



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 DHE 16 SHKURT 2026**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13. I 16. FEBRUARA 2026. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2026**

Rendi i ditës

1. Plotësimi i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 10-V-006, datë 12. 2. 2026, lidhur me përbërjen e komisioneve parlamentare,
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-002 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit për Programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër” ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (pjesë e Grupit të Bankës Botërore),
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-004 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për “Instrumentin për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor” ndërmjet Bashkimit Evropian, që përfaqësohet nga Komisioni Evropian si huadhënës, dhe Republikës së Kosovës si huamarrës, dhe Bankës Qendrore të Kosovës si agjent i huamarrësit,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-005 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin “Kompas” - Qasja gjithëpërfshirëse e Kosovës për forcimin e sistemit të shëndetësisë,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-006 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH) për Projektin “Edukimi në fëmijërinë e hershme dhe kujdesi për kapitalin njerëzor të Kosovës”,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Dnevni red

1. Dopuna Odluke Skupštine Republike Kosovo br. 10-V-006, od 12. 2. 2026. godine, o sastavu parlamentarnih odbora
2. Razmatranje Nacrt-zakona br. 10/L-002 o ratifikaciji sporazuma između Republike Kosovo i Evropske Unije o aranžiranjima za implementaciju podrške Unije Kosovu u okviru instrumenta za reforme i rast,
3. Razmatranje Nacrt-zakona br. 10/L-003 o ratifikaciji Sporazuma o finansiranju za prvi program “Finansiranje razvojnih politika za fiskalnu efikasnost, konkurentnost i zeleni rast”, između Republike Kosovo koju predstavlja Ministarstvo finansija, rada i transfera i Međunarodnog udruženja za razvoj (deo Grupe Svetske banke),
4. Razmatranje Nacrt-zakona br. 10/L-004 o ratifikaciji Sporazuma o Zajmu za “Instrument za Reforme i Rast za Zapadni Balkan” između Evropske unije, koju predstavlja Evropska Komisija kao zajmodavac, i Republike Kosovo kao zajmoprimca, i Centralne Banke Kosova kao Agentu zajmoprimca,
5. Razmatranje Nacrt-zakona br. 10/L-005 o ratifikaciji Sporazuma o Kreditu između Republike Kosovo koju predstavlja Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera i Međunarodne Asocijacije za Projekat “Kompas” - sveobuhvatan pristup Kosova jačanju zdravstvenog sistema,
6. Razmatranje Nacrt-zakona br. 10/L-006 o ratifikaciji Sporazuma o Kreditu između Republike Kosovo koju predstavlja Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera i Međunarodne Asocijacije za Projekat “Kompas” - sveobuhvatan pristup Kosova jačanju zdravstvenog sistema,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 10/L-001 o budžetskim izdvajanjima za budžet Republike Kosovo za 2026. godinu.

Seancën e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuara media që po e përcillni këtë seancë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në sallë janë të pranishëm 99 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, ju njoftoj që në seancën e sotme janë dy deputetë të Kuvendit, të cilët nuk e kanë dhënë ende betimin, për shkak se nuk kanë qenë të pranishëm në seancat e kaluara. Janë deputetja Afërdita Hajrizi dhe deputeti Uran Ismaili. Andaj, unë i ftoj të dy deputetët që sot ta japin betimin. Tekstin e betimit e kanë para vetes. Për të përmbushur këtë detyrim, lus deputetët që të ngrihen në këmbë, ta dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe në fund ta shqiptojnë fjalën “Betohem”.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin. Do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë shtetasve të saj. Do të angazhohem për mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e sovranitetit, tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me ligjet e vendit. Betohem!”

Lus deputetët që ta nënshkruajnë tekstin e betimit dhe ta dorëzojnë në sekretariat. Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Po procedojmë me rendin e ditës:

1. Plotësimi i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 10-V-006, datë 12. 2. 2026, lidhur me përbërjen e komisioneve parlamentare

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kanë propozuar plotësimin e vendimit të Kuvendit lidhur me përbërjen e komisioneve parlamentare. Në këtë rast ftoj shëfën e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes që t'i propozojnë emrat e deputetëve për këto komisione.

Zonja Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

Të nderuar të pranishëm,

Lëvizja propozon që në Komisionin për Buxhet të ketë anëtare dhe deputeten Shqipe Meta-Jusufi.

Një ndryshim, deputeti Arbër Rexhaj të jetë në Komisionin për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, ndërkohë që deputeti Ilir Qeriqi të jetë te Komisioni për Mbikëqyrje të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Deputeti Valon Ramadani te Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi, Tregti dhe Inovacion dhe deputetja Adriana Matoshi te Komisioni për Administratë Publike, Digjitalizim, Inovacion dhe Media.

Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu zonja Nagavci. Tani e ftoj zotin Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i propozon këta anëtarë të komisioneve:

Në Komisionin për të Drejtat, Interesin e Komuniteteve dhe Kthim është deputeti Besnik Tahiri, jam unë.

Anëtar i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, jam unë Besnik Tahiri.

Anëtare e Komisionit për Integrimin Evropian propozohet deputetja Time Kadrijaj, anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporës propozohet deputetja Time Kadrijaj.

Anëtar i Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji propozohet deputeti Besnik Tahiri. Anëtar i Komisionit për Ekonomi, prapë Besnik Tahiri.

Anëtare në Komisionin për Mjedis, Albana Bytyqi. Anëtare e Komisionit për Shëndetësi propozohet Albana Bytyqi.

Anëtare e Komisionit për Administratë Publike, Digjitalizim, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal propozohet deputetja Time Kadrijaj.

Anëtare në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes propozohet deputetja Albana Bytyqi.

Anëtare në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Familjen, Vlerat e Luftës Çlirimtare dhe Peticione propozohet deputetja Albana Bytyqi.

Anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike propozohet Besnik Tahiri. Anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë, Bekë Berisha.

Anëtar në Komisionin për Kulturë, Turizëm dhe Sport, Bekë Berisha dhe anëtare në Komisionin për Mirëqenie Sociale, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Persona të Pagjetur propozohet Time Kadrijaj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar deputet Tahiri!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për plotësimin e vendimit të Kuvendit lidhur me përbërjen e komisioneve parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 101 deputetë, prandaj po vazhdojmë. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Me 100 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi plotësimin e vendimit të Kuvendit lidhur me përbërjen e komisioneve parlamentare.

U uroj punë të mbarë të gjitha komisioneve parlamentare!

E kur jemi këtu, e falënderoj Komisionin për Buxhet dhe atë për Integrimet Evropiane për punën që kanë bërë gjatë ditës së sotme për trajtimin e dokumenteve që tash i kemi në shqyrtim.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-002 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje

Të nderuar deputetë,

Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare bëhet jo më herët se një javë nga dita e shpërndarjes së tij. Andaj, shqyrtimi i këtij projektligji duhet të bëhet me shmangie nga afati procedural i paraparë në nenin 83, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit.

Prandaj, ftoj përfaqësuesen, shafen e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes që ta paraqesë propozimin për shqyrtimin e Projektligjit për shmangie, pra nga afatet procedurale të parapara me nenin 83, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit. Zonja Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Pra, ashtu sikurse kemi dorëzuar edhe kërkesën zyrtare, kërkojmë shmangie nga procedurat e përcaktuara me Rregullore për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji, pasur parasysh rëndësinë e projektligjit edhe vonesat e shumta, të cilat kanë ndodhur për arsye që i dimë të gjithë. Andaj, ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë këtë propozim tonin. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu zonja Nagavci!

Konstatoj se në sallë janë 105 deputetë. Prandaj, po vazhdojmë.

Lus deputetët që me ngritje dorë të deklarojnë:

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë, sipas informacioneve, 100 deputetë të Kuvendit kanë votuar për t'u shmangur nga afati procedural i paraparë në Rregulloren e Punës së Kuvendit. Prandaj, edhe po procedojmë.

Komisioni Funkcional për Integrim Evropian e ka shqyrtuar projektligjin e lartpërmendur dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Prandaj, me këtë rast ftoj përfaqësuesin nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht ministrin e Financave, zotin Murati, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqes para jush Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje, i njohur si Marrëveshja për Instrumentin për Reforma apo shkurtimisht edhe Plani i Rritjes së Bashkimit Evropian.

Në kuadër të këtij plani apo kësaj marrëveshjeje, pra parashihet që Kosova të përfitojë një pako prej 882,6 milionë eurove, e cila është mund të them, alokimi më i lartë në raport me bruto produktin vendor nga të gjitha shtetet. Pra, është rreth 8% e bruto produktit vendor që është i alokuar Kosovës dhe kjo mbështetje financiare, pra vjen në formën e 1/3 si grant, apo 253,3 milionë euro, ndërkaq pjesa tjetër 629,3 milionë euro është në formë të kredisë. Në këtë aspekt,

pra janë dy marrëveshje që duhet të ratifikohen sa i përket Planit të Rritjes. Është kjo, pra tani në këtë pikë të rendit të ditës që është Marrëveshja që e mundëson instrumentin apo Planin e Rritjes dhe reformën apo paketën e reformave dhe më pastaj në një pikë tjetër do të kemi edhe Marrëveshjen e kredisë, pra që mundëson ratifikimin e kredisë në vlerë prej 629,3 milionë euro.

Sa i përket Marrëveshjes Kornizë, teksti i së cilës është standard për të gjitha shtetet përfituese, është që të krijohet baza e përgjithshme kontraktuale që mundëson që Kosova të përfitojë nga fondet e BE-së të ofruara në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje, kurse qëllimi i Marrëveshjes për kredinë, pra do të jetë që të rregullojë kushtet e ndërlydhura specifikisht për marrjen e fondeve të BE-së. Dua të rikujtoj, pra se si Qeveri i kemi dhënë rëndësi dhe prioritet këtij instrumenti, ashtu që të respektoheshin të gjitha afatet e vendosura nga ana e Komisionit Evropian. Rrjedhimisht, edhe kemi qenë, pra Kosova ka qenë ndër shtetet e para që ka finalizuar Agjendën e Reformave dhe kjo është arritur brenda afatit fillestar të vendosur nga Komisioni Evropian, gjersa formalisht është miratuar qysh në tetor të vitit 2024.

Mirëpo, kanë ndodhur disa vonesa pjesërisht, pra edhe në finalizimin e Agjendës së Reformave nga disa shtete të tjera, e pjesërisht edhe për shkak se paralelisht është dashur që vetë Komisioni Evropian, pra të zhvillojë rregulloren e nevojshme për themelimin e këtij instrumenti të ri. Ndërkohë, pastaj, siç e dini, ka qenë edhe situata kur Kuvendi nuk ka qenë funksional dhe ka qenë e pamundur të procedohej tutje.

Prandaj, edhe kemi ardhur në situatën kur tani, paksa edhe me urgjencë na është dashur ta procedojmë menjëherë qysh në mbledhjen e djeshme të Qeverisë sapo kemi marrë detyrën nga ju, deputetë të nderuar, në mënyrë që kjo marrëveshje sot të vijë në seancë dhe të miratohet dhe pastaj të kemi mundësinë edhe të disbursimit. Fillimisht, pra është e paraparë që me rastin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes të disbursohen 7% e mjeteve, apo rreth 62 milionë euro, nga të cilat, pra mënyra se si është e aranzhuar pako apo Plani i Rritjes është e paraparë që gjysma vjen si mbështetje buxhetore, gjysma tjetër shkon si depozitë apo si mbështetje për Republikën e Kosovës në kuadër të fondit apo kornizës për investime të Ballkanit Perëndimor.

Formohet një standard përfundimtar i dakorduar i Marrëveshjes për Instrumentin për reforma për Kosovën, ishte dërguar tek ne, më 15 nëntor të vitit 2024, dhe ishte pranuar fizikisht në Qeveri pra, më 27 nëntor 2024, ku po të njëjtën ditë ishte miratuar edhe Projektligji për ratifikim.

Të njëjtin projektligj, pra e sjellim sot për ratifikim në mënyrë që të mund të procedohet tutje me përfitimin jo vetëm nga mbështetja financiare, por gjithashtu edhe në kuadër të zbatimit të reformave, të cilat parashihen që të na përafrojnë apo të na mundësojnë konvergjinë më të shpejtë drejt standardeve të Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu i nderuar ministër! Tani ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Integrim Evropian, zonjën Hykmete Bajrami, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

Po, ju lutem, regjia, t'ia kaloni fjalën kryetares së komisionit, zonjës Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Në mbledhjen e Komisionit për Integrim Evropian të mbajtur sot në orën 11:30, në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL, ne shqyrtuam Projektligjin nr. 10/L-002 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma për rritje.

Komisioni për Integrim Evropian, edhe pse në kohë shumë të shkurtër, duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj marrëveshje në mënyrë unanime ka votuar për marrëveshjen dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që të votojë për. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, e nderuar zonja Bajrami! Tani është radha e kryetarëve, përkatësisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

E ka radhën Vetëvendosja, zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

Lëvizja Vetëvendosje natyrisht se e jep mbështetjen e plotë për këtë marrëveshje dhe njëkohësisht edhe nga ana jonë i falënderojmë të gjithë deputetët, edhe të komisioneve që u takuan sot, konstituuan komisionet dhe i miratuan të gjitha këto marrëveshje, përfshirë edhe Projektligjin për buxhet. Pra, japim mbështetjen e plotë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Tani e ka radhën PDK-ja, zoti Tahiri.

ARIAN TAHIRI: E nderuar, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Gjithashtu, Partia Demokratike e Kosovës, duke pasur parasysh që është interes i vendit, interesi i shtetit, e jep mbështetjen për marrëveshjet ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Tahiri! Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Lushaku.

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mbështetë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, edhe këtu që është marrëveshje në mes të

Bashkimit Evropian dhe Kosovës, si njëra nga marrëveshjet më të rëndësishme që siguron integrimin e Kosovës në Bashkim Evropian. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Listës serbe. Nuk e dëshirojnë fjalën. Përfaqësuesi nga Grupi Multietnik, shefi i Grupit, zoti Asllani.

ARTAN ASLLANI: Faleminderit, kryetare!

Në emër të Grupit Multietnik, deputeti Fridon Lala ka qenë pjesë e Komisionit për Integritet Evropian dhe energjia që ka qenë në këtë komision e ka sjellë edhe në grupin tonë. Kështu që Grupi i Multietnik i mbështet të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Uroj që kjo energji të vazhdojë. Zoti Tahiri!

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat vijnë në Kuvend dhe të cilat janë në interes të Kosovës, grupi ynë parlamentar do t'i mbështesë. Ajo që duhet të dijë qytetari i Kosovës sot është se kjo është ajo marrëveshja, një ndër marrëveshjet më të rëndësishme të rrugëtimit të Kosovës drejt Unionit Evropian. Plani i Rritjes është një plan jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ne kemi një kërkesë prej ministrit të Financës, tek çështja që u ngrit më herët, pra tek përqindja, tek 7%-shi. Ne kërkojmë tek 62 milionë të jetë një plan, ta shohim një plan, për shkak se këtë plan ne nuk e dimë.

Kjo kredi është e ndarë në dy pjesë: një është kredi, tjetri është grant dhe duam të dimë ku shkojnë këto para. Kjo është kërkesa jonë themelore. Po, përsëris këtë, se edhe për skemat sociale, për reformën kur e kemi pas miratuar, e kam kërkuar të njëjtën, po pres prej jush që të na prezantoni një plan, këto fonde ku shkojnë, për shkak se, siç e dini, në pamundësi të miratimit i kësaj marrëveshje, siç e thatë edhe ju më herët, kemi humbur shumë kohë dhe duam ta dimë ku shkojnë këto para, në cilat pika investive. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Nëse dëshiron, ministër, për të dhënë sqarime? Urdhëro, fjala është për ju!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

I nderuar deputet Tahiri.

Sa i përket mënyrës së dizajnit të Planit të Rritjes, mënyra është kështu: Plani i Rritjes parasheh, siç e thashë, 882 milionë euro. Pra, mbështetja totale për Republikën e Kosovës, e cila mbështetja është e zbërthyer me zhbllokime bazuar në dinamikën e reformave që zbatohet. Për shembull, ka të parapara në pakon e reformave ligje të ndryshme, vendime, akte nënligjore apo edhe targete apo cakte të caktuara që duhet t'i arrijmë në Administratën Publike, në gjyqësor apo edhe në masat të efikasitetit, të cilat pastaj zhbllkojnë fonde të caktuara.

Një prej këtyre fondeve, siç e përmenda, 7% që është paradhënia apo pagesa qysh në start e cila parashihet t'i alokohet Republikës së Kosovës. Tani, burimi i financimit për këtë paradhënie prej 62 milionë eurove është 1/3 do të jetë grant, ndërkaq 2/3 janë kredi. Pra, nëse e rumbullakojmë në 60 milionë euro, mund të themi që 20 milionë euro prej këtyre janë grant, ndërkaq 40 të tjera janë në kredi. Po tash ky është vetëm burimi, se si vijnë dhe si kompozohet ky 60-milionëshi. Ndërkaq, mënyra se si shfrytëzohet është e përcaktuar kështu. Gjysma e këtyre 60 milionëve shkon në WBIF.

Pra, është korniza investive e Ballkanit Perëndimor, janë mjete të dedikuara për Republikën e Kosovës, të cilat i vihen në dispozicion Republikës së Kosovës për projekte investive. Pra, ne duhet të dërgojmë ngjashëm siç kemi dërguar projekte në të kaluarën për WBIF, konkurrojmë, në të kaluarën kemi konkurruar për një shumë të tërësishme të mjeteve të fundit të WBF-it, tani e kemi shumën e alokuar, pra është dedikuar për Republikën e Kosovës, por mjafton që të dërgojmë projekte, të cilat janë të financueshme dhe në bashkëpunim edhe me institucione financiare ndërkombëtare, siç janë: BERZH-i, IB, Banka Botërore e të tjera.

Pra, financohen ato projekte. Domethënë gjysma e këtyre mjeteve shkojnë në WBF, gjysma tjetër disbursohet si mbështetje buxhetore në llogarinë e Thesarit të Republikës së Kosovës. Pra, bëhet pjesë e bilancit bankar, i cili shfrytëzohet për mbështetje buxhetore pa ndonjë dedikim specifik.

Domethënë nuk është se ka dedikim specifik. Është njësoj sikurse marrim hua në tregun e letrave me vlerë, pra që është dedikimi i përgjithshëm, veçse këtu ndikon që të jetë norma e interesit e ulët, pra njësoj siç e ka vetë Bashkimi Evropian për vete, domethënë e transferon të njëjtin çmim apo kosto të huamarrjes dhe të njëjtën kohë kredia është afatgjatë, pra është 40-vjeçare. Domethënë, afati i kthimit është 40 vjet me grejs periudhë prej 10 vjetëve. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar ministër!

Deputeti Tahiri dëshiron sërish ta ketë fjalën. Urdhëro, zoti Tahiri!

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, ministër, për sqarim!

Arsyeja pse e ngrita këtë çështje lidhet drejtpërdrejt me diskrecionin që Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht ministria që ju udhëhoqi e ka në dispozicion. Ky diskrecion mundet të përdoret pa ndonjë kriter të saktë, e ka një kornizë, por nuk ka kriter. Ne duam që këto para të mos shkojnë në një destinacion që mund të kenë përfitime anësore, por të dihet paraprakisht.

Se këtu është nisja, 7% është nisja, kjo është paradhënia. Duke qenë se kjo është paradhënia i kemi bukur me rëndësi që ajo korniza e reformave që duhet bërë shteti dhe në administratë, por edhe në sektorë të tjerë, të hyjë në funksion të marrjes pastaj hap pas hapi. Në të kaluarën, të mos kthehem mbrapa, por në marrëveshjen, sidomos për reformat sociale ku unë, ne e kemi votuar,

nuk e kam parë një plan. Pres prej teje që të sjellësh një plan në Parlament për këtë temë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar zoti Tahiri! Ministër, fjala është për ju!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, zoti Tahiri!

Sa për sqarim, unë e shpjegova paradhënien, meqenëse ishte pra për 7% si paradhënie, pjesa tjetër prej 93%, siç e theksova, është e ndërlidhur në tërësi me masat e Planit të Rritjes.

Për shembull, njëra që më kujtohet është nëse rritet fondi i garancive kreditore, pra i garantimit të kredive prej Republikës së Kosovës, ajo e liron një pjesë të mjeteve që i bie se indirekt ato mjete, pra që janë financuar nga Plani i Rritjes, kanë shkuar drejt rritjes së fondit për garantimin e kredive që ndihmon, pra në mbështetjen e biznesit. Pra, ka këso masa të ngjashme që janë të parapara në paketën e reformave. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Atëherë, në sallë janë 108 deputetë. Siç e dini për miratimin e këtij projektligji duhen së paku 80 vota për, për shkak se është marrëveshje ndërkombëtare.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë!

Kush është për këtë marrëveshje?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj se me 104 vota për, asnjë kundër, pesë abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 10/L-002 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje. Faleminderit deputetëve!

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit për Programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër” ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (pjesë e Grupit të Bankës Botërore)

Të nderuar deputetë, shqyrtimi i projektligjit për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare bëhet jo më herët se një javë nga dita e shpërndarjes së tij. Prandaj, edhe për këtë marrëveshje-projektligj duhet të bëhet shmangia nga afati procedural. Prandaj, ftoj përfaqësuesen nga Lëvizja Vetëvendosje, shefen e Grupit Parlamentar, zonjën Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

Për të njëjtat arsye sikurse edhe për projektligjin paraprak, propozoj shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 107 deputetë, prandaj i lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen!

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Prej javës tjetër kjo do të jetë e mundshme, zoti Hasani sistemi elektronik i votimit, do të jetë më i lehtë edhe për deputetët, edhe për transparencën, por edhe për administratën.

Atëherë, 100 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kuvendi e miratoi shmangien nga afati procedural për këtë marrëveshje.

Prandaj edhe po procedojmë. Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin e lartpërmendur dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij, por para se t'ia jap fjalën kryetarit të komisionit, po e ftoj përfaqësuesin nga Qeveria, përkatësisht ministrin e Financave që ta paraqesë dhe t'arsyetojë këtë projektligj. Ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

Kjo është një marrëveshje financimi e nënshkruar me Bankën Botërore, konkretisht me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim, në 18 prill të vitit 2024. Pra, ka qenë programi i parë apo i titulluar Programi i parë për financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër.

Ngjashëm sikurse që u votua Plani i Rritjes me Bashkimin Evropian, kemi pasur një dakordim të ngjashëm edhe me Bankën Botërore, ku ka qenë një pako e reformave dhe ligjeve që është dashur të miratohen, në mënyrë që Kosovës t'i jepet si shpërblim në fund të asaj kjo marrëveshje financimi në vlerë prej 90,3 milionë eurove. Shteti i Kosovës i ka përmbushur të gjitha detyrimet në raport me Bankën Botërore dhe tani këto mjete janë në dispozicion, por ajo çfarë është e nevojshme që kjo të bëhet efektive është ratifikimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Mund ta them me kënaqësi që kjo marrëveshje ka kushtet më të mira ndonjëherë, mendoj sa i përket financimit, sepse bëhet fjalë për financim me afat maturiteti 12- vjeçar, por me normë interesi 0%. Pra, asnjë tarifë tjetër nuk ka, 0% norma e interesit, si dhe grejs periodha është gjashtë vjet. Pra, tek pas gjashtë vjetëve fillon kthimi, i cili bëhet në gjashtë vjet të tjera. Pra, në

tërësi maturiteti është 12 vjet dhe konsideroj që është një marrëveshje me kushte mjaft të mira, e cila ju lus që ta ketë mbështetjen tuaj, në mënyrë që Kosovës, Republikës së Kosovës t'i vihen në dispozicion këto mjete.

KRYETARJA: Faleminderit, ministër!

Tani ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet, z. Enver Haliti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

ENVER HALITI: Faleminderit, kryetare!

I nderuar kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në bazë të nenit 83, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2026 e shqyrtoi Projektligjin nr. 10/L-003 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr. 10/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për programin e parë për financimin e politikave zhvillimore dhe efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër, e cila është në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financës, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Gjithashtu, ne si Komision FunkSIONAL e kemi kaluar edhe një amendament, që i është ngjitur kësaj me materialin, që është amendamenti 1 i Komisionit FunkSIONAL, ku në nenin 4 (Hyrja në fuqi) ndryshohet teksti që ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ftoj deputetët që ta mbështesin. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit i nderuar, z. Haliti!

Siç e përmendi edhe kryetari i komisionit, pra bazuar në raportin që ka proceduar Komisioni për Buxhet, kemi një amendament të propozuar. Prandaj, edhe para se ta votojmë në tërësi këtë projektligj, do të duhej që ta votojmë fillimisht këtë amendament. Vetëm sa të marrim konfirmimin se sa deputetë janë në sallë.

108 deputetë janë në sallë. Po vazhdojmë me votimin fillimisht të amendamentit.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë, me 102 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi e miratoi amendamentin e propozuar nga Komisioni Funkcional.

Tani po vazhdojmë të votojmë për projektligjin me amendamentin e miratuar:

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Me 103 vota për, asnjë kundër, 5 abstenime, Kuvendi i Republikës e miratoi edhe këtë projektligj.

Faleminderit edhe një herë deputetëve të Kuvendit!

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-004 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për “Instrumentin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor” ndërmjet Bashkimit Evropian, që përfaqësohet nga Komisioni Evropian si Huadhënës, dhe Republikës së Kosovës si Huamarrës, dhe Bankës Qendrore të Kosovës si Agjent i Huamarrësit

Duke pasur parasysh që edhe për këtë projektligj kërkohet të shmangemi nga afatet procedurale, unë ftoj përfaqësuesen nga Vetëvendosje që ta bëjë propozimin për shmangie. Znj. Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje ftoj të gjithë deputetët që të votojnë për shmangie nga afatet procedurale, duke pasur parasysh rëndësinë e votimit të kësaj marrëveshjeje.

KRYETARJA: Faleminderit!

Tani vetëm e marrim numrin e deputetëve që janë në sallë. Duhet konfirmimi i deputetëve para çdo votimi.

Atëherë, në sallë janë të pranishëm 108 deputetë.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë:

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë, 102 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim, prandaj po vazhdojmë me procedurat.

Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin e lartpërmendur dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Unë ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Murati, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit!

E nderuar kryetare,

Ky projektligj apo kjo marrëveshje ndërkombëtare është marrëveshja e radhës, për të cilën paralajmërova në kuadër të Planit të Rritjes me Bashkimin Evropian. Konkretisht, paraprakisht u miratua Korniza dhe pakoja e reformave, ndërkaq tash për miratim është Marrëveshja e kredisë, pra për pjesën e atyre dy të tretave të kredisë.

Në qendër të kësaj agjende të reformave janë reformat për administratë publike, menaxhimin e financave publike, digjitalizimin e shërbimeve, infrastruktura, politika e dekarbonizimit, eficientia e energjisë, arsimi, tregu i punës si dhe sundimi i ligjit.

Kurse, sa i përket Marrëveshjes për financim dhe kushteve të financimit, vlera totale e kredisë siç e thashë më herët është 629 milionë euro, konkretisht 629 311 236 euro, ku nga kjo shumë, pra një pjesë, apo 34,75% e disbursimit do të transferohet në kornizën e investimeve të Ballkanit Perëndimor, ndërkaq pjesa tjetër vjen si mbështetje buxhetore. Secili disbursim i kredisë pra ka afat maturimi prej 40 vjetësh pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe pagesa e kryegjësë pra fillon tek në vitin 2034.

Duke konsideruar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje financimi në kuadër të kompletimit apo përmbylljes së pakos së Planit të Rritjes, ju ftoj për miratim! Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, ministër!

Tani është radha e kryetarit të Komisionit për Buxhet, z. Enver Haliti.

ENVER HALITI: Faleminderit, kryetare!

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në bazë të nenit 83, paragrafi 5 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur në datë 13 shkurt 2026 e shqyrtoi Projektligjin nr. 10/L-004 dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr. 10/L-004 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për “Instrumentin për Reforma dhe Rritje në Ballkanin Perëndimor” ndërmjet Bashkimit Evropian,

që përfaqësohet nga Komisioni Evropian si huadhënës dhe Kosovës si huamarrëse dhe Bankës Qendrore të Kosovës si Agjent i Huamarrësit.

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe paragrafit 2 të Ligjit nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare, Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave të të gjithë deputetëve me ligj ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për marrjen e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2026, pasi e shqyrtoi projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje të kredisë mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, i propozon këtij Kuvendi ratifikimin e kësaj marrëveshjeje! Njëherësh, i falënderoj të gjitha grupet parlamentare që e kanë mbështetur në komision edhe këtë marrëveshje ndërkombëtare sikur të tjerat.

Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit po ashtu, i nderuar z. Haliti!

Në sallë janë të pranishëm 103 deputetë, lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë:

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Edhe për këtë marrëveshje kanë votuar 98 deputetë për, asnjë kundër, 4 abstenime.

Konsiderohet që edhe ky projektligj, përkatësisht kjo marrëveshje u ratifikua në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-005 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin “Kompas” - Qasja gjithëpërfshirëse e Kosovës për forcimin e sistemit të shëndetësisë

Sikurse edhe për marrëveshjet e tjera, edhe për këtë kërkohet që të shmangemi nga afatet procedurale. Prandaj, edhe e ftoj shefen e Grupit të Vetëvendosjes që ta bëjë propozimin. Znj. Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj marrëveshjeje dhe po ashtu edhe ndikimin e jashtëzakonshëm që do të ketë në sistemin e shëndetësisë, ju ftoj për shmangie nga afatet procedurale, në mënyrë që të procedojmë tutje me implementimin e projektit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Në sallë janë të pranishëm 101 deputetë, prandaj edhe lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë:

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Për kanë votuar 94 deputetë, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kuvendi e miratoi shmangien nga afatet procedurale.

Vazhdojmë me trajtimin e këtij projektligji.

Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin e lartpërmendur dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Fillimisht ftoj ministrin Murati që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Në mbështetje të vazhdueshme ndaj sektorit shëndetësor në Republikën e Kosovës, Ministria e Financave, në emër të Republikës së Kosovës, ka nënshkruar Marrëveshjen e Kredisë me Bankën Botërore, konkretisht Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e ashtuquajtur “Kompas”, shkurtimisht apo Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë.

Kjo marrëveshje e kredisë ka vlerën prej 18,6 milionë eurosh dhe ofron kushte të favorshme financimi me kohëzgjatje prej 30 vjetësh, prej të cilave pesë janë grejs periudhë, ndërkaq 25 të tjera periudhë e kthimit dhe me normë interesi prej 0.64% vjetore.

Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i kapaciteteve institucionale, si dhe rritja e cilësisë së kujdesit në sistemin shëndetësor në Kosovë. Projekti ka tri komponentë. Koncretisht, komponenti i parë mbështet forcimin e pjesëve përbërëse të sistemit shëndetësor, që përfshin përmirësimin në ofrimin e shërbimeve, zhvillimin dhe zbatimin e blerjeve strategjike; forcimin e kapaciteteve institucionale si dhe përgatitjen për reagim ndaj pandemive. Komponenti i dytë mbështet zhvillimin e një sistemi të integruar informativ për shëndetësi; pra, parasheh një sistem të ri digjital, i cili mundëson përmirësimin e cilësisë së kujdesit. Si dhe komponenti i tretë përfshin mbështetjen për menaxhimin dhe zbatimin e përgjithshëm të projektit, duke përfshirë edhe monitorimin dhe vlerësimin.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të këtij financimi për këtë projekt kaq rëndësishëm për sektorin e shëndetësisë, ju ftoj për miratim të këtij projektligji për ratifikim të marrëveshjes. Faleminderit!

KRYETARJA: Ministër, faleminderit!

Tani është radha e Komisionit për Buxhet. Kryetari i komisionit, z. Haliti.

ENVER HALITI: Faleminderit, kryetare!

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në bazë të nenit 83, paragrafi 5 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2026 e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 10/L-005 dhe ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr. 10/L-005 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Punës, Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin “Kompas”, Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë.

Andaj, ju ftoj të gjithëve që ta përkrahni! Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit edhe nga ana juaj, z. Haliti!

Në sallë janë të pranishëm 108 deputetë, prandaj po vazhdojmë me votimin. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë:

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë, 103 deputetë kanë votuar për këtë projektligj, asnjë kundër, asnjë abstenim. Konsiderohet që edhe ky projektligj është i miratuar.

E kemi vetëm edhe një marrëveshje ndërkombëtare, pastaj e kemi dhe Projektligjin për buxhetin për vitin 2026.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 10/L-006 për ratifikimin e Marrëveshjen e kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH) për Projektin “Edukimi në fëmijërinë e hershme dhe kujdesi për kapitalin njerëzor të Kosovës”

Edhe për këtë projektligj nevojitet që të shmangemi nga afatet procedurale. Prandaj, e ftoj znj. Nagavci që ta bëjë propozimin për shmangie.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Miratimi i këtij projektligji, i cili do të mundësojë ratifikimin e marrëveshjes, do të mundësojë po ashtu një ndikim dhe përmirësim të jashtëzakonshëm në fushën e edukimit në fëmijërinë e hershme, jo vetëm duke ofruar qasje për më shumë fëmijë, por duke ofruar mbështetje për grupet e marginalizuara dhe për familjet në nevojë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme të përfshirjes së fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme dhe të edukimit cilësor për fëmijët në këtë fazë, unë i ftoj të gjithë deputetët që të votojnë shmangien nga fatet e parapara procedurale.

Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, znj. Nagavci!

Atëherë, në sallë janë të pranishëm 107 deputetë, po vazhdojmë.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

102 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim, prandaj edhe vazhdojmë.

Një minutë, ju lutem!

Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin e lartpërmendur dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Prandaj, fillimisht ftoj ministrin Murati, pastaj kryetarin e komisionit, z. Haliti.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Edhe kjo është një marrëveshje e radhës me Bankën Botërore, konkretisht Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim për projektin “Edukimi në fëmijërinë e hershme dhe kujdesi për kapitalin njerëzor të Kosovës” në shumë prej 18.6 milionë eurosh.

Po ashtu, vlen theksohet që projekti ka përfituar edhe një grant nga Banka Botërore në shumën prej 2 milionë dollarëve amerikanë. Kredia ka kushte mjaft të mira të financimit, me një kohëzgjatje prej 30 vjetësh, pesë prej tyre janë grejs periudhë; ndërkaq, norma e interesit, ngjashëm sikurse marrëveshja paraprake është 0.64 për qind interes vjetor.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të ndikojë në përmirësimin e qasjes së fëmijëve në institucionet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme. Po ashtu, projekti synon edhe përmirësimin e cilësisë së institucioneve që ofrojnë shërbimet e edukimit të hershëm, përkatësisht grupmoshat zero deri në gjashtë vjeç.

Projekti ka disa komponentë. Përmes komponentit të parë do të përkrahet ngritja e nivelit të kornizës rregullative për të siguruar standarde të cilësisë për ofruesit e shërbimeve për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme. Ky komponent do të realizohet duke zhvilluar një kornizë kombëtare të cilësisë për këto institucione dhe duke ngritur kapacitetet e profesionistëve të angazhuar në to. Në komponentin e dytë projekti synon integrimin shumësektorial në shpërndarjen e shërbimeve për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, në mënyrë që të sigurohet angazhim i koordinuar institucional në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Komponenti i tretë ndërkaq përfshin ndërtimin e disa qendrave të reja të ofrimit të këtyre shërbimeve, pra çerdheve, dhe në rast nevojë, renovimin e atyre ekzistuese. Po ashtu ky komponent përfshin dizajnimin dhe zbatimin e një skeme të kuponëve, përmes të cilëve familjet do të kenë mundësi të dërgojnë fëmijët e tyre në këto qendra.

Pra, ai granti prej dy milionë dollarësh parasheh ndarjen e vauçerëve apo kuponëve për familjet në asistencë sociale, në mënyrë që edhe ato familje të kenë mundësi t'i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhe, por me kosto të mbuluar nga ky grant. Komponenti i katërt ndërkaq përfshin përkrahjen ndaj zbatuesit të projektit, në këtë rast, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për të menaxhuar dhe monitoruar projektin.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projekti në ngritjen e cilësisë së edukimit të hershëm parashkollor, ju ftoj për miratim të kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, ministër!

Fjala është e kryetarit të komisionit, z. Haliti!

ENVER HALITI: Faleminderit, kryetare!

Komisioni për Buxhet, Punë e Transfere, në bazë të nenit 83, paragrafi 5 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2026 e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr. 10/L-006 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës e Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (AZHN) për projektin “Edukimi në fëmijërinë e hershme dhe kujdesi për kapitalin njerëzor të Kosovës”.

Kërkoj që të gjithë deputetët ta përkrahin. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar z. Haliti!

Në sallë janë të pranishëm 108 deputetë, prandaj lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen:

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë, 102 deputetë kanë votuar për këtë marrëveshje, asnjë kundër, asnjë abstenim. Rrjedhimisht, ratifikohen të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare.

Faleminderit edhe një herë të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës për mbështetjen e tyre.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026

Edhe për të shqyrtuar këtë projektligj nevojitet që të shmangemi nga Rregullorja e Kuvendit, përkatësisht nga afatet procedurale. Prandaj, e ftoj shefen e Grupit Parlamentar, znj. Nagavci, që ta bëjë propozimin për shmangie.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Projektligji për buxhetin është natyrisht një ndër ligjet më të rëndësishme dhe do të duhej të ishte i votuar tashmë, duke pasur parasysh situatën dhe vonesat në konstituimin e Kuvendit dhe miratimin e Qeverisë, tash duhet që ta procedojmë me procedura të përshpejtuara, në mënyrë që të mos ketë vonesa në ekzekutim në muajin në vijim. Andaj, ju ftoj të gjithëve që të votojmë për shmangien për afatet procedurale edhe për projektligjin. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në sallë janë të pranishëm 107 deputetë, prandaj kush është për?
Më fal, në rregull!

Atëherë ju kisha lutur që nëse dëshironi fjalën që të paraqiteni me kohë. E di që për shkak se ende nuk e kemi sistemin elektronik, kjo është pak më e vështirë, por javën tjetër kjo rregullohet, prandaj po i ftoj grupet parlamentare që t'i paraqesin qëndrimet e tyre. Z. Tahiri.

ARIAN TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës nuk e mbështet këtë propozim. Ne e dimë dhe e kuptojmë rëndësinë e buxhetit, mirëpo ne dje e kemi argumentuar dhe dëshmuar vullnetin tonë dhe gatishmërinë për të kontribuar që shteti të mos bllokohet, duke e mbështetur propozimin për vazhdimin për muajin mars. Prandaj, sot ne nuk e mbështesim këtë propozim. E kuptojmë rëndësinë dhe jemi tolerant që të mos ketë proces të rregullt, të ketë procedurë të përshpejtuar.

Mirëpo, duke pasur parasysh se nevojitet kohë, minimumi kërkojmë një afat optimal që për neve konsiderojmë që është tri ditë, në mënyrë që edhe deputetët e pozitës, edhe deputetët e opozitës të kenë mundësi ta shohin materialin, ta analizojnë, duke pasur parasysh se është një dokument voluminoz me rreth 700 faqe dhe po flasim për projektligjin më të rëndësishëm të vendit, pra buxhetin. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, z. Tahiri! Fjalën e ka deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, znj. kryetare!

Të dashur kolegë deputetë,

Në mirëkuptimin e madh për rëndësinë e Ligjit të buxhetit, pajtohem se është ligj i rëndësishëm; me siguri, më i rëndësishmi që Qeveria mund ta ketë. Dhe, sepse është i rëndësishëm, nuk mund ta pranojmë një fakt që brenda tri orësh ta trajtojmë një buxhet jetësor të Republikës së Kosovës. Nuk është serioze, ju lutem!

E dini që s'është serioze. Për aq kohë sa arritëm ta lexojmë, ky ligji i buxhetit që na e keni sjellë s'e reflekton as këtë Qeveri këtu. A e dini që katër ministri ose pesë nuk kanë buxhet për vete? Pra, s'po flasim për ato zotimet e pardjeshme që i dëgjuam këtu, se do të bëhet kjo ajo, që s'janë fare në buxhet. Por, katër ministra këtu s'e kanë buxhetin fare të parashikuar.

Prandaj, ju lutem bëhemi më seriozë dhe në këto tema të seriozitetit të lartë, merreni këtë dokument, jepuni kohë tri-katër ditë deputetëve ta lexojnë, ta shohin, përshtateni me kabinetin tuaj fillimisht, përshtateni edhe me komunat e Kosovës. Mos të harrojmë, Prishtina e ka të aprovuar buxhetin tash e sa javë, ju nuk e keni në buxhet fare këtu. E më pas, ejani në Kuvend dhe sikurse çështjet e marrëveshjeve, i diskutojmë dhe të buxhetit. Pa dyshim, është shumë e rëndësishme të jetë edhe i zoti i shtëpisë këtu, Kryeministri i Kosovës. Nuk ka ligj më të rëndësishëm!

Le të vijë, ta prezantojë, ta debatojmë si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Ju lusim për seriozitet! Mos e merrni ndryshe! Merreni si seriozitet, si praktikë minimaliste demokratike dhe për të mirën e këtyre ministrave. Katër ose pesë ministra do të duhej tash të dilnin këtu dhe të thoshin:

“Më falni, se ky buxhet nuk bën, se s’e kam të paraparë buxhetin për Ministrinë time”. Ku të shkojë në zyrë një ministër kur s’e ka buxhetin për ministrinë e vet.

Prandaj, ju kërkohet mirëkuptim dhe natyrisht, nëse s’kemi mirëkuptim, nuk do të votojmë për. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Prishtina e ka miratuar që gjashtë ditë, jo që disa javë. Vetëm për ta sqaruar. Z. Tahiri, fjala është për ju!

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Financave,

Janë katër argumente, të cilat pashmangshëm na detyrojnë si Kuvend i Republikës së Kosovës të mos e miratojmë këtë shmangie dhe të mos debatojmë sot Projektbuxhetin e vitit 2026.

E para, çfarë bëme dje? Dje, a e votuam vazhdimin e ndarjes buxhetore mu në këtë Kuvend. Pra, në aspektin funksional të shtetit të Kosovës, nuk ka asnjë nguti. Unë e shikova te ueb-faqja e Ministrisë së Financave, në janar ka hyrë pak borxh, mund të hyjë edhe në shkurt pak te marsi. Ky është veç i vetmi dëm. Ndërsa e dini çfarë dëmi po na bëhet neve në aspektin e afateve kohore?

Deputetë të nderuar,

Nuk ka asnjë urgjencë për shkak se ne dje e kemi miratuar vazhdimin e ndarjes buxhetore për funksionimin e shtetit të Republikës së Kosovës. Ky është argumenti i parë, e që është rreth afateve. Argumenti i dytë, që ndërlidhet me praktikë, qysh bre ka mundësi 1 deputet, po duhet të jesh supermen që ta analizosh buxhetin e Republikës së Kosovës të vitit 2026 tabelë për tabelë.

Unë fillova ta lexoj në zyrën time me stafin tim, dhe çka pashë aty është që ka shumë për t’u debatuar. Ky nuk është buxheti i vitit 2026, të nderuar deputetë. Ky është buxheti i vitit 2025, i vitit të kaluar. Vetëm në tekst, vetëm në tekst kam bërë disa ndryshime, ndërsa vijat buxhetore janë të njëjta. Në tekst kanë bërë dy ndryshime.

Te neni 32, dhe në mos qofsha gabim, te neni 11 reflektohet struktura e Qeverisë. Pra, reflektohet struktura e Qeverisë në këtë buxhet. Është e vërtetë që reflektohet. Por reflektohet, ta ka lënë ty në vendim të Qeverisë që të riorganizohet, pasi të miratohet Rregullorja e Punës së Qeverisë, në të njëjtën kohë me vendim të ministrit, i nderuar ministër, i lejohet ministrit ta riorganizojë Kabinetin e vet qeveritar. Kështu është në ligj.

Pra, është reflektuar Kabineti qeveritar. Po, është reflektuar në dy nene, edhe në qoftë se e shihni tekstin në buxhet, fondi i buxhetit është i ndryshëm me këto dy nene se është marrë copy past

dhe është vendosur. Veç këqyreni nëse keni kohë, se e kam analizuar. Është reflektuar, mirëpo ne duhet ta diskutojmë përmbajtjen e buxhetit. Praktikisht, nuk ka mundësi ta bëjmë. Po ashtu, në tekst është reflektuar edhe një çështje tjetër. Siç e dini, është paga e 13-të, që është reflektuar në buxhet dhe ne duhet të diskutojmë si deputetë, a duam që pagën e 13-të t'ia japim krejt korpusit të administratës publike dhe të administratës shtetërore, apo duam ne t'i marrim si të emëruar politikë dhe në Kabinet qeveritar, që kur të bëhen 21 kabinete dhe të tjera janë diku rreth 450 njerëz, apo duam që ato mjete t'i futim diku në skema sociale. Është diskutim politik, nuk është diskutim përmbajtjesor.

Çështja e tretë lidhet drejtpërdrejt me aspektin politik.

I nderuar ministër,

Më 28 dhjetor, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 51%. Keni qenë në zyrë. Ju keni qenë ministër, 52 apo 55 sa të doni, nuk është problem kjo punë. Duroni, dëgjoni se ky është argument, nuk është inat. S'jam duke folur personalisht, jam duke folur me argumente. Dilni nëse keni argument dhe më kundërshtoni.

Më 28 dhjetor keni fituar. Secili ministër ka qenë në kabinet, në dikastere, kur nuk e kam votuar, kur kam folur për platformën e kryeministrit, unë kam pritur që ta kam një platformë që reflekton mbi këtë buxhet. Jo një ekspozë që s'e kam parë. Emrat i kam dëgjuar, e i kam shkruar ngadalë, as mbiemrat s'mund t'i shkruaja, por jo dikasteret. Ne duhet të diskutojmë për buxhetin prej perspektivës, po ashtu politike, ju lutem!

Dhe, e fundit, është kolegiale, a i ngrehëm duart krejt këtu për të gjitha marrëveshjet. Asnjë fjalë nuk e thashë për Bankën Botërore, të nderuar deputetë dhe deputete. Sot ka qenë afati i fundit, dhe sikur të mos i jepnim zor për t'i miratuar, ju që keni qenë në komisione për marrëveshjet ndërkombëtare, sot do t'i humbnim 90 milionë të Bankës Botërore. Po flasim pak edhe për kolegalitet.

Na jepni kohë që ta shikojmë buxhetin, dhe nuk po hyj të flas për përmbajtje. Kam çfarë të them për përmbajtje, se e kam lexuar. E kam parë sa është rritur fondi i investimeve kapitale për ushtrinë. E kam parë sa është fondi për sigurime shëndetësore. Nuk po hyj në këtë temë, po ju lutem pak për kolegalitet. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Tahiri!

Vetëm për njoftim nga ajo që e shtroi zoti Abdixhiku. Unë jam njoftuar nga kryeministri Kurti që është në Munih të Gjermanisë në Konferencën për Siguri, në Konferencën e Sigurisë. Prandaj, vetëm që ta ndaj me juve këtë si informacion.

Jo jo, zoti Tahiri, iu përgjigja zotit Abdixhiku, se tha që kryeministri është dashur që të jetë i pranishëm. Natyrisht që është një projektligj shumë i rëndësishëm. E kemi zëvendëskryeministrin këtu, e kemi ministrin e Financave përgjegjës për hartimin e buxhetit, prandaj edhe e bëra këtë më tepër vetëm si njoftim.

A është paraqitur dikush tjetër për fjalë? Përfaqësues i Listës serbe?

IGOR SIMIĆ: Hvala predsjedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani građani,

Ono što smo mogli da čujemo danas kada je u pitanju Budžet za narednu godinu, svodi se na tri reči: lažno, potrebno je brzo, i odstupanje od pravila. To je neka praksa koja predugo traje u ovom Parlamentu.

Pogledajte koliki je to dokument, ko može da obradi sve ovo za nekoliko sati, a da se ozbiljno bavi poslom koji su nam građani poverili kada su nas birali na ovim izborima?

Dakle, ako hoćete ozbiljno da pristupimo ovakvom jednom dokumentu, potrebno je nekoliko dana, kako bi mogli da sagledamo sve aspekte budžetskih izdvajanja, jer ovo nije privatna notacija, a govorimo o blizu 4 milijarde evra. Hvala!

KRYETARJA: Nëse nuk ka të tjerë të paraqitur, atëherë vazhdojmë që ta votojmë propozimin për shmangie... Zoti Abdixhiku! Zonja Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!

Për të dhënë edhe një plotësim. Është e vërtetë që në pjesën tekstuale janë futur nene, të cilat i japin autorizime të veçanta ministrit që të reflektojmë andej strukturën e buxhetit, por ne të gjithë e dimë rëndësinë e pjesës tabelare. Dhe, në pjesën tabelare, kur e shikon strukturën e buxhetit, janë këtu 4 ministra të pranishëm, të cilët fare nuk figurojnë.

Dhe, tash Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ka praktikuar asnjëherë që t'i japë autorizim ministrit të Financave që ta ndryshojë ligjin, të cilin e miraton Parlamenti i Republikës së Kosovës.

Tjetra, ju lutem! Asnjë fjalë nuk u tha për urgjencën. Dje, pavarësisht që jemi në opozitë, kemi votuar për zgjatjet buxhetore për muajin mars. Nuk ka absolutisht asnjë lloj ngutje që ne në orën 11:00 e kemi marrë Ligjin e buxhetit, siç u tha mbi 700 faqe, dhe sot ta trajtojmë një dokument, i cili, mbi të gjitha, nuk e ka as strukturën e kabinetit të reflektuar, e lërë më zotimet të cilat kryeministri Kurti i ka thënë atë ditë në ekspozë.

Kështu që, jo vetëm që jemi kundër, por do të kishte qenë tepër e arsyeshme që edhe ju të tërhiqeni prej kësaj kërkesë, e cila është komplet joracionale. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në sallë... Zonja Nagavci dëshiron ta japë një sqarim.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

Unë edhe një herë i falënderoj të gjithë kolegët deputetë për votimin edhe për miratimin e marrëveshjeve. Besoj që kjo votë e të gjithë ju deputetëve ka qenë për shkak të rëndësisë që ka për qytetarët secila prej këtyre marrëveshjeve.

Në këtë frymë, të gjithë, edhe zoti Tahiri me rekomandimet që i kishte, zonja Bajrami e të tjerë, të dimë se do të ketë mundësi që të dorëzohen amendamentet, që ky projektligj do të shqyrtohet në komisionet funksionale. Secili prej deputetëve mund t'i paraqesë amendamentet dhe natyrisht se do të ketë hapësirë që të diskutohet secila prej shqetësimeve në komisione, e pastaj edhe në lexim të dytë përpara votimit.

Kështu që, edhe një herë, duke pasur parasysh vonesat e shumta që kemi pasur në konstituim të institucioneve, unë ju ftoj që të vazhdojmë tutje me shmangie nga afatet procedurale dhe pastaj me trajtim edhe punë në amendamente, të cilat do t'i jepni. Me gjithë respektin për analizën që tashmë keni filluar ta bëni. Faleminderit!

KRYETARJA: Ministri Murati e ka fjalën.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

I dëgjova edhe shqetësimet, edhe vërejtjet nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Gjithsesi, sa i përket çështjes së ministrive pa buxhet. E vërtetë. Ne edhe si Qeveri, pra ditën kur ministrat e kanë marrë detyrën, janë emëruar, atë ditë edhe e kemi proceduar Ligjin për ndarjet buxhetore. Ka qenë një emergjencë më tepër sesa edhe ne që e konsiderojmë si një buxhet për tërë vitin. Vetëm ta përfundoj.

Pra, ka qenë buxhet emergjence. Po të ishte miratuar, ta zëmë, po të kishte buxhet të miratuar dhe në fuqi, ne patjetër si Qeveri e re do ta bënim një rishikim. Ngjashëm siç kemi bërë, ta zëmë në vitin 2021. E kemi gjetur një buxhet që jo domosdo ka reflektuar gjithë vizionin e secilit prej dikastereve. Ka pasur edhe ndryshim të dikastereve në atë kohë dhe është bërë ai rishikim në muajin prill, nëse s'gaboj. Në mars është marrë detyra nga Qeveria e re më 2021, në prill ka pasur rishikim të buxhetit.

Ngjashëm parashihet që të ketë rishikim, madje dhe për komunat. Sepse siç e dini, në procesin zgjedhor që sapo e kemi lënë pas vitin e kaluar në nivelin lokal, ka dhe kryetarë komunash që kanë ndryshuar dhe patjetër që ndryshon edhe prioriteti në nivelin lokal. Pra, duhet të ketë një

rishikim, e po besoj rishikimi do të nxirrte në pah edhe për nivelin qendror, edhe për nivelin lokal, buxhetin dhe reflektimin e të gjitha prioriteteve të programeve qeveritare.

Çka ne kemi dashur të bëjmë si Qeveri e sapomiratur dhe konfirmuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka qenë që të sigurojmë mbarëvajtjen e vendit dhe të funksionimit të shtetit dhe të institucioneve shtetërore. Zgjatja për muajin mars siguron vetëm shpenzimet rrjedhëse. Ndërkaq, çdo prokurim, për shembull, nëse nesër do edhe në një komunë të prokurojë diçka, nuk mund nëse e tejkalon alokimin e tre muajve. Pra, nëse është paraparë një shpenzim i mirëmbajtjes së rrugëve, ta zëmë, që është i buxhetuar në tërë vitin 1 milion euro, ndarja prej tre muajve apo 3/12, nuk mjafton që ajo komunë t'i zotojë mjetet dhe ta iniciojë procedurën e prokurimit.

Çdo prokurim i ri është i bllokuar në gjithë vendin për aq sa nuk ka buxhet të miratur. Ky është problemi. Shpenzimet rrjedhëse dhe mund t'i menaxhojmë disi, por sa u përket prokurimeve të reja, në rastet kur skadojnë kontratat dhe mund të ketë mungesë të procedurave të reja të prokurimit, atëherë mund të krijohen situata që ndoshta edhe mund të eskalojnë, apo mund të jenë shumë të vështira, gjë që tani për tani nuk mund ta parashikojmë. Synimi ka qenë që të jetë një buxhet emergjent vetëm sa ta kemi një urë lidhëse deri në miratimin e një buxheti të rishikuar më së largu në muajin që vjen.

Ne sapo ta kemi një konfirmim të këtij Ligji për buxhet, do të fillojmë procesin e rishikimit të buxhetit, të cilin do ta sillnim para jush në Kuvend. Zgjatja e marsit që ka ndodhur mjafton për pagesë të shpenzimeve rrjedhëse. Edhe një herë po e theksoj, nuk mjafton ligjërishit për të mundësuar organizatat buxhetore, komunat, ministritë që të hyjnë në obligime të reja.

Dikasteret, siç e thatë edhe ju, janë paraparë në nenin 11, paragrafi 5, që me rastin e votimit në Qeveri të Rregullores dhe shpërndarjes së përgjegjësisë, të mund të bëhet riaranzhimi i tabelave. Jo të ndryshohen kufijtë, jo të rriten kufijtë. Pra, kufiri i shpenzimit mbetet i njëjtë, vetëm se ka bartje të programeve nga një dikaster në tjetrin. Nuk ka ndryshim të kufijve buxhetorë si tërësi. Ndryshimi apo ligji që parasheh tavanin e pagave, tavanin e investimeve kapitale, tavanin e mallrave dhe shërbimeve nuk ndryshon në tërësi. Edhe rregulla e deficitit respektohet.

Çfarë bëhet është që vetëm merret një program apo nënprogram nga një dikaster vendoset tek tjetri, varësisht se si miratohet fushëveprimi në Rregulloren e Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, ministër! Zonja Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Ministër, nuk e shpjegove arsyen e urgjencës sot. Po të kërkohen tri ditë për ta analizuar deputetët Ligjin e buxhetit, ligjin që është më i rëndësishmi brenda një vitit kalendarik. Tri ditë

po kërkojmë kohë. E vetmja arsye për të cilën neve na shkon mendja, është që ju po kërkonit që t'i shmangeni debatit në seancë.

Përndryshe, sa i përket diskutimit në komisione, sa i përket paraqitjes së amendamenteve, ne e dimë shumë mirë, ju jeni ministër i Financave prej vitit 2021, asnjë amendament i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk ka kaluar. Ka kaluar një amendament i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili asnjëherë nuk është zbatuar. Kjo është historia sa u përket komisioneve dhe amendamenteve.

Në anën tjetër, thatë që nuk keni mundur t'i reflektoni ministrinë, sepse ditën kur është paraqitur Kabineti është përcjellë. Më 28 dhjetor e keni ditur që i keni fituar zgjedhjet. Domethënë, ju nuk e keni ditur përbërjen e Kabinetit deri në ditën kur janë votuar ministrat?! Kjo me të vërtetë tregon shumë për vizionin dhe planifikimin e juaj dhe atë çka ju dëshironi të bëni me taksat e qytetarëve të këtij vendi dhe me zhvillimin e këtij vendi.

Do të thotë, keni dikastere të cilave sot nuk ua dini buxhetin. Si ka mundësi që një ministër që është i ulur aty, që po e shoh zotin Jagxhiu, i di objektivat për ministrinë e tij, kur ai në fakt nuk e di sot sa e ka buxhetin për mallra, sa e ka buxhetin për investime, sa e ka buxhetin për subvencione. Nuk e ka idenë. Në fakt, ai nuk ka kod buxhetor. Njëjtë është edhe me ministrin Basha dhe plot ministra të tjerë. Domethënë, ju faktikisht nuk e keni idenë se çfarë do të bëni, siç nuk e keni pasur në pesë vjetët e kaluara. Të mundoheni ta keqpërdorni mirësinë tonë që votuam pesë marrëveshje ndërkombëtare sot.

Ju, i nderuar ministër, i keni numrat për ta kaluar Ligjin e buxhetit, sepse Ligji i buxhetit kalon me shumicën e thjeshtë. Ajo çka po kërkonit sot është që po kërkonit t'i shmangeni debatit, edhe shmangia sot nga Rregullorja kërkon 2/3 e deputetëve që janë të pranishëm, që po shpresoj shumë që nuk i keni.

Ne dëshirojmë që të kemi debat dhe t'u tregojmë qytetarëve të Republikës së Kosovës se si Qeveria juaj ka planifikuar që t'i shpenzojë taksat dhe shpenzimet e tyre. Ne dëshirojmë t'u themi atyre që po ata kanë shtesa, po ata e kanë Super-Punën, por çka me deponitë e mbeturinave? Çka me një deponi të mbeturinave në Komunën e Pejës, e cila ka pasoja epidemike dhe ju nuk e ndani asnjë cent në buxhet. Mund të blini vota sa herë që ka zgjedhje, mirëpo neve na duhet trajtim cilësor i ndarjes buxhetore dhe ne kërkojmë shpjegim për secilin zë buxhetor dhe për secilin pikë dhe atë ju nuk po kërkonit që ta keni sot, sepse po kërkonit që të trajtohet pa u lexuar prej deputetëve.

A e dini që në Komisionin për Buxhet dhe Financa, deputetët kanë shkuar, ka kaluar Ligji i buxhetit pa e pasur materialin? Ku keni parë kështu? Cila është urgjenca? Tri ditë po ju kërkojnë. I keni të votuara zgjatjet buxhetore për muajin mars. Ju po thonit që ka mbetur me

shpenzime rrjedhëse, edhe nuk ka mundësi kjo. A e dini ministër që Komunën e Prishtinës e keni lënë një vit e dy muaj pikërisht kështu me 1/12, dhe krenoheni për këtë. Derisa ata e kanë e kanë ratifikuar buxhetin në vitin 2024, mirëpo ju si Ministri e Financave nuk e keni marrë mundin. E keni lënë komunën më të madhe në Kosovë, ku bën pjesë, domethënë gjysma e popullsisë së Kosovës graviton këtu, ju e keni lënë vetëm me 1/12, dhe tash nuk dëshironi që të na jepni afat 48 orë ose 3 ditë për ta shqyrtuar dhe për të debatuar këtu. Dëshirojmë që të debatojmë. Dëshirojmë që kryeministri Kurti të jetë këtu.

KRYETARJA: Faleminderit! Urdhëro, ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, nderuar deputete!

Si ministër i Financave e kam konsideruar që nuk e kam diskrecionin, pra për të qenë i përgjegjshëm, dhe nuk kam diskrecion që të vonohet ky ligj. Shteti nuk mund të mbetet pa buxhet. Mund të jetë buxheti më i keq ndoshta i mundshëm, sipas vlerësimit të cilido prej juve. Mund të jetë buxheti më i mirë i mundshëm, sipas vlerësimit të deputetëve të pozitës. Këto mund të jenë mendime të ndryshme dhe mund të debatojmë. Megjithatë, ne duhet ta kemi një Ligj të buxhetit. Debatet substanciale që po mendojnë që duhet t'i zhvillojmë, pajtohem me ju, duhet të zhvillohen. Mirëpo, na lejoni kohë që atë debat ta zhvillojmë kur e kemi një Ligj të buxhetit, i cili e siguron mbarëvajtjen e shtetit.

Ndërkaq, ne do ta sjellim rishikimin në muajin e ardhshëm. Rishikimi do të sillet muajin e ardhshëm, sepse është i domosdoshëm fillimisht për dikasteret qeveritare, por edhe për komunat, sepse ka shumë komuna ka që kanë ndryshuar kryetarët. Nëse nuk ka ndryshuar kryetari, mund të ketë ndryshuar përbërja e Asamblesë komunale, e cila ka ndryshuar mendim ndoshta sa i përket përbërjes së buxhetit. Gjithsesi, do të ketë rishikim dhe do ta bëjmë në afat rekord. E po besoj që aty do të zhvillohet pastaj debati, diskutimi sa i përket edhe reflektimit të prioriteteve, por edhe e kemi komoditetin e mbarëvajtjes së shtetit. Kjo është arsyeja pse ka kaq urgjencë.

Ideja ka qenë që edhe në Qeveri nuk kemi bërë diskutime ditën që janë emëruar ministrat që e kanë marrë detyrën, dorëzim-pranimin. Kemi proceduar me Ligjin për ndarje buxhetore në mënyrë që të fitojmë në kohë, të sigurohemi që shteti ka siguri, ka mbarëvajtje dhe rishikimi do të vijë në afat rekord. Për këtë, përtej zotimit që mund të jap këtu si ministër i Financave nuk mund të them gjë tjetër.

Por, çka na duhet, na duhet një stabilitet dhe një siguri që shteti ka buxhet, që organizatat buxhetore në rast se u duhet të prokurojnë diçka që shkon përtej ndarjes 1/12, të mund ta bëjnë atë. Të tjerat mund edhe t'i diskutojmë, por prapë po e them, ideja ka qenë kjo. Asgjë tjetër. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Me vëmendje e përcolla këtë pjesë të debatit. Po besoj që është më se qartë që nuk është tema te bllokada dhe te rreziku që vendi të jetë pa buxhet. Për shkak se e thanë, por e ripërsëris, pa dallim, të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës në mënyrë të vullnetshme e kanë votuar dje vendimin për shfrytëzimin e ndarjeve buxhetore edhe për muajin mars. Nuk kërkoi askush qëllimisht që të humbet kohë dhe vendi të vendoset në vështirësi, dhe Qeveria në vështirësi. Kërkuam një afat më se të arsyeshëm, tri ditë.

Po e them, pavarësisht që kam punuar dhe jam i kësaj fushe, edhe unë sot e kam problem të diskutoj me kompetencë për këtë dokument kaq të rëndësishëm dhe kaq voluminoz. E them me bindje që edhe deputetët e pozitës kanë çka çfarë të japin kontribut në këtë drejtim. Por, nuk kanë pasur mundësi dhe nuk janë të përgatitur për shkak se janë në pyetje vetëm disa orë.

E di praktikën e vitit 2011. Jemi formuar si qeveri, kemi ardhur në Kuvend. Kuvendi e ka provuar vendimin për shfrytëzimin e ndarjeve buxhetore. Është përgatitur buxheti, është diskutuar në procedurë dhe afate të rregullta, është votuar dhe ka hyrë në fuqi. Ne prapë nuk po themi që t'i shfrytëzojmë ato afatet maksimale ligjore, mirëpo kërkesa jonë është tri ditë. Dhe, qëllimi dhe tendenca është që të mos ketë debat.

Ky buxhet, jam i bindur, do ta shikojmë gjatë diskutimeve, nuk është në përputhje me ekspozenë e kryeministrit. Gjithçka që është thënë në ekspozë, gjithë ato premtime nuk janë të reflektuara në këtë buxhet për vitin 2026 dhe vitet vijuese, janë nivel dëshiror. Ato nëse s'e kanë konstruksionin financiar nuk realizohen dhe sigurisht se shihet që nuk ka mundësi të kalojë edhe pa opozitën.

Unë po ju kërkoj, tërhiqeni dhe silleni pas tri ditësh. Jemi të bindur që do t'jua votojmë që të hyjë në procedurë të përshpejtuar. Përndryshe, sigurisht se pa debat, pa diskutime...

Edhe, ministër, nuk mund ta ndërrosh me një nen dhe të thuash në këtë nen e bëjmë këtë. Sipas kësaj, po e thjeshtësojmë. Po themi që Kuvendi i Republikës së Kosovës e aprovon Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 në vlerë 4 miliardë euro dhe Qeveria i autorizon ministrat që ta shpërndajnë këtë shumë.

Por, kur të ndërrohet dhe kur të reflektojë strukturën e Qeverisë, katër ministra shtohen, sa zëvendësministra shtohen, sa këshilltarë shtohen. Krejt kjo ta ndërron edhe numrin e të punësuarve. Prandaj, ka më shumë se një arsye që opozita po kërkon një afat optimal për tri ditë

që të kemi mundësi për t'i përgatitur diskutimet, propozimet, amendamentet dhe të gjitha çështjet e tjera. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Para se të vazhdojmë, unë i ftoj shefat e grupeve parlamentare që të vijnë për një konsultim. Besnik, të lutem vetëm pak! E ka me rëndësi që ta gjejmë konsensusin, jo ta shohim kush kë po e mund.

Buxheti është shumë i rëndësishëm për qytetarët e Republikës së Kosovës. Unë nuk mendoj që këtu duhet të shtyhem se kush po humb e kush po fiton. Nëse munden shefat e grupeve të vijnë për konsultim, po ashtu edhe ministri i Financave.

Atëherë, faleminderit! Pas konsultimeve me shefat e grupeve parlamentare, kjo seancë shtyhet për të hënë, në orën 10:00. Pra, leximi i parë i Projektligjit për buxhetin është të hënë, në orën 10:00. Për ta sqaruar, leximi i dytë të premtën, por që këtë e definojmë të hënë.

Faleminderit dhe mirupafshim në seancën e njëjtë, por që po shtyhet për të hënë.

* * *

E hënë, më 16 shkurt 2026

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 13 shkurt 2026

Seancën e drejton kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar dhe media që po e përcillni këtë seancë!

Ashtu siç u dakorduar me shefat e grupeve parlamentare gjatë seancës së jashtëzakonshme të datës 13. 2. 2026, po i hap punimet e vazhdimit të seancës së jashtëzakonshme plenare, e cila vazhdon sot, pra më 16. 2. 2026.

Para se të vazhdojmë, ju ftoj të votoni për praninë tuaj.

Tani është sistemi elektronik i votimit, prandaj le të shohim sa deputetë janë në sallë. Vazhdojmë me votimin!

Në sallë janë të pranishëm 103 deputetë.

Procedojmë me pikën e papërfunduar të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 10/ L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026

Të nderuar deputetë,

Referuar nenit 80 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin vjetor në seancë plenare bëhet jo më herët se një javë nga dita e shpërndarjes së tij. Projektligji është shpërndarë më 13 shkurt 2026, andaj shqyrtimi i këtij projektligji duhet të bëhet me shmangie nga afati procedural i paraparë me nenin 80, paragrafi 1 i Rregullores së Punës së Kuvendit. Në seancën e kaluar të jashtëzakonshme ne kemi pasur propozimin e shefes së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, pra për shmangie nga afatet që parasheh Rregullorja e Punës së Kuvendit prandaj, edhe po vazhdojmë me votimin.

Ju lus të gjithëve që të votoni përmes sistemit elektronik për shmangiet nga afatet procedurale. Votojmë tash!

Atëherë, 82 deputetë kanë votuar për, 9 kundër, 1 abstenim që nënkupton që ka kaluar propozimi për shmangie nga Rregullorja e Punës së Kuvendit.

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet e ka shqyrtuar Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Prandaj, ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, përkatësisht ministrin e Financave, zotin Hekuran Murati, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2026. I nderuar ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që me gjithë shtyrjen që u bë, ta paraqes para jush Projektligjin për ndarjen buxhetore për vitin 2026. Të gjithë e dimë që ky projektligj sipas ligjit parashihej të miratohej dhe të dorëzohej në Kuvend më datën 31 tetor të vitit të kaluar, gjë që Qeveria aso kohe në detyrë e kishte bërë. Megjithatë, në mungesë të një Kuvendi funksional, por edhe në mungesë të konsensusit më pastaj pas konstituimit të Kuvendit, ky projektligj nuk ishte proceduar dhe nuk ishte miratuar në mënyrë që të ishte në fuqi, pra datës 1 janar kur edhe fillon shfrytëzimi i këtij buxheti.

Si rezultat i kësaj, ne kemi pasur zgjatjen buxhetore automatike, siç parashihet me LMFPF-në që është për dy muajt e parë dhe, më pastaj, siç e dini, edhe ju është miratuar edhe zgjatja për muajin mars. Sido që të jetë, këto zgjatje mjaftojnë vetëm për shpenzimet rrjedhëse. Sa u përket prokurimeve të reja, projekteve të reja, është e pamundur të iniciohen procedurat pa pasur zotimin e mjeteve, e nëse alokimi është i bërë vetëm për 3/12 e vitit, pra nuk mund të zotohet komplet viti ta zëmë për ndonjë projekt kapital apo për ndonjë prokurim tjetër sa u përket mallrave dhe shërbimeve për shërbime esenciale në rast se është nevoja.

Prandaj, duke e parë këtë situatë, duke qenë të vetëdijshëm edhe për situatën emergjente, pra që na pret sa i përket lëvizjes tutje dhe zhblllokimit të buxhetit qoftë për nivelin qendror apo edhe për atë komunal, ne i kemi propozuar si Ministri e Financave Qeverisë në mbledhjen e parë, pra si Qeveri e re që të procedojmë projektligjin ashtu siç ka qenë, pra duke mos reflektuar domosdo tani për tani ndryshimet e nevojshme për të gjitha prioritetet, por edhe për strukturën e Qeverisë, por që këtë ta bëjmë në një rishikim të më pastajmë. Ndërkaq, ky projektligj, pra është projektligji i cili është miratuar më 31 tetor të vitit të kaluar ashtu siç e ka paraparë ligji. Pra, tabelat janë të ngjashme, e vetmja gjë që ndryshon ka të bëjë me pagën e 13-të, pra që është paraparë jo në fund të vitit, por të bëhet në fillim të vitit.

Ndërkaq, çështja tjetër që është paraparë ka të bëjë edhe me ndryshimin apo mundësinë e ndryshimit të tabelave në ligj sa u përket dikastereve në momentin kur Qeveria e miraton Rregulloren e Qeverisë dhe bëhet definimi apo përcaktimi i ndarjes së detyrave dhe fushëveprimi të secilit prej dikastereve apo ministrive dhe kjo punë është lënë që të bëhet më

pastaj, pra përmes nenit 11, paragrafi 5 konkretisht. Sa i përket buxhetit në fjalë, pra është një buxhet që kufiri i shpenzimit është përafërsisht 4 miliard euro, apo 3 miliardë e 967 milionë euro, ndërkaq këto shpenzime mund të ndahen apo të zbërthehen në kategori kësisoj, pra: paga dhe shtesa 980 milionë euro, mallra dhe shërbime 545 milionë euro, subvencione dhe transfere 1 miliard e 358 milionë euro, si dhe shpenzime kapitale 998,4 milionë euro apo 897 milionë euro të financuara nga granti apo buxheti i rregullt, si dhe 100 milionë euro të tjera të financuara nga klauzola e investimeve.

Sa i përket burimit të financimeve, pra të hyrat buxhetore gjithsej janë 3,64 miliardë euro, nga të cilat hyrat tatimore janë 3,26 miliardë euro, ndërkaq të hyrat jotatimore janë 357 milionë euro. Pjesa e mbetur, pra e deficitit financohet apo është paraparë të financohet qoftë përmes huamarrjes apo mënyrave të tjera, siç janë grantet e përcaktuara nga donatorët dhe të ngjashme.

Sa i përket këtij buxheti, pra përveç atyre inputeve që kanë dhënë secila prej organizatave buxhetore, është paraparë, siç e thashë, që edhe paga e 13-të, të shtohet këtu. Është paraparë që përvoja e punës, pra siç e dini me Ligjin e pagave për 15 vitet e para është 0,25% për vit, të kthehet në 0,5% në vit, pra për të gjitha vitet, përfshirë edhe 15 vjetët e para. Gjithashtu, është paraparë edhe shtyrja e hyrjes në fuqi e normës progresive për tatimin në pronë, gjë për të cilën ka pasur diskutim.

Plani ka qenë që vitin e kaluar kjo gjë të bëhej, pra të ndryshohej ligji në konsultim me komunat. Megjithatë, duke pasur parasysh, siç e dini që Kuvendi nuk ishte funksional, një gjë e tillë u pamundësua. Prandaj, po e shtyjmë edhe një herë në mënyrë që këtë vit, pra të kemi reflektimin e një ligji të ri ku bëhet bashkë në konsultim me komunat, marrë parasysh që të hyrat nga tatimi në pronë të gjitha u shkojnë komunave.

Gjithashtu është e paraparë edhe neni që mundëson riaranzhimin e tabelave buxhetore, duke mos ndryshuar kufijtë, pra duke mos rritur kufijtë e shpenzimit. Pra, kufijtë mbeten ata që i miraton ky Kuvend, krejt çfarë bëhet është riaranzhimi i tabelave.

Pra, kjo është pak a shumë ajo çfarë përmban Ligji për ndarje buxhetore apo Projektligji për ndarje buxhetore, i cili, siç e thashë edhe një herë, vjen si arsye e emergjencës në mënyrë që shteti, në mënyrë që komunat, organizatat buxhetore të kenë një buxhet dhe të mund të vazhdojnë me punën e tyre në rrjedhë normale.

E ndërkohë, pastaj ne si Qeveri e re, por duke pasur parasysh edhe komunat që kanë nevojë për një rishikim, do ta sjellim rishikimin sa më shpejt që është e mundur potencialisht, pra në muajin e ardhshëm pasi që të ketë pasur reflektim edhe të dikastereve të Qeverisë, por edhe besoj komunat kanë nevojë që ta bëjnë një gjë të tillë, marrë parasysh ndryshimin e strukturës së asambleve komunale apo në disa raste edhe udhëheqjes komunale. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu i nderuar ministër Murati!

Tani është radha e Komisionit për Buxhet, kryetari i komisionit, zoti Enver Haliti, fjala për ju.

ENVER HALITI: Faleminderit, kryetare!

I nderuar nënkryetar,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere në bazë të nenit 74 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2026 shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 10/ L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 10/ L-001 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Arsyetim: Në bazë të nenit 74, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare, komisioni përgjegjës raportues e shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 10/ L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e këtij projektligji në parim. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar zoti Haliti!

Tani është radha e grupeve parlamentare, nga Lëvizja Vetëvendosje, shefja e Grupit Parlamentar, zonja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: E nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar nënkryetar,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot jemi më 16 shkurt dhe, sikurse e tha edhe ministri i Financave, ky debat do të duhej të ishte bërë para tetorit të vitit të kaluar. Duke pasur parasysh emergjencën në të cilën ndodhemi në mënyrë që të gjitha institucionet të funksionojnë në mënyrë të rregullt, duke pasur parasysh se detyra dhe obligimi ynë si deputetë është që të veprojmë në interesin më të mirë të qytetarëve, por edhe duke i shtuar kësaj faktin se ky është buxheti më i madh që ka pasur ndonjëherë Republika e Kosovës, e përtej kësaj se ky buxhet adreson kujdesin për të gjithë sektorët,

departamentet, për të gjitha shtresat e qytetarëve, duke adresuar edhe disa nga prioritetet e qeverisë, ne i japim mbështetje të plotë këtij buxheti, mbi të gjitha edhe për faktin se në afatin më të shkurtë të mundshëm, pra muajin e ardhshëm, do të mund të sillet buxheti i ri, i cili do t'i adresojë edhe çështjet që janë pjesë e programit qeverisës të Qeverisë Kurti.

Andaj, Lëvizja e mbështet këtë buxhet.

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci. Radha është e PDK-së. Zoti Hamza, fjala është për ju në emër të PDK-së.

BEDRI HAMZA: E nderuar kryetare e Kuvendit,

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Po e kuptoj rëndësinë që vendi të ketë buxhet dhe për asnjë arsye dhe në asnjë moment të mos ketë situata kur nuk mund t'i kryejë pagesat për të gjitha kategoritë.

Mirëpo, ne treguam vullnet të mirë edhe jam i bindur që kemi bërë mirë që kemi votuar vendimin për zgjatjen e shfrytëzimit të ndarjes buxhetore. Edhe sot treguam vullnet të mirë, sepse votuam që kjo pikë e rendit të ditës të vendoset sot, sepse kërkon shmangie prej procedurave dhe i kërkon 2/3 e votave të pranishmeve.

Nuk e kuptoj pse kjo urgjencë kaq e madhe, ne nuk duam edhe nuk lejojmë vonesa. Po, pse kjo urgjencë kaq e madhe? Po, vetëm dy arsye shkojnë ndërmend. E para, që t'i pamundësojmë deputetë pozitës dhe të opozitës që me diskutimet e tyre sigurisht se të shprehin edhe kritika, mirëpo të japin edhe propozime, edhe alternativa që sigurisht ndikojnë pozitivisht në këtë dokument kaq të rëndësishëm që po shqyrtojmë sot.

Dhe e dyta, nuk dua të besoj, sepse vendi ka nevojë për institucione, ka nevojë për stabilitet dhe nuk dua të besoj që kjo çështje lidhet me rastin e zgjedhjes së presidentit apo presidentes. Projektbuxheti i propozuar për vitin 2026 është buxhet që menaxhon status quon, kjo si rezultat i rritjes së shpenzimeve operative dhe posaçërisht të transferet dhe subvencionet. Kjo ndikon në rritjen e konsumit në periudhë afatshkurtër, por në periudhë afatgjatë si rritje e shpenzimeve rrjedhëse e zvogëlon hapësirën për investime kapitale. Këto shpenzime të rritura për subvencione dhe transfere e zvogëlojnë hapësirën fiskale për periudhat e ardhshme dhe sigurisht se do ndikojnë në pamundësinë e zgjerimit të bazës prodhuese dhe eksportuese.

Këtu vërehet që ka mungesë të investimeve për sektorët strategjikë në Republikën e Kosovës. Disa indikatorë të rëndësishëm makroekonomikë dhe financiarë tregojnë përkeqësim. Importet

në vitin 2025 kanë rritje 11,3% dhe kanë arritur në mbi 7 miliardë. Eksportet janë 942 milionë që shënon një rënie të lehtë prej 0,2% dhe kjo ka ndikuar në përkeqësimin e deficitit tregtar, ku deficitit tregtar për vitin 2025 e kalon shifrën e 6 miliardë eurove. Po, ka rritje të eksporteve vitet paraprake, jo në vitin 2025, ka rritje të importeve dhe ka përkeqësim të deficitit tregtar. Kemi një përkeqësim të mbulueshmërisë së importeve me eksporte.

Në vitin 2024, mbulueshmëria e importeve me eksporte ka qenë 18,1%, në vitin 2025 kjo ka rënë në vetëm 13,3% dhe kjo rritje e importeve është faktor, i cili ka ndikuar edhe në rritjen e të hyrave për buxhetin e Kosovës. Rritja ekonomike reale, përjashto vitin 2021, kur kemi pasur një rritje mbi 10% dhe kjo ka ardhur si rezultat pas një viti pandemik, vitit 2020, se s'mund t'i trajtojmë këto si të shkëputura njëra prej tjetrës, kur në vitin 2020 kemi pasur për herë të parë si Kosovë rritjen me normë negative prej 5,34%. Ndërsa vitet vijuese norma e rritjes ekonomike është sjellë aty diku rreth 4%, këtë vit, në fakt për vitin 2025 vlerësimet janë se norma reale e rritjes ekonomike do të jetë nën 4%.

Uroj që kjo të jetë më e lartë!

Likuiditeti në sektorin bankar është duke u përkeqësuar. Raporti kredi-depozita ka arritur diku te 90%. Ky raport ka ndikuar që të rritet norma e interesit në depozita. Rritja e normës së interesit në depozita automatikisht reflekton në rritjen e normës së interesi në kredi. Kreditë bëhen më të shtrenjta edhe për ekonomitë familjare, edhe për biznesin. Inflacioni vazhdon të rritet dhe sidomos kemi një rritje enorme të çmimit të energjisë, të ujit, të bukës, të qumështit, mishit dhe të gjithë artikujve të tjerë të shportës bazë dhe kjo ka ndikuar në përkeqësimin e standardit të jetesës qytetarëve të Kosovës.

Zoti kryeministër, ju në ditët e votimit të qeverisë e prezantuat një ekspozim. Kishte gjëra të nevojshme në atë ekspozë. Problemi qëndron që shumica prej tyre nuk janë të reflektuara në këtë buxhet, nuk janë të reflektuara as në vitin 2025, as për vitet vijuese dhe diçka çka s'e ka konstruksioni financiar jetë në nivel të projekteve ideore dhe presin ndoshta në një periudhë në të ardhmen që të realizohen. Ju premtuat pagë mesatare mbi 1 mijë euro dhe nëse shikojmë pagën mesatare për vitin 2024 në sektorin publik, është 668 euro.

Në vitin 2025 ka pasur rritje të pagës për një koeficient dhe themi që ka shkuar në 770 dhe për të mbërritur paga mesatare në sektorin publik mbi 1 mijë euro, duhet të ketë rritje të pagave për 30% dhe kjo në tabelën për vitin 2026, 2027 dhe 2028 nuk është reflektuar, sepse masa e pagave e mbulon pagën e 13-të dhe jo në tërësi dhe mbulon numrin apo vendet e reja të punës që planifikohen të hapen.

Shtesat për fëmijë, përkrahja për lehonat dhe kur e shikojmë pozicionin e subvencioneve dhe transfereve, e kemi një rritje prej 17%. Kjo është e mjaftueshme vetëm sa për të mbuluar koston

e rritjeve aktuale, nuk ka diçka mbi këtë kosto. U përmendën investimet në Trepçë, pa thënë a në miniera, a në minierat ekzistuese, hapjen e minierave të reja, kapacitetet e reja apo kapacitetet ekzistuese përpunuese përmes investimeve private, a duam që ta privatizojmë Trepçën? A duam që ta koncesionojmë, a kemi linja kreditore dhe nga i kemi linjat kreditore? Këto nuk kanë asnjë përgjigje në këtë dokument.

50 milionë euro për studimin e burimeve natyrore, asnjë cent në buxhet. Resortin e Dukagjinit, 500 milionë euro për Brezovicën. Qysh? Përmes investitorëve privatë? Kur? Përmes buxhetit? 100 milionë për investime për mërgatën, asnjë cent në buxhet. Rehabilitimi i Kosovës A dhe B, asgjë konkrete në buxhet. Projekte të kogjenerimit. Unaza e Prishtinës nuk është në buxhet.

Për më tepër, lëre që s'është në buxhet unaza e Prishtinës, por buxheti i Komunës së Prishtinës nuk është pjesë e këtij buxheti fare.

Po i drejtohen ministrit të Financave. Zoti ministër, për t'u bërë pjesë e buxhetit, na obligon edhe ky draftligj, të cilin po e diskutojmë, neni i gjashtë i tij, se thotë: "Një buxhet, i cili nuk është aprovuar në kohë apo nuk është aprovuar para se buxheti të aprohet...", dhe ky buxhet ende nuk është aprovuar.

Të lutem që të bëhet pjesë e këtij buxheti, sepse pavarësisht cila parti politike e udhëheq një komunë, e posaçërisht kryeqytetin, ka nevojë të përkrahet. Në asnjë mënyrë, të pengohet. Për disa çështje teknike, u fut buxheti në sistem a s'u fut.

Hapeni sistemin atje, jepuni pak më shumë kohë dhe bëjeni buxhetin e Komunës së Prishtinës pjesë të buxhetit.

Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike. Ky ka qenë një program, i cili për herë të parë është futur gjatë pandemisë Covid. Po vazhdon! Kontingjencat në Ministrinë e Financave janë rreth 80 milionë. Kjo është edhe ndërhyrje në kompetencën e Kuvendit. Kuvendi nuk mund t'i japë autorizim....

Që ka mundësi edhe një minutë, ta di për nder!

KRYETARJA: Po, urdhëroni z. Hamza, edhe një minutë sa për ta përmbyllur fjalën!

BEDRI HAMZA: Nuk ka mundësi 80 milionë të jenë pjesë e buxhetit dhe të autorizohet një ministër, i cili t'i ndajë sipas rasteve.

Në të kaluarën rezerva buxhetore ka qenë 10 milionë, dhe ka qenë pesë milionë shpenzime rrjedhëse, pesë milionë shpenzime kapitale. Sot, përtej rezervës po flasim, janë edhe disa të tjera

që janë nëpër ministri të tjera, po kjo është 80 milionë; për 80 milionë, të cilat ky Kuvend nuk di, nuk e ka informacionin për çka do të përdoren.

Kemi dëmet në bujqësi; tre milionë për t'i mbuluar dëmet në bujqësi është pak.
Stadiumi i futbollit, është pak.

Kompleksi Adem Jashari, shumë simbolike.

KRYETARJA: Faleminderit, z. Hamza! Tani është radha e Lidhjes Demokratike të Kosovës.
Deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të institucioneve,

Të nderuar qytetarë,

Të premten kërkuam dhe besoj u dakorduam që, në njërën anë, deputetëve të Kuvendit të Kosovës t'u jepet më tepër kohë për të trajtuar një dokument shumë të rëndësishëm, gati 700-faqësh, sikurse ky i buxhetit, më voluminozi që mund ta ketë Kuvendi i Kosovës. Po, edhe në anën tjetër, që t'i jepet kohë Qeverisë të sjellë një dokument të ri, me tri reflektime kryesore, jo përmbajtjesore, por shumë elementare.

E para, të reflektojë strukturën e kabinetit qeveritar, pra të ministrive, që katër ministri të reja të kenë edhe buxhetin e tyre dhe ky buxhet t'u ndahet jo nga ministri i Financave ministrive të tjera, por nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

E dyta, që buxheti të reflektojë ekspozenë që e prezantoi Kurti ditën e formimit të Qeverisë, në mënyrë që ato zotime të dhëna të mos jenë vetëm fjalë, po të kenë kuptim të vërtetë. Në, të kundërtën, një ekspozë pa buxhet mbetet vetëm një platformë e fjalëve të thata që duket jobefasueshëm do të jetë sërish rasti këtu.

Dhe e treta, shumë e rëndësishme për ne, për Lidhjen Demokratike të Kosovës, siç e kemi parë fatkeqësisht shumë më pak e rëndësishme për ju, që buxheti i Kosovës të reflektojë ligjshmërinë dhe kushtetueshmërinë. Fjalën e kam për buxhetin e Kryeqytetit.

Paradoksalisht, ky buxhet i Kosovës nuk e merr parasysh buxhetin e kryeqytetit të vet. Është jo vetëm e habitshme, por jashtëzakonisht shqetësuese se si Kuvendit i sillet një dokument që s'e respekton vendimarrjen autonome të kryeqytetit të vet, dhe së këndejmi menjëherë bëhet jokushtetues.

Sa për rikujtim, Prishtina, kryeqyteti ynë, e ka miratuar buxhetin e saj më 6 shkurt të vitit 2026. Buxheti i Kosovës është sjellë në Kuvendin e Kosovës për herë të parë më 13 shkurt të vitit 2026.

Mos i ngatërmoni gjërat me legjislaturën e kaluar. Kjo është legjislaturë e re e Republikës së Kosovës.

Nuk ka asnjë arsye as ligjore, as logjike, as kushtetuese që një buxhet nacional të mos marrë parasysh vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës. Sikurse jemi mbledhur ne këtu në Kuvend për të vendosur mbi diçka, edhe asambleja lokale e kryeqytetit ka shprehur vullnetin e popullit të Prishtinës për ndarjet e buxhetit të vet. Pra, ka vendosur për buxhetin e vet. Ne nuk kemi as autoritet, as s' duhet të kemi vullnet ta bllokojmë kryeqytetin e Kosovës.

Madje, veç mendja të na shkojë për ta bërë një gjë të tillë, është luajtje me fatin e mijëra e mijëra punëtorëve, mijëra e mijëra familjeve, e mbi të gjitha qindra-mijëra banorëve që janë lodhur nga kjo përplasje e panevojshme.

Prandaj, për LDK-në është jo vetëm e rëndësishme që zotimet e dhëna për Prishtinën t'i realizojmë në tërësi ne që e kemi marrë besimin aty, por edhe e domosdoshme që të kuptojmë relacionin që do të ketë LDK-ja me këtë Kuvend. Nëse LDK-së i mohohet nga ky Kuvend një e drejtë kushtetuese vetëm nga vullneti i numrave shumicë, atëherë edhe LDK-ja do ta ridefinojë pozicionin e saj në relacion me çështjet që kërkojnë dhe numrat tonë në këtë Kuvend.

Tani më lejoni që të shpreh dhe qëndrimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës për përmbajtjen e këtij dokumenti që na është prezantuar. Këto qëndrimet tona nisen nga një realitet i thjeshtë, sa është edhe shqetësues për brezin tonë, për gjeneratën tonë; realiteti se Kosova është vendi më i varfër në Evropë dhe ky buxhet i vendit më të varfër në Evropë vazhdon të jetë fatkeqësisht pa ambicie, dhe si i tillë, do të vazhdojë ta mbajë Kosovën si vendin më të varfër në Evropë. Na ndodh kështu, sepse në vend të njohjes së gjërave bazike ekonomike, Qeveria po i fsheh ato, pra refuzon t'i njohë. Përkundrazi, i përdor shpesh edhe si pamflet suksesi në Kosovë. Dhe, janë tre indikatorë kryesorë ekonomikë në vend, tri të vërteta që e përcaktojnë shëndetin e një ekonomie. Ato s'mund të fshihen asnjëherë. E para është inflacioni, e dyta është deficitit tregtar, e treta është rritja ekonomike.

Nga ekspozeya e kryeministrit ditë më parë dëgjuam për buxhet rekord prej 3.9 miliardë eurosh dhe natyrisht krahasueshëm shumë më shumë se viti 2021. Por të flasësh për euro, për para, për të hyra, pa e përmendur gjënë më të rëndësishme, fuqinë reale të tyre, pra e përmendur inflacionin, është sa gabim politik, aq edhe qëllim propagandistik. Sa për rikujtim, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, e cila për kureshtjen e secilit, gjendet si pjesë e Zyrës së Kryeministrit, pra sipas dhënave zyrtare të vetë Qeverisë, nga dita e parë e qeverisjes së

Vetëvendosjes e deri më sot inflacioni në Kosovë është plot 30%, është rritja më e madhe kumulative në gjithë historinë e Republikës së Kosovës.

Kuptojeni, paraja para pesë vjetësh ka qenë për 30% më e vlefshme se sa që është sot. Paraja, numrat, eurot, secila prej tyre kanë vlerë sot 30% më pak se sa pesë vjet më parë. Së këndejmi, çdo numër, çdo vlerë buxhetore, çdo e hyrë apo çdo shpenzim sot është 30% më pak i vlefshëm se sa në vitin 2021. Thënë këtë, 3.9 miliardë euro sot, me inflacionin prej 30%, janë rreth 2.9 miliardë euro të vitit 2021. Pra, një miliard euro më pak në vlerë. Kaq kanë vlerë këto 3.9 miliardë euro. Asokohe, në vitin 2021 buxheti i Kosovës ka qenë 2.6 miliardë euro, që i bie se në esencë, për pesë vjet, ju e keni rritur buxhetin e Republikës në terma realë për vetëm 300 milionë euro.

E vërteta e dytë e madhe është se politikat tuaja, këto që po i prezantoni në buxhet, po e gërryejnë nga brenda bazën prodhuese të Kosovës. Këto politika si të buxhetit që prezantohet sot, nuk po japin rezultat ekonomik. A jemi të vetëdijshëm se për pesë vjet, deficitit tregtar i Kosovës është thelluar nga 3 miliardë euro në plot 6 miliardë euro brenda vitit?

Pra, kur i përmendim eksportet me plot mburrje se po rriten, duhet patjetër t'i përmendim dhe importet dhe rritjen shumë më të madhe të tyre. E kur t'i përmendim se sa shesim e blejmë, gjënë e vetme që në fund një ekonomist, po mbi të gjitha një politikan duhet ta bëjë, është të llogarisë se sa është kjo diferencë. 6 miliardë euro në vit është kjo diferencë. Ka qenë 3 miliardë euro pesë vjet më parë dhe ky 3 miliardë euro atëherë ka qenë kauza kryesore ekonomike e secilës alternativë politike, përfshirë edhe tuajën, sepse 3-miliardëshi ka qenë alarmant.

Sot, me 6 miliardë euro është kolaps. E kuptoni se këtu s'ka më ekonomi? S'mund të flasësh më për ekonomi. E kuptoni se për 10 vjetët e ardhshëm, minimalisht kjo Kosovë me këtë trend do t'i largojë nga 60 miliardë deri në 80 miliardë euro; nga 16 milionë euro në ditë i bie. Vetëm sot, në këtë ditë, në këtë të hënë, do ta mbyllim ditën me 16 milionë euro diferencë mes blerjeve nga jashtë dhe shitjeve jashtë. Dhe a e dini pse e kemi këtë diferencë norme? Sepse kemi pikërisht buxhet që administron, e jo që zhvillon, sikurse ky që na prezantohet sot.

Buxheti juaj e injoron prodhimin vendor, e injoron industrinë, e injoron në tërësi investimin. Buxheti blen paqe sociale dhe nuk ka fare ambicie për të ardhmen. Si ta quash ndryshe një buxhet që, besoni ose jo, projektin më të madh kapital qendror e ka në vlerë prej 20 milionë eurosh. Ja ku kemi mbërritur! Projekti më i madh kapital i një shteti brenda një viti në vlerë prej 20 milionë eurosh. Në 10 projektet më të mëdha kapitale qendrore është edhe ndërtimi i ndërtesës së institucionit të Shtimes.

Në një buxhet zhvillimor të vërtetë, top 10 projektet e një shteti do të ishte unaza e kryeqytetit, centrali me gaz, spitali i ri, parku teknologjik, Brezovica dhe nuk janë asnjëra nga këto. Projekti më i madh për një vit është 20 milionë euro.

Ku të zhvillohemi më pas me këtë buxhet? Përveç se nuk janë investimet kapitale, që fundja, nuk ishte as disa ditë më parë që u përmend këtu në këtë foltore, nuk janë as reformat thelbësore. Në këtë buxhet nuk është as mësimi tërëditor e as edukimi i hershëm për fëmijë, as reforma me spitale të reja shëndetësore, sigurime shëndetësore e as kapacitete të reja energjetike. Merreni me mend! Jemi para kolapsit energjetik. Ky buxhet nuk ka asnjë investim që e ndryshon këtë kolaps. Do të vazhdojmë të blejmë nga 250 milionë euro në secilin vit, e s'i kemi 250 milionë euro për të ndërtuar një bllok të ri apo një kapacitet të ri. Nuk ka investime as në turizëm, as në Brezovicë, e as në Dukagjin. Pra, asnjë projekt që ka e lë shenjë për zhvillim.

Dhe, se pse është kështu, sepse kjo logjikë nuk ekziston në vendimmarrje shtetërore, na kthehet si rumbullakim një rritje ekonomike prej 4% dhe kjo rritje sërish na paraqitet si sukses.

KRYETARJA: Një minutë, të lutem, për ta përmbyllur fjalën! Keni përfaqësuesit nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Shpërndajeni fjalën me të tjerët!

LUMIR ABDIXHIKU: Ju faleminderit!

Dhe kjo rritje sërish na paraqitet si sukses historik. Na thuhet vazhdimisht siç na është thënë edhe më parë se rritja jonë është rritja më e madhe në rajon. Sa për rikujtim, në 14 prej 16 vjetëve të fundit, Republika e Kosovës e ka pasur rritjen më të madhe ekonomike në Ballkanin Perëndimor.

Pra, për 14 prej 16 vjetëve të fundit, rritja ekonomike e Kosovës më të varfër në Evropë është rritja më e madhe se secili shtet në Ballkanin Perëndimor. Dhe a e dini pse është kështu? Sepse e kemi bazën e ulët ekonomike. Në bazë të ulët ekonomike, rritja s'do të thotë asgjë. Një njeri që e ka një euro, i bën dy, ka rritje prej 100%. Një tjetër që ka 1 000, i bën 1 500, ka vetëm 50%. Tani cili qenka më mirë? Ai që ka shtuar vetëm 1 euro e thotë jam rritur 100%, apo ky që ka shtuar 500 euro dhe thotë se jam rritur vetëm 50%. A e kuptoni se ky krahasim s'ka asnjë rëndësi?

KRYETARJA: Faleminderit, z. Abdixhiku!

Do të keni mundësi të tjera. Kuvendi është për të debatuar, por që e kemi një rregullore, të cilën duhet ta respektojmë.

Radha është e Listës serbe. Zoti Simiq!

IGOR SIMIĆ: Hvala predsedavajuća!

Poštovane kolege poslanici,

Kao Poslanička Grupa, mi smo detaljno analizirali ovaj nacrt budžeta koji je usvojila vlada i prosledila Skupštini.

Hoću da kažem da postoji puno prostora za negativne komentare i kritike. Ono što posebno želim da kažem jeste da postoje negativni komentari i kritike na usvojene budžete u četiri opštine na Severu, u Leposaviću, u Zvečanu, u Zubinom Potoku i u Severnoj Mitrovici.

Dakle, budžeta koje su usvojile nelegalne i nelegitimne skupštine u prošloj godini, koje nisu usvojene na jedan transparentan način i takođe javne rasprave u tim opštinama sa lokalnim stanovništvom nisu vođene na jedan transparentan način, tako da ti budžeta ne odražavaju zaista potrebe lokalnog stanovništva po pitanju kapitalnih investicija i mi danas ne možemo pozitivno, naravno, da se deklariramo na ovaj nacrt budžeta. Bićemo uzdržani i svakako ćemo kao poslanička grupa dati svoj doprinos u funkcionalnim stalnim komisijama, gde ćemo predložiti i adresirati amandmane koji se tiču kapitalnih investicija u opštinama sa srpskom većinom. I kako bude odnos prema tim amandmanima od strane poslanika u skupštinskim odborima, takvak će i naš odnos biti u buduću prema ovom nacrtu zakona. Hvala!

KRYETARJA: Tani vazhdojmë me Grupin Multietnik.

Kush është paraqitur? Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se uvažena predsednice parlamenta, gospođo Hadžiju!

Uvaženi premijeru Vlade Republike Kosovo, gospodine Kurti,

Poštovani ministri,

Kolege narodni poslanici,

Pred svega dozvolite mi da povodom Dana Aškalija uputimo iskrene čestitke svim pripadnicima aškaliske zajednice ovde na Kosovu, uz želju da dalje društveni napredak, ravnopravnost i snažni institucionalno učešće u svim segmentima javnog života naše države.

Poštovani građani,

Pred nama je jedan od najvažnijih strateških dokumenata, budžet Republike Kosovo za 2026. godinu, projektovan na nivou približno od 4 milijarde evra koji definiše pravce razvoja države, institucionalne prioritete i socijalno-ekonomsku politiku za naredni period.

Ovaj budžet nije samo zbir finansijskih stavki, već operativni instrument jedne javne politike koji treba da obezbedi stabilnost, razvoj i ravnopravnu raspodelu resursa među svim građanima u svim zajednicama na Kosovu. Njegova struktura jasno pokazuje fokus na socijalnu sigurnost, ekonomski rast, kapitalne investicije i razvoj lokalnih sredina.

Posebno želim naglasiti da budžet predviđa ulaganja kroz kategorije subvencija, transfera i kapitalnih investicija koje su usmerene ka unapređenju uslova života, otvaranju radnih mesta i jačanju lokalne ekonomije, što predstavlja ključni mehanizam razvoja države i društva u celini.

U ime Multietničke Poslaničke Grupe važno je istaknuti i dimenziju inkluzivnosti ovog našeg zajedničkog budžeta. Dokument jasno prepoznaje potrebu za ulaganjima u sredine u kojima žive nevećinske zajednice kroz posebne programe i projekte za žene i mlade. U okviru budžeta predviđene su investicije preko lokalnih kancelarija za zajednice, kao infrastrukturni projekti namenjeni sredinama u kojima mi živimo, te čine značajni deo stanovništva te lokalne samouprave, uključujući projekte prilagođavanja infrastrukturne projekte za razvoj lokalnih zajednica.

Dame i gospodo,

Budžetske linije obuhvataju i kapitalna ulaganja na opštinskom nivou, gde su projekti usmereni za razvoj ekonomije, infrastrukture, lokalnih usluga i socijalnih programa, uključujući programe koji direktno targetiraju potrebe zajednica i njihovu integraciju u razvojne tokove naše države. Od Leposavića, preko izgradnje škole u Dobruši, Prizrena do investicija u Mamuši i Dragašu. Ovo je značajan iskorak, jer prvi put u ovakvom obimu vidimo sistematski pristup razvoju nevećinskih zajednica i sredina kroz infrastrukturne projekte, programe subvencija, institucionalnu podršku, što doprinosi ravnomernom regionalnom razvoju i društvenoj koheziji u celini.

Istovremeno, budžet snažno adresira socijalnu politiku, povećanje podrške penzionerima, dodatke za decu, podršku svim domaćinstvima, kao i unapređenje sistema socijalne zaštite. To su direktne mere koje utiču na standard svakog našeg građanina. Ekonomski segment budžeta otvara prostor za razvoj start ap biznisa, poljoprivrede i turizma, znanstva, malih i srednjih preduzeća kroz subvencije i razvojne šeme, što predstavlja osnovu za održivi rast i otvaranje novih radnih mesta. Ulaganje u obrazovanje, renoviranje škola, razvoj kulturnih programa i očuvanje kulturnog nasleđa svih zajednica dodatno potvrđuju inkluzivni karakter budžeta i njegovu usmerenost ka dugoročnom razvoju našeg društva.

Poštovani građani, ovaj budžet jasno pokazuje da postoji prostor za sve, za socijalne kategorije, za mlade, za privredu, za lokalne zajednice i za nevećinske zajednice koje moraju biti deo razvojnih politika države u svim opštinama gde mi živimo. Multietnička parlamentarna grupa smatra da je predloženi budžet razvojno orijentisan, socijalno odgovoran, institucionalno stabilan dokumentat koji omogućava implementaciju konkretnih projekata u interesu svih zajednica, a naše zajedničke projekte, s obzirom da smo upravo preuzeli mandat za svaku zajednicu ponosob, uvrstićemo u rebalansu budžeta za 2026. godinu. Poštovane kolege poslanici, zbog toga, u prvom čitanju, u ime multietničke poslaničke grupe, izražavam podršku budžetu Republike Kosova za 2026. godinu i potvrđujem da ćemo glasati za njegovo usvajanje. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit po ashtu, e nderuar zonja nënkryetare Rexhepi!

Më lejoni që t'i bashkohem edhe unë urimit tuaj për ditën e komunitetit ashkali dhe po ashtu falënderoj komunitetin ashkali për kontributin që ka dhënë për shoqërinë tonë, por edhe për Republikën e Kosovës.

Tani e ka fjalën z. Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Mbasi e nisëm me urime, edhe unë po e uroj komunitetin e ashkalive për ditën e tyre.

Të nderuar deputetë dhe deputete,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar media,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës unë do të bëj një vlerësim të këtij buxheti prej dy perspektivave; prej asaj politike dhe prej asaj teknike, për shkak se mendoj që të dyja e kanë vlerën e vet në mënyrë që qytetarët e Kosovës të njoftohen me çfarë dokumenti jemi duke e trajtuar dhe me cilin buxhet në fakt do të operojë Kosova këtë vit.

Të nderuar deputetë,

Ky buxhet që e keni përpara është miratuar në Qeverinë në detyrë më 12 shkurt të vitit 2026. Po esenca është që ky buxhet është miratuar më 31 tetor të vitit 2025 më herët dhe në tabelat në të cilat përshkruhen vijat buxhetore, projektet kapitale, buxheti për mallra dhe shërbime është i njëjti.

Pra, çka dua t'u them qytetarëve të Kosovës? Qeveria e Kosovës ka mrizuar, nuk ka bërë asnjë veprim mbi programin politik, e as mbi rezultatin zgjedhor, për të sjellë një buxhet para nesh me ndryshime që ishte dashur të reflektohen edhe në ekspozenë që e paraqiti kryeministri, por dhe në synimet strategjike. Pra, jemi duke folur për një buxhet provizor, për një buxhet për disa muaj. Jemi duke folur për një buxhet që për pak muaj do t'i nënshtrohet një rishikimi, në vend se ky rishikim të kishte ndodhur në një kohë të caktuar kur këta ministra, kur ministri aktual që ka qenë ministër i Financave dhe që është tash do të duhej të reflektonte mbi planet strategjike që i ka. Pra, mos harroni! Jemi duke folur për një buxhet, i cili nuk reflekton aspak në asgjë që është premtuar këtu nga ekspozerja e kryeministrit.

Çështja e dytë politike ndërlidhet me investimet kapitale. Në qoftë se e shihni me kujdes buxhetin dhe vijat buxhetore, ne jemi duke folur për 81% të investimeve kapitale që janë projektet që vazhdojnë, jo që ka iniciativa të reja. Përderisa në ekspozenë e kryeministrit, ne dëgjuam bukur shumë iniciativa të reja, bukur shumë projekte të mëdha politike që pak më vonë do t'i trajtoj.

Çështja tjetër që duhet ta dijë qytetari i Kosovës që po më dëgjon, kur flet dikush thotë ky është buxheti më i madh i Republikës së Kosovës. Ju lutem, për katër vjet në këtë seancë, unë kam dëgjuar që gjithmonë kanë thënë se “ky është buxheti më i madh”, se është rrjedhë normale, është procedurë standarde që shteti normal që ka pak rritje ekonomike, e rrit buxhetin për ndopak. Pra, nuk është kurrfarë lavdi të thuhet ky është buxheti më i madh. Me sa di unë, në historinë e Kosovës vetëm në pandemi nuk ka ndodhur. Pra, këto janë tri aspekte politike.

Dhe, e fundit, e katërta, secili shtet dhe kjo Qeveri e ka një dokument strategjik që quhet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve. Kjo është një kornizë që e drejton buxhetin, planifikimin buxhetor të të hyrave në një afat afatmesëm kohor. Ky buxhet nuk është në vijë me KASH-in. Pra, nuk është në vijë me dokumentin orientues që e ka Qeveria.

Tani për shkak të kohës më duhet me i cek disa çështje që ndërlidhen me ekspozenë e kryeministrit. E para, kur e shihni pikën 224 që flet për fondin e sigurimeve shëndetësore, buxheti i përcaktuar këtu është 10 milionë 834 mijë euro. Më fal, qysh bëhet sigurimi shëndetësor me këtë vijë buxhetore? A më tregon mua dikush? Qysh arrin me zbatimin në këtë vit të premtimit më të madh të kësaj Qeverie për sigurimet shëndetësore? Pra, me 10 milionë euro kjo nuk bëhet. Kjo është e para.

E dyta: U fol shumë për investimet në ushtri, për investimet në sektorin e sigurisë. Investimet për vitin 2026 në raport me investimet kapitale në ushtri të vitit 2025 dallojnë jo më pak se 2 milionë euro. Qysh blihen bre krejt ato armatime? Krejt ato zotimet që janë bërë. Qysh me 2 milionë euro më shumë? Pra, jemi duke folur për një buxhet që absolutisht nuk reflekton me një zotim politik dhe me atë që është synimi strategjik i kësaj Qeverie.

Çështja tjetër kur flasim prapë për sektorin e sigurisë. 24 milionë euro ka investime kapitale te Policia. Vetëm 24 milionë euro! Pra, për çfarë forcimi të rendit dhe ligjit po flasim me këto të dhëna buxhetore?

Shkojmë tutje, flasim pak për sektorin publik. Buxheti për vitin 2026 parasheh një rritje të fondit të pagave në sektorin publik për 6,7%. Përderisa rroga e 13-të vetëm në vete i ka 8%. Pra, paska paga për ta dhënë rrogën e 13-të! Më fal, paska buxhet për ta bërë rrogën e 13-të, por nuk paska buxhet për një rritje normale shtetërore, e cila reflekton mbi bazë. Jemi duke folur për standarde, për një lojë të gjuhës, e cila absolutisht nuk reflekton kodin e funksionimit të sistemit publik.

Çështja tjetër: Po, në Ligjin për buxhet, në pikën 4 dhe 5, te faqja 11, është reflektuar Kabineti qeveritar që është i përbërë prej 21 anëtarëve, respektivisht 19 ministrive. Mirëpo, këtu është një problem i madh, ministër Murati. Ia ke lënë diskrecionin secilit ministër në ministrinë përkatëse me një vendim, pasi të miratohet Rregullorja e punës së Qeverisë, të bëjë bash çka të dojë, si të dojë mund ta vizatojë buxhetin e ministrisë së vet.

Po, po këtu e ke! Shikoje te pika 3 dhe 4, ministër! Shikoje, është interesant. Pika 5. Ky është fondi qysh e ke bërë copy paste këtu. Tjetër fond është këtu pika 4 dhe 5, tjetër fond është këtu në buxhet. Bile këto të kesh pak kujdes kur t'i transferoni se është dokument shtetëror. Pra, duhet pasur bukur shumë të dhëna ne në rishikim, pra më fal, në amendamentim këto 3-4 ditë se çka do të ndodhë me këtë. Për arsye se në qoftë se e lëmë atë diskrecion, atëherë po e lëmë një hapësirë të madhe për manipulim politik.

Dhe e fundit lidhet me shkencën, me universitetet, me bazamentin e vendit. Shikoni! Universitetet publike, do të thotë s'kemi asnjë cent për investime në infrastrukturë, apo asgjë tjetër. Kur shohim për në arsim dhe shkencë kemi jashtëzakonisht pak për vitin 2026 në këto kode. Dhe, e fundit, ku është teknologjia informative, ku është inteligjenca artificiale, ku janë progreset inovative dhe, mbi të gjitha, ku është investimi për energji? Mbi cilin fond, mbi cilin projekt, mbi cilin dokument strategjik?

Ne nuk e mbështetim këtë dokument. Ne e shohim bukur të rëndësishme një çështje për fund. Këto 2-3 ditë që i kemi përpara deri të premtën, në qoftë dot ë vazhdojmë të mos kemi mundësi që ta japim asnjë amendament, unë propozoj që ne ta bojkotojmë procesin diskutimit të buxhetit, për shkak se ky buxhet mund pak të forcohet për disa muaj vetëm në qoftë se me të vërtetë arrihet një konsensus për të bërë amendamente të sakta në këtë buxhet. Përndryshe, ky nuk është buxhet i këtij viti, është buxhet i 31 tetorit. Ju faleminderit!

KYRETARJA: Faleminderit, zoti Tahiri! Fjalën e ka kryeministri Albin Kurti. Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Ju faleminderit, e nderuara kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,

Të nderuar kolegë nga Qeveria

Së pari më lejoni që t'ju falënderoj për votimin me mbi 2/3 e Kuvendit të Republikës të Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian, i cili ka një vlerë të gjithmbarshme prej 882,6 milionë euro, nga të cilat afro 30% janë grante, ndërkaq pjesa tjetër janë kredi, përfshirë natyrisht edhe votimin që u bë në javën që lamë pas për tri marrëveshjet ndërkombëtare me Bankën Botërore, në shumën e përgjithshme prej mbi 120 milionë euro, që kështu atë ditë e bënë ditë mbi 1-miliardëshe për Republikën tonë të përbashkët. Pra, faleminderit të gjithëve për këtë!

Ashtu siç e parasheh Ligji për financat publike, brenda vitit 2025, brenda tetorit të vitit 2025, saktësisht më 31 tetor 2025, në mbledhjen e Qeverisë, ne e patëm miratuar buxhetin për vitin 2026, që është dashur të bëhet diskutim e aprovim në nëntor e në dhjetor të vitit që e lamë pas, por siç e dimë, Legjislatura IX përfundoi ashtu siç përfundoi. Patëm zgjedhjet e parakohshme të lira, të ndershme, demokratike. Tash kemi Kuvend të Legjislaturës X, kemi Qeveri të re.

Andaj, edhe e bëmë një mbledhje të re të Qeverisë, në mënyrë që të vijmë me buxhetin për vitin 2026 te ju, por i cili nuk mund të jetë i ri ashtu siç është përbërja e Kuvendit dhe ashtu siç është Qeveria e re.

Zotimet që i kemi thënë në fushatën e fundit, natyrisht që janë të përmbledhura në ekspozenë që kam bërë më 11 shkurt kur u rizgjodha kryeministër, por para se ajo ekspozë të shndërrohet në buxhet të ri duhet të vijë te ju Programi qeveritar. Pra, do të ishte jo normale që ne këtu të sjellim tash buxhet në përputhje me ekspozenë, pa e sjellë paraprakisht Programin qeveritar.

Rendi logjik i gjërave për nga kronologjia është kështu. Pra, zotimet në fushatë, ekspozetja e kandidatit për kryeministër, programi i ri qeveritar dhe më pastaj rishikimi i buxhetit. Në këtë buxhet që e kemi prezantuar te ju, natyrisht që kryefjala është shifra prej afro 4 miliardë euro, ku 1/4 apo rreth 1 miliard euro janë buxhetuar për investime kapitale. Natyrisht risi, por tashmë e paralajmëruar e këtij buxheti është paga e 13-të për gjithë punonjësit e sektorit publik. Pra, kush punon 12 muaj në sektorin publik i merr 13 paga dhe kjo sivjet nuk do të jetë në fund të vitit, por në pranverë.

Gjithashtu, është i përfshirë edhe zbatimi i rritjes së pagës bazë me 0,5% për çdo vit përvojë pune, për dallim të asaj që kemi pasur më herët, ku për 15 vitet e para zbatohet rritja vetëm 0,25% për çdo vit përvojë pune. Pra, kemi dyfishim të shtesës së përvojës së punës. Kjo përkthehet në rritje për pagën e secilit që punon në sektorin publik, varësisht nga vitet e përvojës së punës.

Buxheti 2026 përfshin edhe rritjen e pensioneve, të shtesave për fëmijë, të shtesave për lehonë, pagesave për të rinj dhe për gratë që angazhohen nga Super-Puna, kompletim i reformës së asistencës sociale, e shumë e shumë mbështetje të tjera për familjet.

Synimi ynë vjen nga orientimi ynë, rritjen të mos e mbajmë për shtet, por ta shpërndajmë në shoqëri dhe shpërndarja e rritjes ekonomike, shpërndarja e mirëqenies, përveç se e zvogëlon pabarazinë, njëkohësisht edhe e rrit kërkesën agregate në ekonomi që natyrisht që është mirë, jo vetëm për familjet në Kosovë, por edhe për ekonominë e shtetit.

Me këtë buxhet rritet mbështetja për barna esenciale, por gjithashtu dhe mbështetja për kulturën e sportin. Rritet mbështetja për ndërmarrësit dhe për sektorin privat e për bujqit, por rritet buxheti edhe për investime në infrastrukturë publike. Por, para së gjithash, në këtë buxhet sigurohet qëndrueshmëria dhe vijimësia e shtetit tonë dhe e zhvillimit të tij.

E kur jemi te investimet kapitale, vit i parë rekord ishte viti 2023 kur shpenzimet kapitale ishin 561 milionë euro. Pastaj 654 milionë euro ishin në vitin 2024. Ndërkaq, në vitin që lamë pas 2025, investimet kapitale gjithsej nga Qeveria e Republikës ishin 720 milionë euro. E siç e

prezantoi ministri i Financave, Hekuran Murati, me buxhetin 2026 kjo i afrohet 1-miliardëshit. Pra, synimi ynë është që 1 miliard të jetë dyshemeja e investimeve kapitale në mandatin katërvjeçar në vijim.

Ne këtu u kritikua që ky është buxhet i status quo-s. Pjesërisht besoj që u përgjigja me faktin që ne duhet ta sjellim Programin qeveritar njëherë dhe më pastaj rishikimin e buxhetit. Mirëpo, në anën tjetër, duhet ta pranojmë bashkërisht që nëse dikur stabiliteti ka qenë progres, tash kemi progres stabil. Pra, është njëfarë kalimi cilësor prej stabilitetit si progres, te progresi stabil. Me ç'rast rritja ekonomike së paku 4%, natyrisht që është stabile dhe një këso lloj rritje stabile nuk është status quo e keqe.

Për sa i përket rritjes së importeve, ajo vjen jo vetëm nga rritja e fuqisë blerëse, sepse siç thashë më herët ne e kemi rritur kërkesën agregate me këtë shpërndarje jo pak te ata që kanë më pak është bërë shumë. Dhe, kjo vjen gjithashtu edhe nga fakti që është eliminuar kontrabanda.

Janë 37 rrugë ilegale që janë mbyllur anembanë Kosovës, prej tyre 27 në veri të Kosovës. Eliminimi i kontrabandës natyrisht që ka kontribuar në rritjen e importit, përveç rritjes së fuqisë blerëse, ku një pjesë e konsiderueshme janë mallra të cilat vijnë nga jashtë.

Është e vërtetë që ka pasur rritje të çmimeve të produkteve bazë, por ato do të kenë tavan së shpejti. Ju e dini që ne kemi propozuar Ligjin për çmime tavan për produkte bazë, i cili ka pasur një adresim në formë të ankesës nga opozita në Gjykatën Kushtetuese dhe më pastaj është rrëzuar. Ne do ta risjellim Ligjin për çmime tavan për produktet bazë dhe në këtë mënyrë do ta frenojmë abuzimin me çmime.

Ne nuk jemi kundër fitimit të korporatave, por jemi kundër super-profitit në kurriz të qytetarëve, që paraqet abuzim me mirëqenien e popullsisë mbarë.

Fitimi i korporatave është rritur në Kosovë. Në qeveritë e mëhershme kurrë nuk e ka mbërri 1 miliard. Nëse s'gaboju, viti 2018 është viti më i mirë me rreth 950 milionë. Ndërkaq, vitin që lamë pas fitimi i korporatave është 2,2 miliardë. Pra, prej më pak se 1 miliard në 2,2 miliardë. Pra, 120% rritje e fitimit të korporatave, që e dimë nga të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, sepse paguajnë 10% tatim aty, dhe vetëm shumëzime me 10, dhe e kupton sa ka qenë fitimi i korporatave në sektorin privat.

Tjetra që dua të theksoj është se u tha që ky është buxhet i vendit më të varfër në Evropë. Buxheti është afro 4 miliardë. Kur e kam marrë detyrën në vitin 2021, buxheti i trashëguar nga Qeveria paraprake ka qenë 2,4 miliardë, që i bie një rritje prej 2/3-ave. Dhe, rritja ekonomike kur ne flasim është rritje reale, nuk është rritje nominale, është rritje pasi hiqet inflacioni. E kush e ka

shumë hall inflacionin, ju lutem që ta mbështetni ligjin që do të vijë së shpejti këtu për çmimet tavan për produktet ë bazë.

Pra, rritja është reale. Dëshirojmë edhe më shumë, edhe më shpejt, por kjo rritje e buxhetit për 2/3 për pesë vjet natyrisht nënkupton që ne jemi të Kosovës, dhe Kosovën e rritim. Nuk e rritim ndonjë shtet tjetër në Evropë. Kosovën të tillë siç e kemi gjetur me buxhet vjetor 2,4 miliardë më 2021, tash e kemi sjellë në 4 miliardë, që besoj se është një rritje e pamohueshme.

Në fund, më duhet t'ju kërkoj falje që më duhet të shkoj e të rikthehem pas rreth një ore, meqenëse Banka Qendrore e Kosovës dhe Banka e Shqipërisë e kanë një organizim të përbashkët se tash është 100-vjetori i Bankës së Shqipërisë, dhe unë do të vij të marr pjesë në debat nëse deri atëherë nuk kanë përfunduar diskutimet pas përfaqësimit një ore.

Por, dua ta ritheksoj që të gjitha kritikrat dhe kundërshtimet që na u bënë, argumentet e opozitës do të jenë plotësisht të vlefshme nëse janë të arsyeshme edhe atëherë kur do ta sjellim rishikimin e buxhetit pas pak muajve, e që do të paraprihet nga Programi qeveritar, që do të diskutohet bashkë me juve këtu. Faleminderit!

KRYETARJA: Kryeministër, faleminderit për fjalën!

Tani është radha e deputetëve. Unë e kam paraqitjen e deputetëve. Pra, po vazhdoj sipas radhës. Deputeti Mërgim Lushaku e ka fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të gjithëve njëherë ju uroj punë e mbarë, dhe dashtë Zotit që të jemi sa më të dobishëm për vendin.

Sot po diskutojmë në parim për buxhetin e shtetit, jo veç teknikisht, jo vetëm si numra e tabela, por si planifikim i drejtimin kah po ecim si shoqëri. Buxheti është pasqyra më e qartë e asaj nga po shkojmë si vend. Aty shihet çka kemi në mendje për familjet tona, për rininë, për punëtorin, për bujkun, për mjekun, për mësuesin.

Po na thuhet se ekonomia do të rritet gati për 5%. Tingëllon bukur, por vetëm pak kohë më parë u ul parashikimi për vitin 2025. Kur brenda një viti ndryshojnë kaq shumë shifrat, lind pyetja natyrisht nëse po flasim mbi baza reale, apo veç mbi shpresa e ambicie elektorale.

Nëse kjo rritje nuk realizohet ashtu siç po shihet, atëherë të hyrat bien, deficiti rritet dhe barrën prapë e paguan qytetari. Edhe inflacioni parashihet të bjerë, por e dimë fort mirë që çmimet e energjisë, krizat e jashtme të vendit dhe luhatjet në tregjet botërore nuk varen prej nesh. Aq më

tepër kur e dimë që industria prodhuese në Kosovë, për fat të keq, ende është mjaft e dobët. Për këtë arsye duhet t'i falënderojmë ata që prodhojnë dhe mbi të gjitha ta stimulojmë me mbështetje serioze këtë sektor prodhues.

Një tjetër realitet që s'mund të fshihet është se buxheti vazhdon të mbushet kryesisht nga TVSH-ja dhe nga akcizat në kufij prej mallrave që i blejmë nga jashtë dhe prej veturave që doganojmë shpesh me çmime rekorde në Evropë. Kjo do të thotë se ekonomia jonë mbështetet më shumë mbi konsumin e importit sesa mbi prodhimin vendor. Sa herë që rriten çmimet jashtë, ne e ndiejmë menjëherë në xhepin e qytetarëve të Kosovës. Kjo nuk është rrugë e sigurt, por duhet ta analizojmë dhe të bëjmë politika më të mira që ta forcojmë shtetin.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere sociale janë rritur ndjeshëm. Pensionet dhe ndihmat sociale janë të domosdoshme. Askush nuk e mohon këtë. Por, kur kjo kategori merr më shumë mjete sesa investimet kapitale, duhet t'ia bëjmë vetes pyetjen serioze: A po ndërtojmë zhvillim për të ardhmen, apo veç po e menaxhojmë të tashmen?

A po blejmë kohë, a po blejmë qetësi sociale, ndoshta edhe vota me skema të herëpashershme për pensionistë, studentë në kategori të tjera, nuk do të duhej të ishim me të drejtë, që në këtë mbështetje të jemi të rregullt dhe të qëndrueshëm, qoftë përmes rritjes së koeficienteve të pagave, apo përmes mekanizmave që u japin qytetarëve siguri të vazhdueshme, e jo ndihma sporadike një herë apo një herë në vit.

Investime kapitale në letër duken të mëdha afro 1 miliard euro, por përvoja e viteve të kaluara na ka treguar se shpesh realizohen vetëm 60%, apo edhe 70%. Pra, problemi nuk është vetëm sa planifikojmë, por sa dimë t'i çojmë projektet deri në fund. Rugët, shkollat, spitalet nuk ndërtohen me premtime, por me punë konkrete dhe menaxhim të përgjegjshëm.

Rritja e borxhit publik, sidomos e atij të jashtëm, është një tjetër çështje që s'duhet të anashkalohet. Borxhi nuk është i keq nëse përdoret për investime që sjellin zhvillim dhe rritje ekonomike. Por, nëse merret për t'i mbuluar shpenzimet e përditshme, atëherë po ua lëmë barrën brezave që vijnë.

Ekonomia jonë vazhdon të mbështetet fort në remitenca. Paratë që i dërgojnë vëllezërit dhe motrat tonë nga mërgata janë bekim për shumë familje, por një shtet serioz nuk mund ta ndërtojë të ardhmen e vet mbi djersën e mërgimtarëve. Duhet që të krijojmë kushte që njerëzit të punojnë, të prodhojnë dhe të jetojnë me dinjitet këtu në vendin e vet.

Në shëndetësi po rriten fondet për barna dhe pajisje, por mungon reforma e thellë që do ta siguronte sistemin shëndetësor për të gjithë. Mjekët vazhdojnë të largohen. Mos i harroni sigurimet shëndetësore që i keni premtuar, e qytetarët po presin për zbatim, e jo vetëm fjalë.

Në arsim po ndahen mjete për paga dhe ndërtesa, por kërkimi shkencor, laboratorët, digjitalizimi mbeten prapa. Në bujqësi, pjesa më e madhe e buxhetit shkon për subvencione direkte, ndërsa shumë pak investohet në përpunim, aty ku kërkohet dhe krijohet vlera e shtuar. Industria ka nevojë për mbështetje të vërtetë, jo vetëm për fonde simbolike. Ndërmarrjet publike shpesh subvencionohen për t'i mbuluar humbjet, e jo për t'i modernizuar dhe për t'i bërë ato të konkurruese.

Po shtyhen edhe reformat e rëndësishme si tatimi progresiv në pronë, ndërkohë që komunave u kërkohet të mbledhin m[shumë të hyra. Edhe të hyrat jotatimore pothuajse nuk rriten fare, çka tregon mungesë të reformave serioze në menaxhim.

Të dashur miq,

Ky buxhet duket më shumë i ndërtuar për ta menaxhuar të tashmen sesa për ta ndërtuar të ardhmen. Ka shumë fokus në konsum dhe shpërndarje, e më pak prodhim dhe krijim të vlerës së re.

Ne kemi nevojë për një planifikim më të mirë, për një ekonomi që prodhon, që eksporton, që mban të rinjtë këtu. Për investim në dije, në teknologji, në bujqësi përpunuese dhe në industri prodhuese. Për një buxhet që mbështet, jo vetëm në import edhe remitenca, por në forcën e brendshme. Por, njëkohësisht nuk guxojmë ta bllokojmë funksionimin normal të shtetit. Pagat duhet të ekzekutohen pa asnjë vonesë, sepse ato janë siguri për familjet tona dhe bazë e stabilitetit shoqëror.

Kjo nuk do të thotë që buxheti nuk ka nevojë për përmirësime, përkundrazi ka nevojë për korrigjim dhe për rishikim sa më të shpejtë, në mënyrë që mjetet publike të orientohen drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe si anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës, sigurisht që do të paraqes edhe amendamente të tjera. Besoj që edhe deputetët e tjerë kanë nevojë që kërkesat, sidomos ato elektorale t'i paraqesin në Kuvend dhe përmes buxhetit t'u zotohen që ato t'u realizohen.

Sigurisht, unë e shoh që shumë projekte janë anashkaluar, në mesin e tyre edhe një projekt që ka qenë edhe më herët që është larguar padrejtësisht, siç ka qenë projekti i Brusit, që do ta lehtësonte jetën e qytetarëve të Skenderajt për ujët e pijshëm.

Ka qenë një padrejtësi e madhe. Po e shoh që, edhe pse e kanë premtuar që do të reflektojnë në të ardhmen dhe do ta rishikojnë buxhetin, nuk ka asnjë ndryshim në këtë aspekt. Por, edhe projektet e tjera që realisht shikohen që janë në dokument, fatkeqësisht nuk po zbatohen dhe nuk po realizohen në plotësi.

Dhe, sigurisht që Kuvendi i Kosovës nuk duhet të jetë vetëm në amendamentimin, por edhe në mbikëqyrjen e buxhetit, dhe realisht Kuvendit i ka humbur edhe një rol vendimmarrës dhe mbikëqyrës, sepse nuk është Kuvendi këtu që vetëm në fund të vitit të ketë votën për buxhet, apo ta mandamentojë edhe buxhetin, por të ketë edhe rol vendimmarrës kur ka çështje të re alokimit të buxhetit.

Prandaj, do të jap maksimumin tim si deputet edhe gjatë procesit të amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Tani fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami dhe ju njoftoj që po e lë kryesimin e seancës te nënkryetari Ardian Gola.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë para se të flas për shifrat në buxhetin e Projektligjit për vitin 2026, po kthehem pak te shpenzimi i parasë publike në pesë vjetët e kaluara.

U fol këtu për shpenzimet kapitale. Shpenzimet kapitale dallojnë shumë, planifikimi me realizimin. Ajo çfarë kemi parë në pesë vjetët e qeverisë së Lëvizjes Vetëvendosje, kemi parë shpenzim të taksave të qytetarëve për blerje të votave dhe blerje të paqes sociale dhe këtë jua dokumentoj me të dhëna të Ministrisë së Financave.

Në vitin 2021 shpenzimet kapitale kanë qenë 419 milionë, ndërkohë subvencionet dhe transferet 817 milionë, rreth 50% më shumë, në fakt qind për qind më shumë. Në vitin 2022 shpenzimet kapitale 419 milionë, subvencionet dhe transferet 1 miliard dhe 37 milionë. Në vitin 2023 shpenzimet kapitale 550 milionë, subvencionet dhe transferet 1 miliard e 47 milionë. Në vitin 2024 shpenzimet kapitale janë 660 milionë, subvencionet dhe transferet janë 1 miliard e 79 milionë dhe në vitin 2025, siç i dha kryeministri shifrat, tha shpenzimet kapitale janë 720 milionë.

Besoni ose jo, kolegë, sipas këtyre shifrave i bie që vetëm në muajin dhjetor, gjatë fushatës elektorale, Qeveria ka arritur t'i shpenzojë plot 240 milionë euro shpenzime kapitale. Merreni me mend fushatën, merreni me mend temperaturat e ulëta, domethënë Qeveria arrin që t'i shpenzojë në muajin dhjetor 240 milionë. Çfarë janë këto? Këto janë kontrata njëburimore janë paradhënie komplet për financim të fushatës elektorale. Janë korrupsion, sepse i vetmi indikator që në Kosovë përpos inflacionit që ka pasur ngritje gjatë kësaj kohe janë kontratat njëburimore dhe është korrupsioni pandemik qeveritar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji ka shumë probleme në pjesën tekstuale. Merreni me mend, në nenin 11, në paragrafin tre dhe pesë, ministri i Financave i jep diskrecion vetes thuhet se është mbret në këtë shtet dhe jo që jemi Republikë parlamentare. Shikoni mandej nenin 12, të nderuar kolegë deputetë. Neni 12, paragrafi 3 thotë se “qeveria mund të aprovojë pagesat e paradhënies prej më shumë se 30% deri në qind për qind për vlerat e kontratës për mallra dhe shërbime”.

Ju e dini shumë mirë që Komisioni Evropian në vitin 2023 i ka ngritur çështje kontratat njëburimore. Gjatë qeverisjes së këtyre, deri në korrik të vitit 2025 janë nënshkruar plot 2 mijë e 550 kontrata njëburimore. Tash merreni me mend, qeveria në pjesën tekstuale i jep të drejtë vetes edhe me dhënë paradhënie deri në qind për qind. Domethënë ministrat japin kontrata pa shpallje të tenderit dhe, në anën tjetër e marrin një vendim që këta operatorë t’i paguajnë deri në qind për qind.

Çfarë kemi tjetër? Në nenin 14, në paragrafin 2, të nderuar deputetë të Legjislaturës VIII, ju kujtohet shumë mirë ku në Komisionin për Ekonomi ka pasur debat lidhur me një garanci bankare për projektin për energji të ripërtitshme, ku menaxherin, atë kohë drejtori i KOSTT-it nuk pranonte që ka lëshuar garanci bankare për operatorin privat ekonomik. Tash, në nenin 14, të paragrafit 2, ju e keni që ministri i Financave nga pjesa e kontigjencës mund të paguajë faktikisht garancinë bankare për një kompani private. Këtu ka pasur shkelje të mëdha, sepse, në fakt, ata që kanë garuar për projektin e tillë nuk kanë qenë në dijeni që Qeveria e Republikës së Kosovës do të lëshojë garanci bankare.

Në nenin 18, gjithashtu ka probleme të ndryshme. Më lejoni vetëm pak të gjej nenin 18 të Projektligjit për buxhetin. Shihni këtu thotë se me qëllim të zbatimit dhe mbikëqyrjes së projekteve, domethënë organizatave buxhetore u jepet diskrecion të paguajnë ekspertë edhe të themelojnë. Në paragrafin 3 thuhet që organizatat buxhetore mund të krijojnë njësitë e mbikëqyrjes për t’i paguar ekspertët. Ne e dimë të gjithë që numri i punëtorëve në organizatë buxhetore kufizohet me Ligjin e buxhetit dhe çka bën neni 18, faktikisht e lë në diskrecion të secilës organizatë buxhetore që ta rrisë sa ka dëshirë numrin e punëtorëve dhe t’i paguajë ata sipas dëshirës së tyre, sepse domethënë këtë ia lejon pjesa tekstuale e Ligjit të buxhetit.

Mandej, shikoni se çfarë thuhet në nenin 22, ende dhe sot e kësaj dite e kemi Programin e ringjalljes ekonomike.

Të nderuar kolegë deputetë, me gjithë këtë lulëzim që e paraqiti kryeministri, a thua vallë pse neve na duhet të kemi një program për ringjallje ekonomike? A e dini pse na duhet? Sepse, ky buxhet është çek i bardhë për ministrin e Financave dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ju të cilët sot votoni në lexim të parë dhe më vonë në lexim të dytë, në fakt, nuk keni bërë asgjë vetëm

që keni dhënë autorizime të pakufizuara Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës që ata ta shpenzojnë buxhetin e Republikës së Kosovës bashkë sikur kanë dëshirë.

Merreni me mend, u përmend më herët edhe nga zoti Hamza, i kemi kontigjencat në Ministri të Financave në shumë prej 47 milionë eurove dhe mbi 30 milionë euro e kemi Programin e ringjalljes ekonomike. Edhe pas pesë vjetëve në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka idenë, nuk ka vizion, nuk ka program, nuk ka projekt edhe nuk e di çka do të bëjë me 33 milionë të ringjalljes ekonomike dhe nuk e ka idenë se çfarë do të bëjë me 47 milionë në fondin e kontigjencave. Mirëpo, a e dini çka? Në kuadër të këtij fondi janë 100 pozita të lira me buxhet prej 20 milionë eurove, që në mesatare kur i ndanim 100 pozita, i pjesëtonim me 12 muaj. A e dini sa i binte paga? I binte diku rreth 18 mijë e 400 euro. Tash ky është diskrecioni që ata që e ngritin votën për këtë projektbuxhet i japin Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Dhe, gjithashtu është kërkesë jona, e duhet të jetë kërkesë e secilit deputet që ka marrë votat e qytetarëve të Republikës së Kosovës që në këtë buxhet të inkorporohet buxheti i Kuvendit i aprovuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Nuk ka asnjë arsye që ministri i Financave të mos e bëjë harmonizimin e tabelave, në mënyrë që Prishtina të nisë projektet e saja sipas aprovimit të Asamblesë Komunale dhe këtu në këtë buxhet, gjithashtu çfarë kam vërejtur, ka një numër të madh të projekteve, ku janë hapur kodet burimore, ndërkohë që shuma për vitin 2026 është zero. I ke çerdhet: çerdhen në Ferizaj, në Prizren, në Pejë, në Gjiilan e të tjera. Shuma nga buxheti, granti qeveritar është zero. Aty-këtu janë 50 mijë euro të ndara me klauzolë të investimeve, po këto janë me shuma zero.

A e dini që ka, për shembull, QKMF-ja në Ferizaj thuhet që do të përfundojë në vitin 2028 dhe a e dini pse shtyhet në vitin 2028? Buxheti për vitin 2028 është i paraparë të jetë 20 mijë euro. Projekti i tërësishëm është 1.4 milionë. Domethënë për 20 mijë euro nuk kryhet në 2027-ën, por kryhet në 2028-ën. Kjo flet shumë për planifikimin, të cilin këta e bëjnë. Dhe, ministër, ishte shumë interesant edhe ai neni 35, ku ke thënë që “tatimi progresiv për pronën e paluajtshme shtyhet në implementim për vitin 2027”. Dëgjo, ju veç marketing politik e keni barazinë sociale. Ju sot u jepni shtesa fëmijëve të atyre që i quani “oligarkë”, të njëjta me ata që janë në asistencë sociale. Ju sot u jepni shtesa grave lehona, të atyre që i quani “oligarkë”. Domethënë, nuk ka barazi sociale. Barazia sociale është kur merr shumë ai që s'ka dhe ai që ka shumë nuk merr fare. Edhe me tatimin progresiv në pronën e paluajtshme e keni pasur pikërisht me këtë kartën e barazisë sociale, por po e shihni që keni pasur veç marketing dhe e keni shtyrë për vitin 2027, sigurisht kur vjen 2027 e shtyni për 2028. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Ardian Gola.)

KRYESUESI: Tani radha është për deputetin Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Një herë mendova që do t'i drejtohem kryeministrit, meqenëse është ministri i Financave, besoj që do të na japë një shpjegim. Nuk po e kritikoj atë bazën e buxhetit, se mendoj që ka ekspertë këtu, por në prezantimin e Qeverisë para katër ditësh kryeministri e përshkroi gatishmërinë e tij për të investuar sidomos në infrastrukturë dhe përmbylljen ose përfundimin e projekteve kapitale që kanë filluar tash e sa vjet. Po e marr shembull rrugën Gjilan - Prishtinë, pastaj rruga Gjakovë - Klinë, rruga Klinë - Pejë, pastaj e përmendi bile prej top prioritetëve ishte Prizren - Gjakovë - Pejë.

Ndërsa nëse e shihni tabelën buxhetore këto, edhe pse kanë filluar si projekte, unë nuk e di me çfarë linjash buxhetore, ku janë ato ndarje buxhetore për të vazhduar ose përfunduar këto projekte.

Pra, ministër, meqenëse jeni prezent, mendoj që kishe mundur të na jepni një shpjegim. Pastaj, kryeministri e prezantoi që do të ketë buxhetin për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë, pensionimin e parakohshëm. Të gjithë e dimë që e kemi Policinë më të plakun ose më të vjetrën në moshë në Ballkan. Është një problem jashtëzakonisht i madh kur e sheh një 64-vjeçar në trafik në temperatura -20°.

Ndërsa, nëse i shihni linjat buxhetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kjo nuk është paraparë. Pra, ai ishte, domethënë iku, u largua ministri se e arsyetoi kryeministrin, po mendova që ministrat do të jenë këtu. Pastaj, kryeministri tha që do të ketë një buxhet prej 200 milionë në sport për ndërtimin e 20 stadiumeve në Kosovë. Nëse e shihni tabelën buxhetore është zero.

Pastaj, tha që buxheti për investimin në ushtri ose në atë arkitekturën e prodhimit ushtarak do të shkojë për katër vjet deri në 1 miliard euro. Nëse e shihni tabelën buxhetore është vetëm 08% diferenca e buxhetit 2026 me vitin 2025. Në anën e kundërt, sot 614 ushtarë e kanë paditur Ministrinë e Mbrojtjes që ua kanë hequr të drejtën e orëve shtesë. Nuk po flas për Policinë, se është e njëjta situatë. Pra, këtë duhet ta trajtojmë seriozisht se është skema e sigurisë, edhe globi është kah flet për këtë aspekt.

Pastaj, tha do të kemi 17 poliklinika në nivel të Republikës së Kosovës për mandatin katërvjeçar. Ministri i Shëndetësisë prapë nuk qenka këtu, ndërsa nëse e shihni buxhetin, nuk është e paraparë në linjat buxhetore në asnjë projekt dhe jam i detyruar për diskriminimin e komunave. S'kam qare pa e përmendur se komunat ku nuk qeveris Vetëvendosja janë të diskriminuara në ndarjet buxhetore, sidomos në projektet kapitale.

Ministrja e Infrastrukturës prapë nuk qenka këtu, imagjinoni rrugën Deçan - Plavë, e përfunduar qysh në Qeverinë e Isa Mustafës dhe u bënë tash tetë vjet, akoma ajo rrugë edhe ai investim që ka ndodhur aty është në shkatërrim e sipër, ndërsa flitej për investime milionëshe në turizmin

malor në bjeshkët e Dukagjinit. Meqenëse e përmenda dhe këtë, u tha që do të investohen 500 milionë euro në Brezovicë. Nëse e shihni tabelën buxhetore, kjo nuk figuron.

Domethënë, nuk e di për çfarë investimi bëhet fjalë. Nuk po zgjatem më shumë se e kam pak Besnikun këtu po më kritikon, po thotë mos u kyç në tema më gjatë, por e pashë edhe një që më bëri shumë përshtypje që tha kryeministri, industrinë inovative 200 milionë euro. Shiheni në buxhet a është ndonjë cent i ndarë për këtë industri edhe tani i thonë popullit jemi duke prodhuar dronë luftarakë. Faleminderit!

KRYESUESI: Radhën e ka Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, nënkryetarja dhe deputetja Vlora Çitaku.

VLORA ÇITAKU: Faleminderit, kryesues!

Unë, në fakt, kam një kërkesë, jemi duke diskutuar dokumentin më të rëndësishëm për katër vjetët e ardhshme dhe kryeministri dhe qeveria nuk janë këtu. Kështu që propozoj që të shkojmë në pauzë derisa të sigurohemi që kryetari i Qeverisë të jetë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirë, sa për rikujtim, kryeministri kërkoi leje për shkak të takimit që kishte me përfaqësues të Bankës Qendrore, gjithsesi mendoj që një grup i ministrave janë këtu dhe mund t'u replikojnë përmbajtjeve, të cilat ju dëshironi t'i diskutoni.

Unë konsideroj që të vazhdojmë me debatin, në mënyrë që të racionalizojmë edhe kohën e mbetur për diskutimin e buxhetit.

Urdhëro, zonja Lushaku!

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: Nënkyetar, vërtet është e pakuptimtë që ne sot po diskutojmë dokumentin më të rëndësishëm në mungesë të kryeministrit. Konsiderojmë po ashtu që është tepër e rëndësishme që ai të jetë këtu përgjatë gjithë kohës, meqë secila prej rekomandimeve dhe sugjerimeve tona, por edhe kritikave ka të bëjë edhe me platformën e tij që ai ka prezantuar. Kështu që konsideroj që ju ose të gjeni një zgjidhje të bëjmë pauzë ose të kthehet Kabineti qeveritar këtu për aq kohë sa ne diskutojmë buxhetin, dokumentin më të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shefja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Me gjithë respektin ndaj kolegëve, unë konsideroj që meqenëse ministri i Financave është i pranishëm, deputetët mund të shterojnë diskutimin e tyre edhe natyrisht që kryeministri bashkëngjitet ashtu siç edhe njoftoi shumë shpejt, ndoshta për pjesën përfundimtare të seancës.

Por, gjithsesi meqenëse ministri i linjës, ministri Murati është i pranishëm, unë nuk shoh asnjë arsye për të ndërprerë diskutimet.

KRYESUESI: Mirë, atëherë konsideroj që duhet vazhduar me diskutimin. Radhën e ka deputetja Time Kadrijaj, nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot kemi para vetes buxhetin për vitin 2026, një buxhet afro 4 miliardë euro. Në letër duket buxhet i madh, e në realitet është i vogël përballë nevojave të qytetarëve. Mos të harrojmë që kemi menaxhuar me mbi 50 miliardë euro për këto pesë vjet të qeverisjes tuaj dhe nuk kemi parë ndonjë ndryshim të dukshëm.

Kosova nuk ka nevojë për buxhet që duket mirë në prezantim. Kosova ka nevojë për buxhet që ndihet në xhepin e qytetarit, në vendin e punës, në spital, në shkollë dhe në të gjitha institucionet e tjera. Ky buxhet nuk është zhvillimor, është buxhet që rrit shpenzimet, por nuk rrit ekonominë. Është buxhet që mban administratën, por nuk fuqizon prodhimin. Me gjithë këtë, nuk shohim plan të qartë për hapje të vendeve të reja të punës, nuk shohim mbështetje të fuqishme për bizneset vendore, nuk shohim vizion ekonomik që e ndal ikjen e të rinjve. Qytetari vazhdon të përballlet me çmime të larta, me pasiguri ekonomike dhe me mungesë perspektive, me 4 miliardë euro Kosova do të duhej të kishte një drejtim të qartë zhvillimi. Ky buxhet nuk i jep atë drejtim.

Në shëndetësi realiteti është i rëndë. Spitalet përballen me mungesa, mjekët largohen, qytetarët presin me muaj për shërbime. Ky buxhet nuk sjell ndryshim rrënjësor, nuk sjellë reformë të thellë. Shëndetësia trajtohet si shpenzim i domosdoshëm, por jo si prioritet kombëtar. Në arsim sfidat janë të mëdha, cilësia kërkon investim serioz dhe afatgjatë. Pa arsim cilësor, nuk ka zhvillim ekonomik. Pa investim real në shkollë, në infrastrukturë dhe në përgatitje të brezave të rinj ne vetëm sapo e shtyjmë problemin përpara. Edhe në aspektin e sigurisë, në një kohë sfidash të brendshme dhe rajonale, buxheti duhet të reflektojë qartësi dhe vendosmëri.

Siguria e shtetit nuk mund të mbetet në nivel deklarativ. Në sektorin e energjisë dështimi është i qartë dhe i prekshëm për çdo familje në Kosovë. Qytetarët kanë paguar faturat më të larta në rajon, bizneset janë përballur me pasiguri, ndërsa vendi vazhdon të mbetet pa strategji të qëndrueshme energjetike. Ministrja e kaluar dhe e tashmja nuk ka arritur të stabilizojë sektorin, po prapë është shpërblyer me postin e ministres. Ky buxhet nuk i trajton barabartë komunat. Zhvillimi duhet të jetë i balancuar dhe i drejtë për të gjitha pjesët e vendit, sepse kur keni kërkuar vota, keni kërkuar cep më cep dhe tani investoni dhe shpërndani paratë cep më cep, ashtu siç keni kërkuar vota. Paratë e qytetarëve nuk janë pronë e një partie, janë pronë e Republikës së Kosovës.

Pashë që keni ndarë vetëm 6 milionë euro për rrugën Dollc - Gjakovë. Një rrugë e një rëndësie të madhe ku ka mbetur edhe 40% e papërfunduar, ndërsa me këta milionat e juaj të shpërndarë nuk ka mundësi të përfundojë dhe unë mendoj që është koha që të investohet në atë pjesë dhe të përfundojë kjo rrugë, e cila ka ngelur për vite e papërfunduar. Gjithashtu, keni ndarë veç 1 milion euro të bartura nga viti 2025 për rrugën Deçan - Plavë. Është mirë ky Kabinet qeveritar, ndoshta edhe ministri i Infrastrukturës, edhe ministri i Buxhetit ta bëjnë atë rrugë, duke ditur që është rrugë e një rëndësie të veçantë, të shihet çka është investuar dhe cilat janë nevojat që të përfundojë ajo rrugë dhe ndoshta atëherë do të kishin reflektuar që për rrugën Deçan - Plavë të ndani më shumë buxhet, në mënyrë që të përfundojë, sepse kur komunat nuk ndihen të trajtuara njësoj, atëherë krijohet padrejtësi dhe ndarje.

Premtimet elektorale kanë qenë të mëdha. Është folur për zhvillim, për punë, për mirëqenie. Sot me një buxhet kaq të madh në dorë do të duhej të shihnim një kthesë të fortë ekonomike. Kosova meriton buxhet që krijon punë, që forcon shtetin, që investon seriozisht në shëndetësi dhe arsim, që i trajton komunat me drejtësi dhe që përmbush fjalën e dhënë para qytetarëve. Mirë që e keni premtuar pagën e 13-të, pajtohem, por e kam një pyetje, ministër. A vlen kjo paga e 13-të edhe për kompanitë publike? A do ta marrin pagën e 13-të kompanitë publike?

Dy tema që gjykata i ka shpallur të paligjshme dhe si duket prapë nuk janë përfshirë në buxhet. Përvoja e punës ka qenë 2.5, është paguar, ndërsa tash është 0.5. A do të a do të intervenohet në këtë drejtim apo do të vazhdohet kështu, edhe pse gjykata ka dhënë një verdikt. Për ushtarët mëditjet e udhëtimeve jashtë vendit për 30 ditë nuk paguhen dhe ata ushtarë që shkojnë për trajnime pas 30 ditë nuk ua paguani, ata detyrohen me paga të veta, edhe pse është avancim profesional, t'i paguajnë këto mëditje. Kjo nuk është në rregull, edhe unë e mendoj që kjo duhet të ndryshohet, sepse siç keni thënë, e kemi prioritet sektorin e sigurisë.

A do të kenë uniforma Policia e Kosovës, Ushtria e Kosovës? A do të kenë këpucë, këmisha, sepse për vite të tëra ata nuk kanë marrë uniforma dhe janë detyruar prej xhepit të vet, prej pagave të veta t'i blejnë këto uniformat, të blejnë këmisha, edhe në një farë forme t'i përshtatin me këmishët që i përdor Policia e Kosovës dhe Ushtria e Kosovës.

Po ashtu, po kërkoj ta stimuloni edhe Policinë e Kosovës, edhe Ushtrinë, edhe Shërbimin Korrektues, edhe zjarrfikësit dhe komplet sektorin e sigurisë.

Keni thënë që keni për të investuar në qendrat e skijimit.

Ministër, a mund ta kemi një përgjigje prej jush? Në këtë pakon që do të investoni në qendrat e skijimit, a do të përfshihet Bjeshka e Madhe e Deçanit, që është bërë një qendër e re skijimi dhe që është tepër atraktive? A do të investoni në këtë qendër të skijimit, njëjtë sikurse kemi kërkuar edhe për qendrën e skijimit në Beleg, në Bjeshkët e Belegut. Po kërkojmë të investohet edhe në

qendrën e skijimit në Bjeshkë të Madhe, e që tash e kemi parë se është një resor tepër atraktiv dhe që po vizitohet shumë prej qytetarëve të Kosovës.

Kisha kërkuar prej juve si Qeveri, mësohuni me kritika, mësohuni me akuza, mësohuni që do të ballafaqoheni me një realitet dhe mos i ndëshkoni gazetarët e Kosovës, siç është rasti i Edina Avdiut, e cila përjashtohet prej RTK-së për shkak të qasjes së saj ose për shkak të parashtrimeve të pyetjeve ndaj kryeministrit për çështje të ndryshme!

Edhe gazetarët, edhe deputetët dhe të gjithë kemi për t'ju ballafaquar me këtë realitet, sepse ne si deputetë të opozitës e kemi detyrë ta mbikëqyrim punën e Qeverisë dhe normalisht që ato do t'i qesim në pah. Mësohuni me këtë realitet! Mos u mundoni t'i ndëshkoni gazetarët, sikurse tash gazetaren së fundi, e gazetaret paraprake, t'i largoni prej vendit të punës për shkak të kundërshtimit të politikave tuaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Meqë grupet parlamentare PDK dhe LDK nuk e konsumuan tërë kohën për të diskutuar, mund ta rikthejmë me PDK-në.

Radhën e ka Besa Kabashi-Ramaj, më pastaj i rikthehemi LDK-së dhe e rikthejmë rendin prapë me Lëvizjen Vetëvendosje, meqë Time Kadriaj në këtë rend tashmë e konsumoi kohën.

BESA KABASHI-RAMAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot qëndroj para jush për herë të parë si deputete e Republikës së Kosovës në Legjislaturën X, plotësisht e vetëdijshme për përgjegjësinë që mbajmë para çdo familjeje që kërkon të jetojë me dinjitet, para çdo të riu që dëshiron të ndërtojë një të ardhme të tij këtu dhe para çdo qytetari që pret drejtësi, siguri dhe institucione që funksionojnë.

Prandaj, nga kjo foltore kemi detyrimin të flasim me qartësi, me përgjegjësi shtetërore dhe me besnikëri ndaj të vërtetës, sepse çështjet që trajtojmë sot nuk janë thjesht statistika, ato janë realiteti i përditshëm i qytetarëve tonë. Prandaj, ky debat për buxhetin nuk është thjesht debat për shifra; është debat për drejtimin strategjik të shtetit tonë. Buxheti është dokumenti më i sinqertë politik i një Qeverie. Aty shihet qartë çfarë ka prioritet real. Aty dallohet vizioni nga retorika. Aty kuptojmë nëse ambicia është program shtetëror apo mbetet deklaratë publike.

Sot po përqendrohem në një shtyllë themelore të këtij drejtimi: financimin e sigurisë kombëtare. Pra, mënyrën se si ky buxhet adreson mbrojtjen, sigurinë e brendshme, zvogëlimin e rreziqeve ndaj fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e emergjencave, inteligjencën dhe sigurinë kibernetike, si dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Sepse, siguria nuk është vetëm një sektor;

është kusht ekzistence për vetë shtetin dhe për zhvillimin ekonomik, stabilitetin institucional dhe besimin e qytetarëve.

Para disa ditësh dëgjuam zotime të mëdha; ndërtim të fabrikës së municionit, prodhim të dronëve Made in Kosova, zhvillim të industrisë ushtarake, investim prej 1 miliard eurosh në mbrojtje si dhe projekte madhore infrastrukturore të paraqitura si pjesë e sigurisë kombëtare. Këto janë ambicie legjitime. Çdo qeveri serioze duhet të ketë objektiva të qarta në siguri. Por, në financat publike ekziston një parim i qartë; strategjia nuk matet me fjalim. Strategjia matet me buxhet. Dhe kur e lexojmë buxhetin, aty ku strategjia duhet të marrë formë financiare, nuk e gjejmë programin, nuk e gjejmë planin, nuk e gjejmë ndërtimin e këtyre kapaciteteve.

Kur e analizojmë dokumentin buxhetor përmes tri pyetjeve themelore: a ndërton kapacitete të reja? A rrit gatishmërinë operacionale? A e forcon vetëqëndrueshmërinë shtetërore në mënyrë të integruar? Përgjigjja që del nga dokumenti aktual është shqetësuese. Nuk shohim fillimin e qartë të projekteve të reja strategjike për vitin 2026. Nuk shohim linja të dedikuara për ndërtimin e industrisë ushtarake. Nuk shohim program kërkim-zhvillimi për dronë. Nuk shohim arkitekturë shumëvjeçare financimi.

Te sektorët primarë të sigurisë dhe mbrojtjes shohim mungesë pothuajse totale të investimeve të reja për 2026. Tek investimet kapitale, kolona për investime të reja për 2026 është pothuajse gjithmonë zero. Shumica e mjeteve janë bartje nga viti 2025. Kjo do të thotë se nuk kemi fillim transformimi strategjik, por vazhdimësi administrative. Siguria nuk ndërtohet duke bartur fonde. Siguria ndërtohet duke hapur projekte të reja. Së dyti, industria ushtarake e premtuar, fabrika e municionit apo prodhimi i dronëve Made in Kosova nuk ekziston në planifikimin financiar. Në buxhet nuk ka as studim fizibiliteti për fabrikë municioni, as projekt ndërtimi, as linjë për kërkim dhe zhvillim, as program për zhvillim të dronëve. Projekte të tilla në çdo vend serioz fillojnë në buxhet, jo në deklarata! Nëse nuk janë të buxhetuara, ato nuk kanë hyrë ende në proces shtetëror.

Së treti, zotimi për një miliard euro investim nuk reflektohet në strukturë financiare shumëvjeçare. Një investim strategjik i tillë kërkon ndarje buxhetore sipas viteve, projekte konkrete dhe faza të realizimit. Ky buxhet nuk paraqet asnjë arkitekturë të tillë. Ai paraqet vazhdimësi administrative, siç thashë, dhe jo transformim strategjik.

E njëjta logjikë vlen edhe për dimensionin modern të sigurisë. Në epokën e kërcënimeve hibride, siguria nuk është vetëm mbrojtje klasike. Ajo është njëkohësisht kibernetike, energjetike, infrastrukturore dhe kapacitet reagimi ndaj krizave natyrore.

Siguria energjetike dhe ajo ujore janë sot po aq strategjike sa mbrojtja territoriale, sepse cenimi i tyre ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e shtetit dhe jetën e qytetarëve tonë. Megjithatë, ky buxhet nuk paraqet planifikim të integruar për këto dimensione. Investimet mbeten të

fragmentuara dhe nuk reflektojnë qartë zotimet politike të shpallura. Pra, nuk kemi vetëm mungesë projektesh të reja, por mungesë të një qasjeje të koordinuar ndërinstytucionale. Nuk shohim lidhje programore ndërmjet mbrojtjes, sigurisë kibernetike, inteligjencës dhe ndërtimit të vetëqëndrueshmërisë shtetërore. Ndërkohë që kërcënimet janë të ndërthurura, planifikimi mbetet i ndarë sipas sektorëve administrativë. Siguria moderne kërkon planifikim të përbashkët shumëvjeçar dhe vizion të unifikuar strategjik, jo ndarje sektorale pa koordinim.

Prandaj, problemi nuk është mungesa e ambicies në fjalime; problemi është mungesa e përkthimit të saj në planifikim shtetëror. Në një shtet serioz, strategjia buxhetohet, premtimi programohet dhe vizioni financohet. Zgjidhja është e qartë; Kosova ka nevojë për planifikim shumëvjeçar të integruar të sigurisë kombëtare ku mbrojtja, siguria e brendshme, inteligjenca, siguria energjetike dhe infrastruktura digjitale trajtohen si një sistem i integruar i vetëqëndrueshmërisë shtetërore. Çdo objektiv strategjik duhet të shoqërohet me program konkret buxhetor, me faza të realizimit, me indikatorë të matshëm dhe me mbikëqyrje parlamentare. Sepse, Kuvendi ynë nuk autorizon vetëm shpenzime; Kuvendi autorizon drejtimin strategjik të Republikës së Kosovës.

Nëse e duam një shtet të sigurt, duhet të planifikojmë si shtet. Nëse duam një ushtri moderne, duhet ta ndërtojmë me projekte reale dhe të matshme. Nëse duam institucione që i rezistojnë kohës, duhet t'i mbështesim me financim serioz dhe vizion të strukturuar.

Historia na ka mësuar se liria fitohet me sakrificë, por siguria jonë dhe e shtetit tonë ruhet me plan, disiplinë financiare dhe përgjegjësi shtetërore. Kjo është përgjegjësia jonë sot dhe për brezat që do të vijnë. Faleminderit!

KRYETARJA: Radhën nga LDK-ja tash e ka shefja e grupit parlamentar, Jehona Lushaku. E kemi Anton Çunin atëherë, pra.

ANTON QUNI: I nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë dhe

Qytetarë të Republikës!

Sot po diskutojmë ndër të tjera për shifrat e buxhetit të mbrojtjes dhe sigurisë. Shpeshherë në këto debate ne humbim pas tabelave të Excel-it, duke numëruar kalibrat e armatimit, mjetet e blinduara dhe teknologjinë e fundit. Por, si përfaqësues të popullit ne duhet të kujtojmë një të vërtetë universale; teknika dhe pajisjet e humbin kuptimin nëse përfundojnë në duart e njerëzve të papërgatitur apo të pamotivuar.

Në arkitekturën tonë të sigurisë, faktori njeri mbetet shtylla kryesore. Një sistem mbrojtje është aq i fortë sa është i fortë njeriu që mban uniformën. Prandaj, investimi në siguri nuk fillon te

blerja e dronëve apo autobлиндave, por fillon shumë më herët që në bankat e shkollës. Për të pasur inteligjencë, polici dhe ushtri me mendje të ndritura, ne duhet të ngremë cilësinë e arsimit në shkollat tona fillore, të mesme dhe në universitetet. Kjo nuk është vetëm çështje pedagogjike, por parakusht i sigurisë kombëtare. Vetëm një arsim cilësor na lejon të përzgjedhim nxënësit dhe studentët më të mirë. Ata që e kuptojnë kompleksitetin e kërcënimeve moderne dhe që kanë kapacitetin intelektual për të udhëhequr në epokën e teknologjisë.

Në këto shkolla, krahas librave duhet të afirmohet fort sporti dhe aktiviteti fizik. Një rini e shëndetshme është garancia e një force mbrojtëse vitale. Pa një rini që rritet me disiplinë sportive, ne do të kemi vështirësi të plotësojmë radhët tona me individë që përballojnë dot sfidat e rënda të shërbimit. Siguria nuk është vetëm teknikë, është etikë. Ne duhet të investojmë që te të rinjtë tanë të mbillet atdhedashuria e vërtetë, jo si fjalë boshe, por si përgjegjësi ndaj vendit dhe që ushtari dhe polici ynë të jetë jo vetëm i fortë, por edhe i dinjitetshëm, duke përfaqësuar vlerat më të larta të popullit tonë.

Një tjetër element jetik që shpesh neglizhohet në debatet e sigurisë është shëndetësia. Nuk mund të pretendojmë siguri të lartë nëse nuk kemi shërbime mjekësore cilësore. Investimi në kualitetin e shërbimeve mjekësore është kusht që personeli ynë të jetë në gatishmëri të plotë fizike dhe mendore. Një zyrtar i sigurisë që ndihet i vlerësuar, që e di se shteti kujdeset për shëndetin e tij dhe të familjes së tij, është një zyrtar që nuk zbrapset para rrezikut.

Zonja dhe zotërinj,

Teknika mund të na japë avantazh në fushëbetejë, por motivimi dhe karakteri e sigurojnë fitoren. Dashuria për atdheun dhe vullneti për shërbim janë karburanti i vërtetë i sigurisë sonë kombëtare. Ne duhet ta modernizojmë ushtrinë dhe policinë tonë, por këtë modernizim duhet ta fillojmë nga njeriu. Pa një strategji të qartë që përfshin edukimin e hershëm, rekrutimin cilësor dhe mirëqenien e personelit, mjetet më të shtrenjta do të mbeten vetëm objekte dekorative. Vetëm një polic apo ushtarak i përgatitur mirë, në mungesë të kohës e burimeve të ndryshme dhe në situata stresuese, mund të sjellë vendime të drejta dhe të veprojë drejt.

T'i japim ushtarit dhe policit tonë jo vetëm mjetin më të mirë në dorë, por mbi të gjitha arsyen dhe përgatitjen më të lartë në mendje dhe zemër! Faleminderit!

KRYETARJA: Radhën nga Lëvizja Vetëvendosje e ka deputeti Egzon Azemi.

EGZON AZEMI: Atëherë, faleminderit!

Meqenëse është edhe për mua hera e parë që flas nga ky Kuvend, i falënderoj të gjithë ata që e mbështetën Lëvizjen Vetëvendosje në zgjedhjet e fundit!

Fjalimet e opozitës që u dëgjuan deri tash mund të them lirisht se janë pothuajse të njëjtat që i kemi dëgjuar ne që s'kemi qenë këtu më herët edhe nga televizori për pesë vjet me radhë. Pati fjalime edhe ndër opozitarët, sidomos i fundit i z. Quni, që megjithatë pati një kuptim, sepse pati një qasje konstruktive dhe kërkoi diçka konkrete që jam shumë dakord, mirëpo me akuza të kota siç pati më herët, me fjalime të përsëritura që pesë vjet nuk besoj që është qasje me të cilën duhet të vazhdojë punën ky Kuvend.

Për vite të tëra kam qenë vetë opozitar në Komunën e Prishtinës. Në atë kuvend, mbi 90% të pikave të rendit të ditës i kemi votuar. Pra, kemi dëshmuar që nuk kemi qasje bllokuese, siç shpeshherë shihet në Kuvendin e Kosovës.

U tha se ministritë e reja nuk paskan buxhet dhe prandaj nuk duhet të votohet ky projekt-buxhet. Por, ju e dini se rishikimi i buxhetit fillon menjëherë dhe ky problem zgjidhet. Pra, jam i bindur që shumica nga ju këtu e dini fare mirë këtë çështje, por megjithatë e problematizoni dhe tentoni që kështu ta mjegulloni opinionin publik.

Në Prishtinë, në kryeqytet, pra në buxhetin e fundit që është votuar, drejtoritë e reja që parashihet të formohen nuk janë të parapara në atë buxhet. Pra, të kritikosh, sidomos nga Lidhja Demokratike, për këtë çështje Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërkohë vetë buxhetin që është votuar në kryeqytet nuk parashihet asnjë linjë buxhetore për drejtoritë e reja, është sinqerisht hipokrizi. Përveç tjerash, u përmend dhe unaza e jashtme, e cila po ashtu nuk parashihet në buxhetin e kryeqytetit të votuar këtë vit nga Kuvendi Komunal, i propozuar nga kryetari Rama. Prandaj, këto kritika prapë po them do të ishin të mirëseardhura.

Mirëpo, qasja bllokuese dhe kjo qasje pra që i tjetëron ose e gjykon të njëjtin fenomen me dy standarde, sinqerisht besoj që edhe në zgjedhjet e fundit e keni marrë një rezultat si dënim i kësaj qasjeje, prandaj uroj që deri në fund do të reflektojmë të gjithë sa i përket kësaj pike. Faleminderit.

KRYETARJA: Radhën nga PDK-ja e ka Arben Mustafa.

ARBEN MUSTAFA: I nderuar nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot po diskutojmë për buxhetin e vitit 2026, por edhe për drejtimin ekonomik të vendit. Prandaj, fillimisht do ndalem te ekspozesa e kryeministrit, te pjesa për ekonominë. Kryeministri në vazhdimësi ka paraqitur një pasqyrë joreale sikur ekonomia e vendit po përparon shumë, po përparon në çdo drejtim. Por, dihet se ekonomia nuk matet me deklarata; ekonomia matet me numra dhe, mbi të gjitha, matet me cilësinë e jetës së qytetarëve. Kur ekonomia ecën mirë, njerëzit e ndiejnë; e ndiejnë me paga më të larta reale, e ndiejnë me vende më të mira të punës

dhe e ndiejnë me kushte më të dinjitetshme të jetesës. Kjo fatkeqësisht nuk është ajo që po e jetojnë qytetarët e Kosovës.

Në vijim, më lejoni t'i paraqes disa tregues të realitetit ekonomik në Kosovë përmes numrave. Kryeministri tha se gjatë qeverisjes së tij, norma mesatare e rritjes ekonomike ka qenë 6%. Kjo nuk qëndron! Norma mesatare është 3,6%, e cila është më e ulët sesa mesatarja prej 4,6% para se të vinit ju në pushtet. Meqë po i referoheni kësaj Qeverie si Kurti 3, atëherë mos ju ikni edhe numrave që i keni pasur në Kurti 1.

Ju keni theksuar vazhdimisht se e kemi normën më të lartë të rritjes ekonomike në rajon, por përqindjet jo gjithmonë tregojnë gjithë realitetin. Prandaj, po ju paraqes një tregues më konkret. Para se të vinit ju në Qeveri, në vitin 2019, diferenca ndërmjet ekonomisë së Kosovës, pra bruto produktit vendor të Kosovës, dhe ekonomisë së Shqipërisë ishte 6,8 miliardë euro. Në vitin 2024, kjo diferencë ka arritur në 14,6 miliardë euro. Kjo dëshmon se, përderisa ju krenoheni me përqindjet, në realitet ekonomia e Kosovës çdo ditë e më shumë po mbetet mbrapa ekonomive të tjera të rajonit.

Ekonomia jonë nuk mund t'i zërë ekonomitë e rajonit duke regjistruar norma të rritjes ekonomike prej 3,4% sikur kjo e vitit 2025, e vlerësuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar: Nuk mund t'i zërë ekonomitë e tjera duke u bazuar në politika që kanë në fokus rritjen e konsumit, por jo dhe investimet.

Po ashtu, kryeministri deklaroi se Kosova ka inflacionin më të ulët në rajon. As kjo nuk qëndron! Në dhjetor 2025 norma e inflacionit në Kosovë ishte 5,3%. Në Shqipëri 2,2%, në Mal të Zi 3,7%, në Maqedoninë e Veriut 3,6%. Pra, jo vetëm që nuk e kemi inflacionin më të ulët në rajon, por jemi dukshëm më lart se vendet përreth.

E përmendi vazhdimisht rritjen e eksporteve, por nuk i përmendni importet. E keni gjetur vendin me deficit tregtar prej 3,1 miliardë euro, ndërsa sot deficit tregtar është 6,1 miliardë euro. Kjo do të thotë se paratë e qytetarëve të Kosovës çdo ditë e më tepër po i financojnë ekonomitë e tjera, ndërsa ju këtu na flisni për zhvillim. Importin ne duhet ta zëvendësojmë me eksport. Por, për të ndodhur kjo, duhet të kemi një ambient miqësor ndaj prodhuesve vendorë. Duhet të kemi infrastrukturë që e mbështet zhvillimin. Duhet të kemi mbështetje direkte për avancim teknologjik dhe diplomaci të fuqishme ekonomike. Asnjëra nga këto nuk po ndodh. Sa u përket investimeve të huaja direkte, ju e dini shumë mirë se 74% e tyre përbëhet nga blerja e patundshmërive nga diaspora.

Në anën tjetër, në prodhim shkojnë vetëm 1,7% e investimeve të huaja direkte. Ky është ambienti i biznesit që keni krijuar. Kjo është ekonomia juaj. Nuk ka progres. Nuk ka progres në

një ekonomi ku të rinjtë e shohin të ardhmen jashtë vendit, për shkak se nuk mund të gjejnë punë të mira në Kosovë.

Në mungesë të mundësive, një popull i tërë po i mban sytë nga Qeveria për shtesa, sepse nuk ka gjë tjetër. E keni lënë një popull të presë çdo muaj, a mos do të ndahen 100 euro? A mos do të ketë një shtesë tjetër? Kjo nuk ka të bëjë me zhvillim. Kjo nuk është ekonomi që e fuqizon qytetarin. Kjo është politikë që e mban qytetarin të varur nga Qeveria.

Familjet kosovare kanë nevojë për mirëqenie më të lartë. Burrat dhe gratë, të rinjtë e të rejtat kanë nevojë për më shumë vende pune që paguhen mirë. Kanë nevojë për të hyra të qëndrueshme që sigurojnë jetë me dinjitet dhe parashikueshmëri. Kanë nevojë për arsim cilësor për familjet e tyre, për siguri shëndetësore. Kanë nevojë për një Kosovë që ecën përpara.

Tani t'i kthehemi buxhetit, më konkretisht. Përderisa ju po krenoheni me rritjen e të hyrave buxhetore, kryefjala e buxhetit tuaj nuk është ndonjë investim i madh transformues për ekonominë e vendit, qoftë në energji, në infrastrukturë apo në shëndetësi. Kryefjala e buxhetit tuaj është premtimi i pagës së 13-të për të punësuarit në sektorin publik, e cila, megjithatë, nuk arrin zotimin për rritje prej 50% që e kemi pas projektuar në projektin tonë qeverisës. Për rritje të pensioneve dhe përfitimeve të kategorive të luftës, të veteranëve të luftës, as edhe një fjalë nuk e keni thënë.

I keni paraqitur disa projekte që premtoni se do t'i realizoni. Sikur t'i dëgjonim për herë të parë, ndoshta do t'i trajtonim më seriozisht, por janë të njëjtat projekte që i dëgjuam edhe para pesë vjetëve dhe para se të vinit me këto projekte, do të ishte më e ndershme t'i jepnit llogari për pesë vjet të humbura pa asnjë projekt madhor të realizuar. Për shembull, një prej premtimeve kryesore me të cilat i patët fituar zgjedhjet e kaluara ka qenë premtimi juaj për Bankën Zhvillimore. Për pesë vjet radhazi asnjë hap konkret, as projektligj, as kapital fillestar, e as strukturë se si do të organizohet kjo bankë. Asgjë!

Sot, pas pesë vjetësh na thoni prapë se do ta bëjmë. Në buxhetin e vitit 2026 asnjë rresht, asnjë euro për Bankën Zhvillimore. Në anën tjetër na thoni se jeni në bisedime me Bankën Botërore. Për çfarë po bisedoni? Pas pesë vitesh në Qeveri, a po kërkonin që dikush tjetër t'ju tregojë se çka është Banka Zhvillimore? A nuk e keni ditur gjatë gjithë kësaj periudhe se çka është dhe si duhet të funksionojë Banka Zhvillimore? Pesë vjet janë shumë për konsultime. Pesë vjet duhet të prodhojnë rezultate konkrete.

Po ashtu, përmendët 1 miliard euro garanci kreditore për investime private. A e keni seriozisht këtë zotim? Askund në buxhet, asnjë plan për zbatimin e këtij projekti. Sa u përket investimeve kapitale, ju jeni Qeveria me performancën më të dobët në realizimin e tyre. Asnjë projekt të madh kapital infrastrukturor nuk e keni përfunduar. As rrugën për Podujevë, as për Pejë e

Gjakovë, as atë për Tetovë. Për autostradën e Anamoravës, për pesë vjet asnjë përparim konkret. Pse duhet t'ju besojmë tash? Çka keni ndryshuar? E keni lënë një rajon të tërë të torturohet dhe të rrezikohet për çdo ditë në rrugën ekzistuese. Dhe, kjo nuk është thjesht paaftësi. Kjo është përbuzje e besimit që jua ka dhënë rajoni i Anamoravës.

Prandaj, nga ky buxhet dhe nga këto politika nuk mund të presim më shumë sesa një menaxhim rutinor të shpenzimeve publike, ashtu siç bëtë edhe në mandatin e kaluar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, një minutë shtesë për deputetin.

ARBEN MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Sot, vendi ka nevojë për investime të mëdha kapitale, për fuqizim të prodhuesve vendorë dhe për një kapërcim më të madh në standardin e jetës së qytetarëve.

Dhe, për fund, duke pasur parasysh rëndësinë që e ka menaxhimi i përgjegjshëm i financave publike, dua t'ju pyes: A do të jeni më të përgjegjshëm me menaxhimin e financave publike, apo do ta vazhdoni të njëjtin avaz me mandatin e kaluar? Sepse në mandatin e kaluar ishit Qeveria me numrin më të madh të kontratave njëburimore që ndonjëherë ka pasur Kosova. Tenderë pa konkurrencë, pa transparencë dhe me dyshime serioze për korrupsion. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Janina Ymeri nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

JANINA YMERY: Faleminderit nënkryetar për fjalën!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të partive,

Të mediave,

Dhe të gjithë ata që po na ndjekin,

Meqenëse është fjalimi im i parë në foltoren e Kuvendit, do shfrytëzoj rastin shpreh falënderimet për zgjedhjen si deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës! Falënderoj së pari Zotin që më ka dhënë mundësi të jem këtu para jush dhe të punoj për të mirën e kombit tim.

Gjithashtu, falënderoj familjen time, bashkëpartiakët e mi, të cilët më kanë ndihmuar dhe më kanë besuar në rrugëtimin tim politik. Mandatin e deputetes, sot para popullit, pavarësisht nëse më ka votuar ose jo, e shoh më shumë si përgjegjësi sesa si privilegj dhe do të mundohem që të shërbej me drejtësi dhe përkushtim.

Për shkak që sot do të diskutohet buxheti, do të rezervohem nga paraqitjet e ideve për tema të tjera dhe do të fokusohem vetëm në analizën e buxhetit të Kosovës për vitin 2026. Tani, për ta

përmbledhur, buxheti i propozuar, siç u tha edhe nga kolegët e mi paraprakë, është afro 4 miliardë euro ose 3,96, dhe me anë të këtij dokumenti sot do të tregohen ku po merren paratë dhe ku po shpenzohen nga Qeveria, domethënë paratë tona nga merren dhe ku shpenzohen.

Çdo investim në shëndetësi, në arsim, në energji dhe në çdo fushë tjetër ndikohet nga ky buxhet. Pra, me këtë buxhet ndikohet ardhmëria jonë që nga investimet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në ujin që pimë, e deri te rruga ku banojmë.

Dua të shtoj se është, gjithashtu, një paradoks që ne e vërejmë se e dëgjojmë se buxheti i shtetit po rritet, siç u tha edhe nga pushteti këtu, por në fakt ne ndihemi më të varfër. Buxheti i shtëpisë sonë nuk po rritet dhe standardi i jetës sonë nuk po përmirësohet. Kjo ndodh për shkak të strukturës së burimeve të financimit që ne kemi si shtet i Kosovës, gjithashtu edhe mënyrën se si shpenzohen paratë.

Tash, burimet e financimit janë këto. Afër 75% të të hyrave tatimore janë tatimet indirekte, janë TVSH-të, dogana, akciza, para që ne nuk i vërejmë, por në fakt ato na merren dhe këto janë të lidhura thellësisht me importet edhe konsumin që ne bëjmë. Janë remitencat, paratë nga familjarët që na dërgohen neve. Pra, fitimi i korporatave fryhet edhe nga inflacioni, por në fakt, edhe pse u proklamua këtu, nuk është që po na sjell neve para, e që po e mbajnë pushtetin.

Me fjalë të tjera, buxheti po rritet nga gjërat që ne blejmë dhe importojmë, që i konsumojmë ne si popullatë e përhershme këtu dhe nga mërgata, e cila e viziton Kosovën. Kjo neve na bën një ekonomi të varur në import edhe konsum, e një shtet që e harxhon paranë e vet, por nuk prodhon jo aq sa është e dëshirueshme dhe e nevojshme.

Po t'i hiqnim nga barazimi, e nderuar popullatë, tatimet e importit, paratë e mërgatës, ekonomia e Kosovës gati se nuk do të ekzistonte fare. Por, sigurisht kjo nuk u thuhet nga pushteti. Kjo është arsyeja pse nuk është bërë asgjë konkrete, as për të zvogëluar importin, as për emigrim, se në fakt edhe nga këto mbahet kjo Qeveri, ndonëse ne si banorë po shpenzohemi, e si popullatë po pakësohemi.

Po ku shpenzohen këto para? Qeveria e kryeministrit Albin Kurti, si për pesë vjetët e shkuara, edhe këtë vit ka planifikuar t'i harxhojë paratë tona në transfere bankare, paga, subvencione, transfere, mbështetje sociale. Por, me gjasë kanë harruar ose nuk e shohin të rëndësishme, ose janë dembelë të punojnë, se neve na duhen projekte transformuese. Vetëm për një vit subvencionet e transferet kanë pasur ritmin më të lartë të rritjes mbi 17%. Ndërsa shpenzimet kapitale, ato që do të bëhen për ardhmërinë tonë, ato që zgjatim më shumë se një vit, 7% rritje.

Këtë që e them më së miri e ilustron disa shifra, si arsimi, afro 43 milionë. Sigurisht, të pamjaftueshme që vijnë nga buxheti dhe nga klauzola e investimeve. Shëndetësia, afro 59

milione, dhe këtu po e përfshij edhe SHSKUK-në. Tash, mund ta imagjinoni një ekonomi si e Kosovës, e cila e ka një shëndetësi dhe arsim të ngratë, sidomos shëndetësinë, edhe krejt investimi bëhet në 100 e pak milionë.

Po kur vijmë te ekonomia, aty ku planifikohen të gjenerohen para, çfarë është menduar aty? Sigurisht, për shkak të fushatës që e kam bërë edhe për shkak të opozitë-bërjes, shumë prej jush pritni që sot të premtohet edhe subvencionim për rrymën elektrike në rritje, por në buxhet nuk figuron.

Ministria e Ekonomisë ka paraparë dymbëdhjetë fish më shumë subvencione, transfere sesa investime nga buxheti. Në vend të investimeve të dedikuara për Ministrinë e Ekonomisë, për asetet tona, është paraparë subvencion për minierat e Trepçës, për departamentin e energjisë, por jo për faturat tona. Për Treinkos, Infrakos, Departamenti i Postë-Telekomit, Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, të gjitha subvencion, të gjitha transfer. Ku po mbetet investimi për të ardhmen tonë, për rininë tonë?

Projektet në klauzolën e investimeve, gjithashtu, janë të së ardhmes dhe nuk janë konkrete për ndryshimin e gjendjes ekonomike në shtet. Gjithashtu, as shuma prej 5,2 milionë eurove shtesë, që mund të merret nga subvencionet, nuk është e mjaftueshme për investime kapitale. Po edhe kur nisin, të nderuar, investimet ato mbeten në letër dhe jo në realitet.

Qeveria në vitin e pestë tani që ka udhëhequr në atë mënyrë që investimet kapitale nuk i ka kryer. Shumë nga këto as nuk kanë nisur, ose zgjatin për një dekadë me kryeministër Albin Kurtin. Prandaj, edhe juve ju thuhet, e nderuar popullatë, se buxheti, filan projekti është i futur në buxhet, është i regjistruar, po ju atë investim nuk e shihni kurrë.

Sa i përket rajonit 05, kështu e kemi parë stadiumin, spitalin në Ferizaj, shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, fabrikën e ujit në Sepetin, Qendra për mbetje inerte në Han të Elezit, por edhe projektet ku këta vetë qeverisin, si Shtimja dhe Gjilani, projektet vazhdojnë pambarimisht. Ato figurojnë si kode buxhetore, por ne nuk i shohim.

Dhe, ku mbetëm ne? Si ka ndikuar kjo mënyrë e menaxhimit të buxhetit? Së pari kemi minus tregtarë, ne më shumë blejmë sesa shesim. Edhe ka mundësi që shumë prej njerëzve mendojnë që i kemi kritikuar e njëjtë, por e keqja është që qeverisja është bërë e njëjtë, pa fije reflektimi.

Emigrimi. Për shkak që nuk ka pasur investime për shpresë e prosperitet, njerëzit po ikin. Sigurisht, pasi të merret shtesa po lehona e transfer për prindërit tanë nuk ka as sigurim shëndetësor, as mbështetje për të papunët. Familjarët po na ikin për siguri dhe për ardhmëri.

Rritja e çmimeve. Asgjë konkrete, siç ju tha, nuk është bërë as për inflacion dhe kjo lidhet me bazën e dobët për prodhim, ku kemi zvogëlim të prodhimit si përqindje e ekonomisë. Për krahasim, menaxhimi i ekonomisë në këtë vend, të dashur banorë të Kosovës, është udhëhequr siç është udhëhequr energjia. Ne kemi paguar gjithmonë më shtrenjtë e më shtrenjtë, por në fakt kemi pasur më pak energji.

Si përmbledhje, ky buxhet s'ka karakter investues real. Ai shpërndan para, por nuk investon. Ekonomia jonë po arnohet dhe po na jepen narkotikë financiarë. Këtë kurrkush nuk e thotë nga pushteti. Paratë nga 100 euro, që na bëjnë të besojmë se jemi më mirë financiarisht, ndërsa e blejmë produktin, e marrim prapë tatimin e produktit, Qeveria prapë na administron para, duke i mbajtur sjellë nga një transfer në tjetrin, por jo në investime. Neve na jepen para për mbijetesë mujore, kompanive, aseteve tona publike u dërgohen para për mbijetesë funksionale.

Gjithsesi, unë propozoj që buxheti të bëhet zhvillimor përmes këtyre hapave. Orientimi drejt prodhimit vendës. Pa një strategji industriale që zvogëlon varësi nga importet, çdo rritje buxhetore prej neve po përfundon në ekonomi të tjera. Po e financojmë ekonominë e Turqisë, të Gjermanisë, bile edhe të Serbisë, por jo të Kosovës.

Shfrytëzimi i hapësirës së borxhit për projekte zhvillimore duhet të investohet, jo në transfere bankare, por në energji, në transport, në digjitalizim, e që kjo nuk po ndodh. Dyfishimi i investimeve në arsim dhe në shëndetësi, meqenëse e paskemi edhe ministrin e Shëndetësisë, edhe kur hapen qendra të mjekësisë familjare nuk ka, e paska lënë edhe ky sallën, kanë ndryshuar gjërat tash. Nuk ka as staf të nevojshëm për çerdhe për qendra të mjekësisë familjare.

Reforma e prokurimit publik. Tenderët po vidhen anembanë. Po keqmenaxhohen ato sidomos me kontrata me negociata. Edhe të shkurtohet koha e implementimit të projekteve. Nuk ka nevojë që për një ndërtesë të pritet 10 vjet dhe nuk ka nevojë për një kot buxhetor të figurojë 2-3 vjet, dhe të mos shpenzohen para.

Edhe rishikimi i formulës së shpërndarjes sociale, ku rritja e transfereve sociale është e papërballueshme, nevojitet që edhe transferet të shoqërohen me trajnime për të papunët, për sigurime shëndetësore, e jo vetëm për mashtrim.

Për fund, buxheti duhet të ndryshojë nga shpërndarës - në zhvillimor. Përndryshe, këta kolegë pas, edhe kur të vijë edhe kryeministri, po e administron varfërinë tonë, e jo zhvillimin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Radha është për deputeten Albana Bytyqi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

ALBANA BYTYQI: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Qëndrimi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për buxhetin është i qartë dhe i pandryshueshëm. Kosova duhet të ketë buxhet, por jemi kundër një buxheti që sillet me procedurë të përsheptuar, pa analizë të mirëfilltë dhe pa përmbajtje të qartë zhvillimore për qytetarët, sepse buxheti nuk është dokument teknik. Buxheti është drejtimi ekonomik i shtetit.

Një nga problemet më serioze të këtij projektligji është diskriminimi në shpërndarjen e buxhetit nëpër komuna jo-Vetëvendosje dhe neni 31, përmes të cilit Qeveria pretendon se po zbaton aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO79/23 për përvojën e punës në sektorin publik.

Mbi 90 mijë zyrtarë publikë kanë pësuar dëm financiar real. Çdo vonesë e mëtejshme rrezikon mijëra padi dhe kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Prandaj, neni 31 duhet të largohet nga Projektligji për ndarjet buxhetore 2026 dhe të iniciohet menjëherë ndryshimi i Ligjit për pagat në përputhje të plotë me vendimin e gjykatës. Andaj, respektimi i gjykatës nuk është opsion, por është detyrim.

Së dyti, ky projektbuxhet ngre shqetësime serioze sa i përket shpërndarjes së projekteve kapitale në komuna. Ka një pabarazi të dukshme dhe një qasje selektive që lë hapësirë për dyshime të forta dhe diskriminim politik, e kjo shihet qartë në komunat ku kryeson Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe ku qytetarët presin punë reale, e jo lista në letër, Suharekë, Gjakovë, Rahovec, Klinë e Deçan. Andaj, investimet kapitale në Suharekë po planifikohen më shumë për vitet pasuese sesa për vitin që po e votojmë sot. Qytetari i Suharekës nuk jeton në kolonën 2028, andaj ai jeton në 2026-tën.

Si prioritet është infrastruktura rrugore, e cila del me vlerë totale rreth 11 milionë euro. Megjithatë, bujqësia me 3 milionë euro, e kjo në një komunë ku ekonomia lokale mbahet shumë nga toka, nga puna dhe nga prodhimi dhe bujqësia nuk trajtohet si motor, por si dekor.

Çka po votojmë sot për këto projekte? Asfalt, apo premtime?

Edhe te çështjet e sigurisë publike, e shohim të njëjtën logjikë të shtyrjes. Rregullimi i shtratit të lumenjve, ndërhyrjet që lidhen me përmbytjet dhe dëme që shtyhen për vitin 2028. Pra, rreziku sot, e financimi pasnesër. Për kulturë, rini e sport jepen vetëm 383 mijë euro në 2026-tën, ndërsa shtëpia e kulturës në Studençan lihet me zero euro për këtë vit. Pra, rinisë i flitet për kulturë, por i thuhet prit edhe një vit tjetër.

Në Gjakovë, edhe pse tregjet janë motorë ekonomikë, projektet e tregut të Orizës dhe Tregut të Qytetit, peshën kryesore të financimit e kanë në vitin 2027, që do të thotë se zhvillimi i tregtisë dhe gjallërimi ekonomik po zhvendosen për një vit tjetër.

Në Rahovec, projektet bazike, si kanalizimet septike nuk kanë një financim të ri në 2026-tën. Pra, zero euro! Paratë planifikohen vetëm për dy vitet pasuese. Qytetari i Rahovecit pret edhe një vit tjetër për standardin minimal. Njësoj edhe disa investime infrastrukturore lidhen me shuma më të mëdha më 2027-2028, që tregon qartë logjikën planifiko sot, realizo nesër. Jo një buxhet që jep zgjidhje brenda këtij viti.

E buxheti për vitin 2026 e ngarkon Klinën me dy barrë njëherësh, 1 milion e 691 mijë euro për projekte të bartura dhe 2 milionë e 310 euro për projekte të reja, çka e rrit rrezikun e zvarritjes së punës në terren. Në anën tjetër, disa projekte turistike rekreative kanë shuma simbolike, madje ngecin edhe me zero euro për këtë vit, dhe ka fragmentim me shumë segmente të vogla rrugësh, ndërsa bujqësia mbetet me ritëm modest, pra pa goditje zhvillimore. Pyetja logjike, a ka kapacitet real zbatimi apo po mbushen listat dhe pastaj do të na thonë: s'u realizua.

Në Deçan nga të hyrat vetjake të reja për 2026 dalin vetëm 97 mijë euro nga 550 mijë euro, që e bën komunën shumë të varur nga grantet dhe e dobëson iniciativën lokale. Madje, disa projekte bazike figurojnë pa financim të ri më 2026, pra zero euro të reja, si elektrifikimi i Bjeshkës së Belegut, asfaltimi i rrugës “Sadri dhe Adem Osaj”, duke e kthyer 2026-tën më shumë në vit të zvarritjes së punëve të vjetra sesa të nisjeve të reja reale, e me rrezik shtesë, sepse më 2027, fondi total i investimeve bie në rreth 2,9 milionë euro, që do të thotë më pak kapacitet financiar për t'i çuar përpara edhe ato projekte të cilat i kanë në listë.

Andaj, të nderuar kolegë, këtu s'po flasim a ka buxhet apo s'ka buxhet. Po flasim a ka drejtim apo s'ka drejtim, sepse qytetarët nuk kanë nevojë për lista projektesh të copëzuara, kanë nevojë për projekte që mbyllen, për kanalizime që nisin më 2026, për mbrojtje nga përmbytjet që shtyhen për vitin 2028, për tregje që hapin ekonomi dhe për bujqësi që trajtohet si prioritet, e jo si shtojcë.

Andaj, kërkesa jonë si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës është kohë për analizë më të thellë dhe rishikim real të buxhetit. Grante zhvillimore për komunat, rritje reale të investimeve kapitale dhe fonde për sektorët ekonomikë lokalë, sepse vetëm kështu projektligji bëhet buxhet zhvillimi.

Dhe, në fund, qytetarët nuk na kanë votuar që ta mirëmbajmë status quo-n, na kanë votuar për ta ndryshuar atë. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.)

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti i PDK-së, Kujtim Gashi.

KUJTIM GASHI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Sot po e trajtojmë një nga dokumentet më të rëndësishme të shtetit, buxhetin e Republikës së Kosovës, i cili duhet të ishte i qartë me prioritete politike, projekte kapitale sociale dhe zhvillimore.

Fatkeqësisht, projektbuxhetit që kemi përpara nuk reflekton barazi, solidaritet dhe partneritet të sinqertë me nivelin lokal të qeverisjes. Komunat që janë kontakti i parë i qytetarit me institucionet nuk po trajtohen si partnerë të barabartë në zhvillim, madje në disa raste, sidomos në komunat e mëdha, mbështetja për komunat është për keqardhje.

Komunat sot përballen me sfida të mëdha, rritje të kërkesave për shërbime publike, nevoja për investime në infrastrukturë lokale, në arsim, në shëndetësi dhe në mirëqenie sociale. Megjithatë, përkundër rritjes së përgjithshme të buxhetit, nuk po shohim një rritje proporcionale dhe të drejtë për komunat e Republikës së Kosovës. Përkundrazi, shumë projekte kapitale janë përqendruar në mënyrë selektive, duke krijuar perceptim dhe bindje për diskriminim financiar ndaj komunave që nuk udhëhiqen nga partia në pushtet.

Buxheti i shtetit nuk duhet të jetë mjet shpërblimi për partinë në pushtet, as mjet ndëshkimi për ata që mendojnë ndryshe politikisht. Paratë publike janë të qytetarëve, jo të partive. Çdo komunë, pa dallim përkatësie politike, meriton trajtim të barabartë dhe mbështetje të drejtë, bazuar në nevojat dhe kriteret e qarta zhvillimore.

Një çështje tjetër thelbësore, që nuk është adresuar, është barra e Kontratës Kolektive për komunat. Vendimet për zbatimin e saj janë marrë në nivel qendror, por faturat financiare u janë lënë komunave. Kjo qasje është e padrejtë dhe e papranueshme. Nuk mund të marrim vendime politike në qendër dhe pastaj t'ua transferojmë koston financiare të qeverisjeve lokale pa mbështetje shtesë buxhetore.

Kjo krijon një presion të madh mbi buxhetin komunal, rrezikon investimet kapitale dhe kufizon mundësinë për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Në vend që komunat të fokusohen në zhvillim, ato detyrohen ta menaxhojnë mungesën e mjeteve dhe t'i shlyejnë borxhet nga procedurat përmbarimore.

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në Kosovë duhet ta forcojë nivelin lokal, jo ta dobësojë atë. Duhet të krijohet një formulë transparente dhe e drejtë e ndarjes së mjeteve që

garanton barazinë e investimeve kapitale dhe që merr përgjegjësi nga niveli qendror për obligimet që burojnë nga vendimet e nivelit qendror.

Buxheti duhet të jetë instrument i zhvillimit të barabartë rajonal, i fuqizimit të komunave dhe i rritjes së mirëqenies së qytetarëve, jo dokument që thellon ndasitë politike dhe financiare dhe diskriminon komunat në baza partiake.

Ky buxhet ka mangësi të theksuara. Nuk ka projekte të mëdha kapitale. Nuk adreson problemet me të cilat ballafaqohet sot vendi ynë dhe nuk përmbush as për së afërmi nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Gashi! Fjala është për deputetin Besian Mustafa.

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Në javën e kaluar natyrisht e pamë kryeministrin Kurti duke e shpalosur vizionin e tij për katër vjetët e ardhshme. Në të foli dhe për rritjen ekonomike për pesë vjetët e kaluara, por çuditërisht e fatkeqësisht harroi të flasë për rritjen e çmimeve në këto pesë vjet: rritjen e çmimeve të energjisë, të ushqimit, të jetesës në përgjithësi për qytetarët e Kosovës.

Javën e kaluar po ashtu kryeministri foli edhe për rritjen e punësimit, por harroi të flasë për rritjen e ikjes së rinisë, e cila ka humbur çdo shpresë për të jetuar e për të parë perspektivë në këtë shtet, fatkeqësisht. Përderisa javën e kaluar kryeministri shpaloste vizionin e tij për katër vjetët e ardhshme, ministri i Financave me gjasë luante në telefon, sepse s'kishte marrë asnjë shënim, sepse këtu të premten në Kuvend na e solli buxhetin e vjetër e jo buxhetin që do të financonte vizionin e kryeministrit për katër vjetët e ardhshme.

Ministër Murati, është e çuditshme, je pesë vjet ministër i Financave, zgjedhjet i keni fituar më 28 dhjetor, pra para tetë javësh. Çka ke bërë këto tetë javë që nuk e ke sjellë një buxhet që reflekton vizionin katërvjeçar të kryeministrit ose të shefit tënd të qeverisë?

Keni vepruar sikur ata nxënësit e shkollës fillore që janë në pushim dimëror ose veror, gjatë gjithë kohës luajnë “Sony Playstation”, në atë natën e fundit para se të rifillojë mësimi çohen e gjejnë diku një kopjim të hartuar që ta dorëzojnë, që po e pranon ministri që ka luajtur “Sony Playstation”, që të nesërmen, një natë para se të kryhet pushimi t’ia dorëzojnë arsimtarit një hartim të kopjuar sa të thuhet që e ka një hartim. Javën e kaluar, po edhe sot edhe vetë ministri Murati tha “e kam sjellë një buxhet veç sa ta kemi këtu”, një buxhet sikur hartimi i kopjuar që e sjell aty veç sa ta kenë një buxhet, por realisht po e përsërisim edhe një herë, nuk reflekton asgjë

nga ajo që tha kryeministri për katër vjetët e ardhshme që natyrisht do të duhej të reflektonte në buxhet për të parë se cilat nga këto prioritetë janë të buxhetuara së paku për tre vjetët e ardhshme.

Ministri i Financave javën e kaluar tha buxhetin e sjell të rishikuar në mars. Pastaj, kryeministri tha në muajt në vijim, ju kisha lutur ta definoni kur e sillni buxhetin e rishikuar që reflekton edhe vizionin e juaj katërvjeçar, edhe strukturën e re qeverisëse dhe çdo gjë tjetër. Natyrisht, ministri i Financave e kishte shtirë aty një hile, që u zbulua shumë shpejt, tek neni 11, ku i kërkon këtij Kuvendi që t'ia aprovojë, t'ia nënshkruajë dhe t'ia vulosë një fletë të bardhë, të cilën pastaj Hekurani shkon në zyrën e tij dhe vendos të shkruajë çka t'i ka qejfi në të, sepse atje në fund e ka nënshkrimin dhe vulën e Kuvendit të Kosovës.

Ministër, besoj e di, e di që e di këtë punë, Kuvendi i Kosovës është i vetmi ai që aprovon buxhetin e secilës linjë, e jo ju. Pra, është e çuditshme, të mos e cilësoj ndryshe që të kërkon që Kuvendi i Kosovës t'ju aprovojë blanko 4 miliardë euro buxhet që ju pastaj të vendosni çdo muaj se si i ndani ato nëpër ministri e nëpër linja buxhetore.

Unë po shpresoj që deputetët, së paku deputetët e koalicionit qeverisës janë të vetëdijshëm që ju e keni bërë Hekuranin ministër e jo Hekurani juve deputetë. Për këtë hartim të kopjuar keq ishte dashur ju që t'ia jepni një njesh të madh Hekuranit, t'ia ktheni këtë buxhet, le ta sjellë pas një jave, sot një javë si dënim, një buxhet i cili reflekton edhe katër vjetët e ardhshme, edhe organizimin e ri qeverisës, e pastaj diskutojmë dhe shohim se çka ka bërë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Veton Berisha.

VETON BERISHA: E nderuar kryetare, zonja Haxhiu!

I nderuar zoti kryeministër Kurti,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po ashtu dhe unë shfrytëzoj rastin që ta uroj komunitetin ashkali për ditën e tyre, veçantë përfaqësuesin, kolegun tim, përfaqësuesin e këtij komuniteti, zotin Artan Asllani dhe uroj çdo të mirat dhe ky vit dhëntë Zoti që të jetë vit i mbarë dhe zhvillimor për këtë komunitet.

Po ashtu, mora të drejtën time për të dhënë sadopak kontribut në çështjen, e cila për mua është çështja më e rëndësishme që diskutohet çdoherë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Si përfaqësues i komunitetit egjiptian normalisht që kam për obligim ta pasqyroj situatën ose nevojat e komunitetit tim, në mënyrë që edhe me programin qeveritar ky buxhet ose buxheti i cili do të jetë në rishikim, sepse po flas në një situatë ku e di që do të ketë rishikim dhe atëherë me siguri do të kem mundësi ta jap më tepër kontribut në çështjet konkrete, edhe në situatën në të

cilën jemi. Normalisht unë e konfirmoj votën time pro këtij projektbuxheti, për faktin që nuk jam i interesuar që të ketë asnjë lloj bllokade të çfarëdo lloj natyre.

I nderuar zoti kryeministër, unë vetëm po i cek disa çështje, të cilat i kam të dorëzuara tek ju si program, i cili vjen direkt nga nevojat e komunitetit dhe normalisht pres që ministritë e linjës të kenë reflektim në këto çështje e që ka të bëjë që akoma mbetet si çështje kryesore, problematika e arsimimit në komunitetin tonë dhe normalisht që ne do të kërkojmë që të ketë rritje të bursës aktuale për shkollat e mesme dhe të larta nga 300 euro në 500 euro në vit, për shkak që duke i parë shpenzimet dhe nevojat e mëdha, kërkohet normalisht që të ketë edhe rritje të bursës.

Po ashtu, të ketë përfshirje të bursave dhe për nivelet e drejtime të tjera, jo vetëm të kufizuara, sepse vazhdimisht marrin të njëjtit në drejtime të njëjta.

Kërkojmë që të ketë buxhet, të planifikohet buxhet në planifikimin ose mbështetjen e qendrave mësimore për mësimnxënie, sepse kjo është një fushë, e cila vërtet e ndihmon procesin e mësimnxënies dhe, po ashtu, ju e dini që një pjesë e madhe e pjesëtarëve të komunitetit egjiptian dhe komuniteteve të tjera në këtë rast mësimin e fillojnë një vit më vonë, për faktin që një pjesë e madhe e tyre nuk e ndjekin procesin parafillor dhe kjo normalisht që nuk na bën të barabartë në procesin e mësimin dhe ne kërkojmë që të gjithë nxënësit, të gjithë pjesëtarët ose fëmijët e komuniteteve tona, komunitetit egjiptian të përfshihen edhe në procesin parafillor. Pra, duhet të ketë një plan se si t'i dërgojmë dhe si ide ka dalë që duhet të ketë çerdhe në afërsi të vendbanimeve të këtyre komuniteteve.

Në fushën e punësimit dhe ekonomisë do të kërkojmë që të ketë mbështetje për bizneset e vogla dhe të mesme, sepse shumë nga pjesëtarët e komunitetit janë të gatshëm të ndërmarrin kësi veprimesh, ku kanë mundësi të kenë vetëqëndrueshmëri ekonomike, mbështetje të projekteve startape, sepse edhe të rinjtë, gratë dhe personat e tjerë kanë mundësi me një mbështetje sado të vogël të kenë një stabilitet ekonomik.

Po ashtu, tek ne është problem përfshirja e komuniteteve në pjesën e 10%-shit në punësimin, sidomos në sektorin publik. Sigurisht që ka qenë problem gjithmonë që s'ka një planifikim buxhetor. Do të doja të ketë vëmendje në këtë aspekt, sepse Ligji për zyrtarët e lartë publikë kërkon që të ketë buxhet në mënyrë që të ketë konkurse dhe pjesëtarët e komuniteteve të përfshihen.

Bujqit dhe blegtorët janë kategori jashtëzakonisht e rëndësishme për neve dhe pres që ky buxhet të reflektojë po ashtu në mundësinë që ata të përfitojnë. Tek fusha e shëndetësisë është e nevojshme, po konsiderohet që ka nevojë të ketë buxhet shtesë për rastet e shërbimeve shëndetësore mobile, për faktin që ka plot arsye që familjet tona për shkak edhe të kushteve

ekonomike, por dhe për shkak të neglizhencave të ndryshme nuk i frekuentojnë qendrat mjekësore. Ka shumë rëndësi vaksinimi, kompletimi i vaksinimit për të gjithë fëmijët.

Në kuadër të mirëqenies sociale, një kategori e cila është vërtetë akoma prezente te ne dhe normalisht ne jemi të kufizuar për shkak që nuk e dimë se kujt do t'i takojë si fushë, sepse tash riorganizimi i ministrive dhe për mua është goxha e paqartë dhe normalisht tash s'mund të jap kontribut se cilës ministri do t'i takojë kjo pjesë, por do të kërkoj që të ketë buxhet të mjaftueshëm në trajtimin e lëmshëkërkuësve, sepse flitet shpesh që nuk ka mekanizma institucionale, s'ka plane buxhetore që lëmshëkërkuësit të trajtohen në mënyrë institucionale.

Dhe një çështje shumë me rëndësi që është nevojë, ka filluar të bëhet nevojë e kohës është ndërtimi i shtëpive dhe renovimi i shtëpive për familjet me nevojë. Një çështje shumë e nevojshme dhe di që kjo do të jetë si kërkesë e krejt neve, por duhet ta dimë saktë se kush do ta menaxhojë këtë proces. Pra, ky proces është shumë i ndejshëm dhe unë pres që të ketë buxhet, po të njëjtën kohë edhe t'i besohet ky proces që ky përfitim të shkojë direkt te familjet dhe të mos përfitojë dikush tjetër nga ky proces.

Nën pesë, kam infrastrukturën, pra e gjithë jeta e komunitetit tonë kemi akoma probleme me gjërat elementare, siç janë: infrastruktura nëntokësore dhe mbitokësore. Pra, akoma kemi probleme me rrugë, me ujësjellës, kanalizim, ndriçime, trafo e të tjera. Dhe një çështje që goxha e shëmtuar duket tek ne është mostrajtimi i mbeturinave te familjet ku jetojnë komunitetet dhe normalisht që ne presim të ndërmerren veprime konkrete.

Kulturë, rini dhe sport, një masë e madhe e të rinjve kërkojnë që t'i ndalojmë këtu dhe të kenë aktivitete dhe normalisht shpresë që të zhvillojnë talentet e tyre. Pra, do të kërkojmë që në kuadër të buxhetit, në kuadër të programit qeveritar dhe buxhetit, i cili do të vijë në rishikim, të ketë buxhet ku do të kemi hapësira rinore për të rinjtë, të cilët do të zhvillojnë aktivitetet e tyre në nivele të komunave. Investim në klube, të gjitha sportet, që janë shumë tash nga radhët e komunitetit dhe normalisht që ata i zhvillojnë aktivitetet, por ka nevojë për mbështetje dhe investime në sport, kulturë, rini.

Pra, të gjitha këto fusha do të jenë çështje të cilat do t'i trajtojmë me kohë, di dhe e pres mbështetjen e qeverisë, në veçanti zotit Kurti, sepse e kemi marrë këtë zotim dhe pres që ky vit, përfundimi i këtij viti të jetë vërtetë vit me rezultate të sakta, sepse dhe ne kemi obligim të jemi të sigurtë me rezultate, të cilat arrihen te komuniteti dhe normalisht ne si përfaqësues kemi për obligim të jemi të sigurtë dhe që të mundohemi që e mira të mbërrijë te populli, e jo të mbesë rrugës pa mbërritur te populli.

Faleminderit! Edhe unë, ashtu siç e deklarova në fillim, do ta mbështes projektbuxhetin, domethënë në këtë lexim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputet Berisha! Tani e ka radhën deputetja Arbnore Salihu.

ARBNORE SALIHU: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm.

Sot po diskutojmë për dokumentin më të rëndësishëm financiar të shtetit, Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Projektligji për buxhetin nuk do të duhej të na vinte me kaq nguti as të premtën, e as sot, sepse kemi të bëjmë me dokumentin më të rëndësishëm financiar të shtetit.

Ky dokument meriton kohë të mjaftueshme për analiza serioze, shqyrtim të thellë, profesional dhe të përgjegjshëm. Natyrisht, ju mund të zgjidhni të mos e merrni aq seriozisht, sepse siç po shihet edhe në këtë dokument që kemi pranuar, mjetet financiare po i bartni sipas qejfit, pa kriterë të qarta dhe pa bazë të qëndrueshme. Shumë projekte po bllokohen, po pengohen, ndërsa komunat po trajtohen në mënyrë selektive, varësisht secila parti i qeverisë.

Ndoshta për ju buxheti është thjesht një tabelë me shifra që mund të rregullohet sipas interesit tuaj, por për qytetarët është përcaktues i mënyrës së jetesës, zhvillimit dhe shërbimit publik dhe pikërisht për këtë arsye ky dokument meriton të trajtohet me seriozitet të shtuar. Buxheti është kontrata jonë me qytetarin dhe duhet të sigurohemi që të jetë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e tyre. Buxheti duhet të jetë garanci e mirëqenies dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, por ky projektbuxhet që e kemi pranuar bie ndesh me këto parime themelore.

Në këtë dokument nuk pasqyrohen qartë prioritetet e kësaj qeverie dhe nuk adresohen nevojat reale të qytetarëve, të komunave që kanë mungesë infrastrukturore bazike dhe të kategorive të ndjeshme të shoqërisë. Së pari, dua të vë theksin te një projekt jetik për bashkëqytetarët e mi: përfundimi i objektit të spitalit të Ferizajt. Projekti i spitalit ka nisur në vitin 2018 dhe ishte paraparë të përfundohej në vitin 2021. Gjatë rrugës janë marrë vendime jo të duhura, të dëmshme, të cilat kanë shkaktuar pasoja për qytetarët ferizajas. Është e dhimbshme, fillimisht për pacientët, në çfarë ambientesh trajtohen, e pastaj edhe për personelin shëndetësor, i cili punon në kushte të mjerueshme.

Në vitin 2024 Ministria e Shëndetësisë kishte dhënë zotim publik se spitali do të përfundonte në vitin 2026, pra në këtë vit, por sot punimet janë ende pothuajse në fazën fillestare të realizimit. Kjo tregon qartë mungesë planifikimi serioz dhe zvarritje të pajustificueshme të këtij projekti. Deri në vitin 2025 janë shpenzuar vetëm 1.8 milionë euro të parapara për këtë projekt, ndërsa mbi 19 milionë euro janë planifikuar tek në vitin 2028. Siç po e shohim me këtë ritëm, përfundimi i këtij objekti mbetet i pasigurt, i bie që as në vitin 2029 e ndoshta as në vitin 2030 të mos përfundojë.

Të gjithë e dimë kontributin e qytetit Ferizaj si taksapaguesi i dytë në Kosovë, por kjo nuk është e vetmja arsye pse Ferizaj meriton që ky projekt të përfundojë sa më shpejt që është e mundur. Ky spital nuk u shërben vetëm banorëve të Ferizajt, por aty trajtohen edhe qytetarë të Kaçanikut, Hanit të Elezit, Shtimes, Shtërpçës dhe jo vetëm. Ndërkohë objekti aktual nuk i plotëson as kriteret për të qenë spital. Ka vetëm 12 shtretër për trajtim e intervenime emergjente. Imagjinojeni, 12 shtretër për një regjion të tërë. Kjo situatë është alarm serioz për shëndetin publik. Prandaj, është qenësore që të rritet shuma e mjeteve të ndara për vitin 2026 dhe ky projekt të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Por, fatkeqësisht ky nuk është i vetmi projekt ku mungon serioziteti në planifikim. I njëjti mentalitet është reflektuar edhe në projekte të tjera jetike për qytetarët në të gjitha komunat e Kosovës. Ja një shembull tjetër: te projekti Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj për vitin 2026 nuk keni planifikuar asnjë mjet të ri, asnjë mjet të ri. Janë vetëm mjete të bartura nga planifikimi i mëhershëm, ndërsa pjesa kryesore e financimit, plot 12 milionë e 50 mijë euro, janë planifikuar për vitin 2027, dhe a e dini çfarë do të thotë kjo? Vazhdim i ndotjes, rrezik për shëndetin publik, pasoja mjedisore afatgjata dhe pengesë serioze për zhvillimin ekonomik të Ferizajt dhe regjionit.

Prandaj, kërkoj që dinamika e financimit të rishikohet dhe të paktën gjysma nga shuma totale që është 12 milionë e 50 mijë sa janë planifikuar në vitin 2027 të avancohet në vitin 2026 në mënyrë që projekti të përshpejtohet. Ky është një projekt me rëndësi të madhe dhe nuk mund të shtyhet pafundësisht. Pas projekteve që lidhen drejtpërdrejt me shëndetin dhe mjedisin, po ndalem edhe te një tjetër projekt me rëndësi për zhvillimin e Qytetit të Ferizajt, e që është infrastrukturë bazike për rininë dhe sportin.

Sa i përket ndërtimit të Stadiumit të Qytetit të Ferizajt, planifikimi është jashtëzakonisht i dobët. Deri në vitin 2025 për këtë projekt janë shpenzuar vetëm 167 mijë euro, janë paraparë 1 milionë e 500 mijë euro si vazhdim nga viti 2025, por mjete të reja për vitin 2026 nuk ka fare. Për vitin 2027 janë planifikuar 2 milionë e 500 mijë euro, ndërsa në vitin 2028 janë planifikuar 8 milionë e 500 mijë euro. Pra, i bie që me këtë dinamikë stadiumi as në vitin 2029 nuk mund të realizohet. Ky është një projekt i rëndësishëm për sportistët, për të rinjtë dhe për zhvillimin lokal.

Njëjtë edhe te projekti Qendra Multifunksionale, situata është po aq shqetësuese. Janë paraparë vetëm 300 mijë euro si vazhdim nga viti 2025. Deri në vitin 2025 janë shpenzuar rreth 1 milion e 210 mijë euro, ndërsa për vitin 2026 ju keni planifikuar vetëm 300 mijë euro. Për çfarë arsye nuk është rritur vlera e mjeteve për vitin 2026? Pse fondet janë shtyrë për vitet 2027 dhe 2028, në të cilat janë planifikuar 1 milion euro për secilin vit? Çfarë është ky lloj planifikimi, ministër? Cila është arsyeja që projekti praktikisht pauzon në vitin 2026 me vetëm 300 mijë euro. Qendra Multifunksionale është hapësirë për rininë, për aktivitete kulturore, sociale dhe komunitare. Me këtë dinamikë financimi, projekti nuk përshpejtohet, përkundrazi vetëm vonohet.

Në vazhden e kësaj qasjeje selektive dhe të pashpjegueshme në ndarjen e mjeteve buxhetore, situata bëhet edhe më e dukshme tek projektet e reja në kuadër të MKRS-së. Vlera e projekteve të reja të ndara për vitin 2026 është 9 milionë e 884 mijë euro. Nga kjo shumë asnjë cent nuk është ndarë për projekte të reja në Komunën e Ferizajt, asnjë projekt i ri. Pse është përjashtuar Komuna e Ferizajt? Cili është kriteri i këtij përjashtimi? E, situata bëhet edhe më paradoksale kur tashmë në këtë mandat qeverisës MKRS është ndarë në dy ministri: Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit dhe Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, ndërsa në buxhet vazhdon të figurojë si MKRS. Pra, kemi ndarje të ministrive, por në letër e planifikim nuk figurojnë. Edhe një dëshmi shtesë e këtij dokumenti është kjo se i mungon ekspertiza dhe planifikimi i mirëfilltë dhe se projektet për rininë nuk merren seriozisht ashtu siç thuhet.

Ndërsa, në tjetrën anë që nga fillimi i vitit 2025, Albin Kurti së bashku me Kabinetin e tij kanë shpenzuar për vetëm nëntë muaj 27,3 milionë euro. Sipas raportit të Ministrisë së Financave, Kosovës i kanë kushtuar 3,8 milionë euro shpenzime telefonike, 8,6 milionë euro për udhëtime zyrtare, 15 milionë euro për derivate. Që nga viti 2021 deri në vitin 2025 kemi parë vetëm rritje të vazhdueshme në këto kategori shpenzimesh. Në një periudhë kur qytetarët po përballen çdo ditë me çmimet më të larta, me kosto jetese të papërballueshme dhe me pasiguri ekonomike, ndërsa Qeveria rrit shpenzimet për shërbime telefonike, udhëtime dhe vetura zyrtare.

Për më tepër, Albin Kurti i kanë shërbyer xhipat e zinj për të shëtitur Kosovën skaj më skaj në periudhat e fushatave zgjedhore. Ky është veç një shembull se si janë shpërdoruar taksat e qytetarëve dhe sot nga e njëjta qeveri kërkohet besim i ri pa llogari për të kaluarën. Po kërkohet votë për buxhetin duke refuzuar të raportohet për vitet e shkuara. Transparenca dhe llogaridhënia sa u përket shpenzimeve buxhetore është obligim ligjor i qeverisë. Si mund të kërkohet votim i buxhetit për vitin 2026 kur mungojnë raportet financiare, raportet e punës, raportet e auditimit të Qeverisë për vitet 2024 dhe 2025. Njësoj ka ndodhur edhe me dhjetëra institucione të pavarura që janë të obliguara të raportojnë për shpenzimet buxhetore në Kuvend.

Pra, ne sot nuk kemi një pasqyrë të qartë se si është menaxhuar paraja publike për dy vjetët e fundit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Përmbylle fjalën edhe një minutë, e nderuar deputete!

ARBENOR SALIHU: Ligji për menaxhimin e financave publike lejon mekanizmin e financimit të përkohshëm përmes ndarjes së 1/12 buxhetit të vitit paraprak edhe për muajin mars, deri në miratimin e buxhetit të ri. Institucionet mund të vazhdojnë funksionimin normal përfshirë pagat dhe të gjitha obligimet e tjera edhe pa miratimin e menjëhershëm të buxhetit të plotë.

Pra, arsyetimi që jemi para një bllokade institucionale nuk qëndron. Ne sot jemi para një kërkesë për votë pa llogaridhënie. Si mund të votohet ky projektbuxhet që udhëhiqet nga një kryeministër, i cili me kabinetin paraprak nuk ka përmbushur obligimin ligjor për raportim para Kuvendit. Pa transparencë nuk mund të ketë mirëqenie. Projektbuxheti për vitin 2026 duhet të jetë një dokument, ku çdo projekt është i planifikuar mirë, çdo shpenzim është i arsyetuar saktë dhe çdo qytetar është i sigurt se paratë e tij menaxhohen ndershëm dhe me përgjegjësi.

KRYETARJA: Faleminderit! Tani është radha e deputetit Fadil Hadërgjonaj. Vetëm pak, i nderuar deputet, sepse janë paraqitur për replikë.

Deputetja Shqipe Metaj.

SHQIPE METAJ: Faleminderit, e nderuar kryetare!

U përmend puna e projekteve në Ferizaj, me të vërtetë është për t'u habitur, po ta thoshte ndonjë deputet i ndonjë qyteti tjetër, ndoshta s'do të befasonesha, mirëpo edhe deputetja nga LDK-ja që më duket jeton në Ferizaj, po ashtu dhe parafolësja nëse jetojnë në Ferizaj, atëherë duhet shumë mirë ta dijë krejt punën e spitalit. Më së paku duhet drejtuar gishtin nga Qeveria. Edhe Qendrën Multifunktionale, QKMF-në, stadiumin e qytetit, edhe spitalin e qytetit ka për t'i kryer Qeveria Kurti. Faleminderit.

KRYETARJA: Faleminderit! Ju lutem që replikat i bëni kur i referohet fjalës apo emrit. Tani është radha për kundër-replikë. A dëshironi deputete?

ARBENOR SALIHU: Po, po, patjetër që i përgjigjem kësaj replike, por unë nuk i përmenda emrin deputetes në fjalë, por kjo deputete e di shumë mirë që në Legjislaturën VIII të gjithë deputetët që kanë qenë të Lëvizjes Vetëvendosje prej Ferizajt nuk kanë kaluar asnjë amendament për qytetin e Ferizajt. Ka fakte, ka argumente, ka video për këtë për këtë që po e them. Kështu që sa i përket çështjes edhe interesimit të tyre për qytetin tonë, për qytetin e Ferizajt, këta e kanë dëshmuar me votë. Vota e tyre ka qenë kundër projekteve, të cilat kanë për qëllim zhvillimin e Ferizajt. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Edhe një herë replikat lejohen kur të përmendët emri dhe kur i referoheni fjalimit. Ju lutem që të bazoheni në Rregulloren e Kuvendit. Me emër të përveçëm unë nuk e dëgjova që ju përmendi, prandaj fjala është për z. Hadërgjonaj.

Deputet Hadërgjonaj, fjala është për ju!

FADIL HADËRGJONAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Media,

Të dashur qytetarë,

Buxheti për siguri dhe mbrojtje, çfarë do të duhej të sigurate? Siguria dhe mbrojtja janë themelet mbi të cilat ndërtohet stabiliteti i shtetit. Pa siguri nuk ka zhvillim ekonomik, nuk ka investime të qëndrueshme, nuk ka mirëqenie sociale dhe as besim qytetar në institucione.

Siguria nuk është shpenzim, është investim strategjik në vazhdimësinë e shtetit dhe në të ardhmen e qytetarëve tanë. Buxheti vjetor për sigurinë dhe mbrojtjen duhet të trajtohet me seriozitet të lartë profesional, larg improvizimeve dhe larg logjikës së ditës. Ai duhet të mbështetet në vlerësim real të rreziqeve, në planifikim afatgjatë dhe në objektiva të matshme. Synimi ynë duhet të jetë i qartë. Të ndërtojmë forca të sigurisë dhe të mbrojtjes mirë të motivuara, mirë të stërvitura dhe mirë të pajisura. Forca që reagojnë shpejt e me vendosmëri dhe që përmbushin çdo detyrë kushtetuese dhe ligjore.

Së pari, menaxhimi i resursit kryesor - njeriut. Fuqia reale e sigurisë dhe mbrojtjes nuk qëndron vetëm te teknologjia, por te personeli. Prandaj, buxheti duhet të garantojë kushte dinjitoze shërbimi, paga konkurruese dhe motivuese, trajtim të barabartë dhe meritokratik, arsimim profesional dhe avancim të vazhdueshëm, stërvitje të rregullta dhe standarde operacionale të përditësuara, programe motivimi dhe zhvillimi të lidershit në çdo nivel komandues. Investimi në personel rrit jo vetëm kapacitetin operacional, por edhe integritetin institucional dhe shpejtësinë e reagimit në terren.

Së dyti, adaptimi i kapaciteteve sipas vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve. Planifikimi buxhetor duhet të bazohet në analiza të strukturuar të mjedisit të sigurisë. Kërcënimet janë dinamike, hibride, kibernetike, asimetrike dhe kërkojnë fleksibilitet strukturor. Kapacitetet duhet të ndërtohen sipas skenarëve realë me njësi të gatshme, për reagim të shpejtë dhe komandim të qartë.

Së treti, modernizimi i pajisjeve, i sistemeve dhe infrastrukturës. Modernizimi nuk duhet të jetë sporadik, por programor dhe shumëvjeçar për pajisje moderne operacionale, sisteme komunikimi dhe komandimi të integruara, mbrojtje kibernetike, infrastrukturë funksionale, stërvitore dhe operative. Çdo investim duhet të lidhet drejtpërdrejt me rritjen e gatishmërisë, shpejtësinë e reagimit, ndërveprueshmërinë dhe efikasitetin në përmbushjen e misionit.

Së katërti, aspekti logjistik dhe rezervat strategjike: Qëndrueshmëria e forcave të sigurisë matet me aftësinë për të operuar gjatë dhe pa ndërprerje. Kjo kërkon zinxhir furnizimi të sigurt, rezerva materiale dhe teknike, mirëmbajtje të garantuar, kapacitete mbështetëse për situata emergjence. Logjistika e fortë garanton veprim të shpejtë dhe performansë të qëndrueshme.

Së pesti, projekt-buxheti për vitin 2026: Projekt-buxheti për vitin 2026 duhet të ndërtohet mbi pesë shtylla: rritje të qëndrueshme të financimit për personel dhe motivimin e tij; program modernizimi shumëvjeçar me faza të qarta; fond të dedikuar për trajnim, stërvitje dhe zhvillim lidërsipi; investime të veçanta në kapacitetet e reagimit të shpejtë dhe mbrojtje kibernetike; rezerva strategjike buxhetore për reagim të menjëhershëm në kriza.

Buxheti i sigorisë dhe mbrojtjes duhet të matet me gatishmëri, shpejtësi reagimi dhe përmbushje misioni, jo vetëm në shifra. Transparencë, kontroll parlamentar dhe efikasitet operacional duhet të jenë parimet udhëheqëse. Siguria e shtetit është përgjegjësi mbipartiake. Është detyrim institucional dhe moral ndaj qytetarëve tanë.

Të nderuar,

Meqë po flasim për fushën e sigorisë dhe mbrojtjes, por edhe për buxhetin e këtij viti, jemi koshientë dhe të vetëdijshëm se themelet e mekanizmave të sigorisë qëndrojnë mbi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe janë trashëgimtare e kësaj vlere. Ne do të duhej që dhe përmes buxhetit dhe planifikimeve buxhetore t'i kultivojmë dhe t'i respektojmë këto vlera në maksimum.

Në planifikimin e buxhetit pashë një rubrikë atje ku janë të planifikuara shpenzimet për mirëmbajtjen apo te Agjencia e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Në një nga rubrikat pashë edhe planifikimin buxhetor që është paraparë për kompleksin memorial në Koshare. Si projekt ka filluar kaheër; gur themeli i këtij projekti është vendosur më 9 prill 2012, është shpallur dhe ka vazhduar.

Para pandemisë është shpallur një tender për t'i kryer disa punime, të cilat e kapnin vlerën prej 2 milionë eurosh. Pastaj, pasi që asgjë nuk ka ndodhur me atë tender, ka vazhduar ritenderimi në vitin 2022 nga Qeveria e kaluar për të vazhduar me punime.

Mirëpo, deri në këtë moment, asnjë punim nuk është zhvilluar. Çka është edhe më për keqardhje, nga të gjitha ato vlera të cilat ishin parashikuar atëherë, pa marrë parasysh edhe inflacionin edhe vlerën fuqinë që kishte dymilionëshi i vitit 2022, për vitin në vijim, Qeveria aktuale ka parashikuar për këtë kompleks 50 mijë euro dhe për vitin 2027 edhe 50 mijë dhe përfundon në vitin 2028 me 20 mijë euro, që vërtet nuk përputhet as me ritenderimin dhe projektin të cilin vetë Qeveria e ka shpallur në vitin 2022.

Ndaj, kisha kërkuar që të fokusohemi më tepër në këtë aspekt dhe në vlerësimin, respektimin e vlerave dhe trashëgimisë mbi të cilën qëndron edhe vetë shteti. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit i nderuar deputet! Tani është radha e Grupit Parlamentar të PDK-së. Deputeti Përparim Gruda.

PËRPARIM GRUDA: Faleminderit, kryetare!

Përpara se të nis të diskutoj për buxhetin, kisha dashur një vërejtje teknike, nëse ka mundësi, zonja kryetare, mbledhjet të fillojnë me kohë. Kemi filluar sot dyzet minuta me vonesë. Çdo seancë në fakt shkon deri një orë vonesë. Po më duket e pakuptimtë, se janë njerëzit duke na parë. Isha duke menduar sot, imagjinoje mësuesi të shkojë dyzet minuta me vonesë, e humb orën e parë, ose polici. Do të ishte mirë të vendosej si standard.

KRYETARJA: Nëse mundem, deputet, vetëm ta sqaroj!

Unë pajtohem plotësisht që në qoftë se seanca thirret në ora 10:00, duhet të fillojë në ora 10:00. Por, para se të vij këtu, unë e shoh sallën nga televizori. Prandaj, kur unë po shoh që salla është e zbrazur, nuk po ka kuptim të vij. Unë vij edhe e para me kushtin që pastaj ju të vini pas meje, kështu që e bëjmë kështu në seancën e nesërme që fillon në orën 10:30. Faleminderit!

PËRPARIM GRUDA: Unë nuk thashë se ka qenë veç faj juaj, është edhe i shefes së grupit më të madh parlamentar dhe të gjithë shefave të grupeve që të kujdesen që seancat të fillojnë me kohë.

Tani, unë po i kthehem temës së buxhetit. E vërteta është që unë nuk kam pasur kohë ta shikoj në detaje. Unë e kam të pamundur për tri ditë t'i përpunoj shtatëqind faqe. Aq më tepër që s'jam jurist edhe më duhet të konsultoj njerëz për fusha të caktuar kur dua të ngre një çështje.

Por, ajo çka mund të them këtu prej përvojës sime për herë të parë në këtë Kuvend me buxhet, është që procesi po më duket plotësisht joserioz. Edhe prej diskutimit të ministrit të Financave e vërejtja këtë joseriozitet.

Ministri i Financave e ka sjellë zgjatjen buxhetore para tri-katër ditësh, me idenë që ne do të kemi një kohë ta bëjmë një buxhet qysh duhet. Ndërkaq, këtu erdhi dhe tha që ky është një buxhet shpejt e shpejt dhe do ta rishikojmë. Pra, në start, ministri i Financave e pranon që buxheti s'është punuar mirë dhe duhet të rishikohet pas disa muajsh.

Unë nuk e kuptoj. S'ka urgjencë për këtë dhe ta dimë edhe një diçka, Ligji për buxhetin nuk është ligj që i nënshtrohet vetëm debatit në këtë Kuvend, i nënshtrohet debatit në krejt shoqëri. Është ligji më i rëndësishëm që miratojmë dhe duhet t'u jepet rasti edhe universiteteve, edhe instituteve dhe njerëzve të shoqërisë civile që të japin komentet e veta ta shohim se si do ta orientojmë. Sepse, ky nuk është një buxhet mbijetese mendoj.

Më 2027 ne s'kemi buxhet veç për të ndarë rroga dhe pensione; të mendojmë pak strategjikisht se ku e çojmë buxhetin. Ndërkohë që hulumtova këto ditë, e kuptova që vendet evropiane sot angazhojnë institute kërkimore t'u tregojnë qysh ta bëjnë planin e buxhetit. Nuk është thjesht të vendosen do tabela dhe do numra. Sidomos vendet skandinaveve përdorin institute, i financojnë ato që t'u japin ide qysh ta përdorin buxhetin. Do të duhej të hapej një debat më i madh.

E dyta, ministri tha nuk janë reflektuar disa ministri në buxhet, po s'ka lidhje se e ka lënë një nen aty që thotë: "... pastaj ministri e ndan". Kjo nuk është në rregull! Kjo është kundër praktikës së hartimit të ligjeve dhe të hartimit të këtij buxheti. Se për ashtu, ministër, unë mund me të të them hiqi krejt ministrinë, edhe vendose veç një fjalë, thuaj: buxheti i Kosovës është 4 miliardë euro dhe e ndan ministri i Financave.

Tash po flas si jurist, në kuptim të teknikës legjislative, kjo s'ka kuptim. Nëse ti ia cakton buxhetin Ministrisë së Sportit, që e keni themeluar të re, caktoja edhe Arsimit, hiqi krejt tabelat. S'bën, kjo s'ka kuptim! Mendoj që ky ligj nuk i plotëson kushtet teknike të standardeve të hartimit të legjislacionit për të kaluar si i tillë.

E dyta, kryeministri tha: rendi i gjërave është që një herë ka qenë ekspozēja, pastaj është buxheti dhe programi i Qeverisë. Jo, kryeministër, nuk është ashtu! Ekspozēja, programi, buxheti. Po, po ku është programi? A, në mbledhjen e radhës, kur të kryhet buxheti. Po, s'qenka radha e gjërave në rregull, pra. Nëse unë ju dëgjova mirë, ju e thatë ndryshe radhën. Por, prapë dilni te ajo që po them unë. Nëse programi është mbas buxhetit, cili është kuptimi i diskutimit për programin? Se ne duam t'ju matim në program sa e keni të realizueshëm, qysh e pasqyroni atë në buxhet. Mendoj që do të ishte një debat normal të sillej një herë programi, të flasim ne për Programin e Qeverisë, të diskutojmë dhe të na bind që ai program pastaj mund të përkthehet në buxhet.

Tjetra, po kthehem tash te çështjet konkrete të buxhetit. E para, ministër, këtu e keni një dispozitë që është jokushtetuese. Këtë duhet ta ndërroni. Neni 31, te shtesa prej 0,5% për shërbyesit civilë. Gjykata Kushtetuese, në aktgjykimin që e citoni këtu, ka thënë më 2024, duhet paguar secilit 0,5% për çdo vit përvojë pune. Edhe ka dhënë obligim të ndërrohet Ligji i pagave. Meqenëse, Ligjin e pagave s'e keni ndërruar, ju e keni futur këtu një dispozitë që thoni hyn në fuqi nga 1 janari. Po, ju duhet t'i paguani dhe dy vjet të tjera, 25 dhe 24.

Prandaj, i shkëlpi të drejtat e njeriut, të shërbyesve civilë dhe e shkëlpi aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. E keni, më duket 138 është paragrafi i aktgjykimit që thotë që duhet të paguhet nga momenti kur gjykata ka vendosur. Dhe, përveç se duhet të reflektohet këtu, ministria që e sponsorizon Ligjin për pagat duhet ta ndryshojë atë pjesë dhe të vendosë në përputhje me aktgjykimin. Është dashur që dy vjet, në fakt. S'ka ndodhur. Mirë është të ndodhë tash! Kështu që, kjo dispozitë këtu nuk e ka vendin, nuk bën nga 1 janari. Duhet të jetë nga dita e hyrjes në fuqi të aktgjykimit. Kështu ka thënë aktgjykimi.

Tash, unë nuk e di sa i bie ajo me kosto, po sado që i bie, nëse nuk ua paguani, të jeni të sigurt, unë i kam parë që janë organizuar këta të administratës së shërbyesve civilë, do të dërgojnë raste në gjykatat e rregullta, edhe do ta marrin edhe interesin. Kështu që, mos e ngarkoni më shumë buxhetin, paguajuni aq sa u takojnë me ligj, se përndryshe ata do t'i marrin ato.

E treta, se po i shoh minutat, e treta që po dua ta ngre, është çështja e arsimit. Meqenëse punoj edhe vetë në arsim. Unë e pashë këtu që shtatë universitetet publike kanë 32 milionë euro buxhet dhe aty hyn edhe kërkimi shkencor. Është pak!

Unë e kuptoj që tash ne po bëjmë vërejtje secili në fushën tonë edhe në fund ministri mund të na thotë ku t'i marrim paratë. Unë po e tregoj një trend. Ne, në raport me buxhetin e përgjithshëm, buxheti për kërkimin shkencor në Kosovë nuk mbërrin as 1%. Vendet evropiane e kanë 2%. Objektiva strategjike e vendeve evropiane është të shkohet te 3% i kërkimit shkencor, në mënyrë që kapitali human të zhvillohet, mënyra e punës të zhvillohet edhe shkenca të vihet në funksion të ekonomisë. Ajo që e mësova e që qe shokuese për mua, është që Kosova paska para, si jurist e mësova unë tash, këta ekonomistët ndoshta e kanë ditur më herët, unë e mësova që Kosova ka çdo vit para më shumë se që mund të shpenzojë. Edhe, kur pyeta pse ndodh kjo, sepse kapaciteti zbatues i shtetit është i dobët. Pra, shteti nuk mund të përdorë aq para, sa ka.

E tash, qytetarët që më dëgjojnë mua, mund ta marrin me mend, që kur u mungon një rrugë a një shkollë a kur kanë paga të vogla, mendojnë që s'kemi mundësi. Në fakt, e vërteta është që s'kemi njerëz t'i zbatojmë këto. Kështu që, investimi a rritja e investimit në arsim do të ishte investimi më i duhur që të mund ne edhe këto fondet që i kemi miratuar ne, kryeministri e përmendi 1 miliard euro marrëveshje ndërkombëtare, unë s'di kur do të vijë dhe kur do të zbatohen me këtë performansë që e kemi të institucioneve. Kështu që, do të duhej të kujdesemi që të investohet më shumë në arsim.

E fundit, dhe që po dua ta paraqes si kërkesë të grupit tonë parlamentar, Partisë Demokratike të Kosovës: kërkoj që të shqyrtohet mundësia që fondet për të akuzuarit në Hagë të rriten. Ne e kemi diskutuar me vite këtu qysh kanë pasur probleme të paguajnë avokatë. Mendoj që ka qenë e turpshme për të gjithë neve, se nëse ky vend nuk ka buxhet të ndajë për ta mbrojtur luftën e vet, nuk e di për çfarë i kemi tjetër. Mua s'më interesojnë këto tabelat e tjera hiç, nëse në Kosovë është dikush që refuzon ta mbrojë atë për çka... se ne mblidhemi sot dhe diskutojmë për buxhet shumë mirë, se jemi vend i lirë, jemi për shkak të sakrificës së dikujt. Kërkoj me dashamirësi që këto fonde të rriten.

E dyta, ministrja e Drejtësisë nuk qenka, po besoj e dëgjon, duhet ta ndryshojë Udhëzimin Administrativ që tavani i pagesave të ngrihet më lart dhe ne të mund t'u ofrojmë atyre njerëzve mbrojtjen e nevojshme, veçanërisht tash në fund të procesit në Hagë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputet! Tani është radha e deputetes Adelina Thaçi-Meta.

ADELINA THAÇI-META: E nderuar kryetare e Kuvendit, znj Haxhiu!

I nderuar kryeministër Kurti,

Të nderuar ju pak ministra që jeni këtu në sallë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Si artiste, soliste me përvojë shumëvjeçare në skenën artistike dhe tani nga perspektiva e deputetes së Kuvendit të Kosovës, më vjen keq qysh në paraqitjen time të parë që më duhet t'i them këto fjalë rreth Qeverisë së re, e cila përmes këtij buxheti, në vend se të sjellë optimizëm dhe perspektivë, po e shpalos një mentalitet të improvizimit dhe joseriozitetit dhe në këtë formë, nuk besoj që meriton të shqyrtohet fare.

Nuk ka nevojë të jem eksperte e financave dhe e buxhetit, meqë nuk vij nga ajo fushë, për të gjykuar këtë situatë absurde, si joserioze dhe si improvizim.

Ne, javën e kaluar në Kuvend kemi miratuar zgjatjen e buxhetit për muajin mars. Pra, Qeveria kishte mundësi që deri në fund të muajit mars ta sillte për shqyrtim dhe debat në parlament buxhetin e rishikuar dhe adaptuar për nëntëmbëdhjetë ministrinë e prezantuar.

Më vjen shumë keq që me këtë buxhet nuk kam lajme të mira për kolegët e mi të fushës së kulturës dhe artit, të Akademisë së Arteve, e për kolegët e Operës së Kosovës. Ata jo vetëm që nuk kanë një afat konkret se kur do të mund të performojmë në Teatrin e Operës dhe Baletit, projekt madhor i promovuar me pompozitet nga Qeveria e kaluar, por s'kanë sot as edhe një seli të përhershme pune, as edhe një zyrë modeste, qoftë edhe në ndërtesën e ministrisë.

Që katër vjet prej themelimit të Operës së Kosovës, ende nuk janë hapur vendet e rregullta të punës për anëtarët e trupës së Operës, pra korit, orkestrës dhe solistëve. Nuk gjej lajme të mira as për kolegët e Filarmonisë së Kosovës, pjesë që dikur isha dhe unë; të Qendrës Kinematografike, rreth infrastrukturës adekuate; apo edhe për kolegët e Teatrit Kombëtar, i cili vazhdon të jetë i mbyllur dhe prej katër vjetësh ende është në renovim. Më falni!

S'kam lajme të mira përgjithësisht për kulturën, ngase zoti kryeministër, po unë këtë kritikë nuk e kam vetëm ndaj jush, por edhe për krejt partinë politike. Gjithmonë kulturën e përdorni për fushata, dhe në mes të atyre premtimeve, kultura gjithmonë përmendet rrëshqitazi. Pra, nuk përmenden nevojat e tyre konkrete dhe as ndonjë premtim sado modest.

Ndërkohë që, dua ta pranoj dhe dua ta them se vitet e fundit kemi parë një rritje graduale, por që shpërndarja e tij nuk ka qenë e drejtë dhe e balancuar. Flasim për buxhetin. Si deputete dhe nënkryetare i Komisionit për Kulturë, unë do t'i takoj të gjitha institucionet që i përmenda dhe do të angazhohem që kërkesat e tyre të shpalosen publikisht dhe të reflektohen sa më drejt në këtë Parlament, në buxhetin e ardhshëm të rishikuar, natyrisht.

Për fund, këtë buxhet nuk mund ta votoj unë, por s'do të duhej ta votojë as ky Parlament, ngase s'është përfshirë as buxheti i Komunës së Prishtinës, i kryeqytetit tonë, ku direkt apo indirekt

frymon e gjithë Kosova: Qeveria dhe institucionet qendrore, ekonomia dhe biznesi, universitetet e kolegjet, QKUK dhe spitalet, ambasadat dhe përfaqësitë e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, kultura edhe arti. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Tani është radha e Grupit Parlamentar të PDK-së, znj. Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Përfaqësues të mediave,

Shumë të dashur kolegë deputetë,

Në fakt, po e përsëris atë që e tha edhe z. Gruda, për dy ditë ka qenë e pamundur që ta lexojmë një buxhet kaq voluminoz, edhe unë këtu ndaj mendimin e njëjtë që s'e kam kuptuar urgjencën e përpjekjes që një projekt kaq i rëndësishëm që është projekt- buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2026 të vijë me kaq shpejtësi. Pra, do t'i prek vetëm disa prej çështjeve, të cilat si deputete kam rritur t'i trajtoj brenda këtyre pak ditëve.

Pra, e para, që nuk është e re, që u tha edhe prej kolegëve të mi, është e vërtetë që buxheti bie tërësisht ndesh me ekspozenë e Albin Kurtit. Pra, nuk e reflekton për së afërmi përbërjen e Qeverisë dhe kjo shihet edhe për faktin që disa ministri nuk kanë fare buxhet dhe kjo u tha edhe më herët nga kolegët e mi deputetë.

Një gjë tjetër që të bie në sy është numri i madh i ministrave, e këtu, të dashur kolegë deputetë, secili e kujtojmë deklaratën dhe premtimin e Kurtit për një kabinet qeveritar me numra të vogël të ministrave, të cilin dikur ai e lidhte me rritje të efikasitetit. Pra, Albin Kurti na thoshte që duhet të ketë më pak ministra, për të arritur efikasitetin e një qeverie dhe për ta ndaluar korrupsionin.

Pra, në vend që të kemi më shumë shërbime sociale për qytetarët, kemi më shumë ministri, 21 gjithsej bashkë me kryeministrin.

Diçka tjetër që bie në sy në këtë projekt-buxhet janë shpenzimet e rritura për subvencione dhe transfere.

Kolegë deputetë,

Pra, po shihet qartazi; interesimi vazhdon të jetë kryesisht te sektorët ku paraja shpërndahet për të pasur efekt të menjëhershëm elektoral. Pra, i merr 100 euro dhe kjo ndikon menjëherë, jo me një investim afatgjatë, jo me një strategji, frytet e së cilës do t'i shihnim pas disa vjetësh. Le të na thotë sot dikush këtu nga kabineti qeveritar, cili ka qenë efekti real i ndarjes së parave, të cilat

janë dhënë me synim për ta rritur mirëqenien e qytetarëve të Kosovës dhe për të krijuar një shoqëri të barabartë, sepse kështu na është thënë.

Pra, nëse i shohim matjet për çdo ditë, ato flasin krejt diçka tjetër. Matjet e opinionit publik, matjet e gjendjes dhe mënyrës se si jetojnë sot familjet kosovare flasin se numri i familjeve që ka nevojë që Qeveria t'ua paguajë rrymën po rritet.

Të nderuar kolegë deputetë,

E kjo çfarë na flet? Pra, na flet që numri i familjeve që jetojnë në kufi të varfërisë është duke u rritur. Po rritet varfëria, po rriten çmimet, jeta e qytetarëve të Kosovës po bëhet përherë e më e vështirë. Ndërkohë, qeveritarët po u kërkojnë qytetarëve të sakrifikohen. Pra, po u thonë sakrifikohuni. Pra, sakrifikohuni e mos u befasoni kur u merret gjysma e rrogës për ta paguar rrymën.

Kolegë deputetë,

Po, është guxim i madh t'i thuash sot qytetarit të Kosovës që po ia merr bukën e gojës me shpenzime të panumërta, me çmim të rrymës, me çmim të rritur të ujit, me çmime të kontributeve të tjera, e në fund t'i thuash: sakrifiko, sepse e ke borxh dhe duro!

Pra, ta marrin bukën e gojës, por lutem shumë që të mos e marrin edhe ëndrrën e qytetarit të Kosovës për të jetuar në Kosovë, sepse duhet të jemi të vëmendshëm. Janë dyzet mijë qytetarë të Kosovës, të cilët vetëm gjatë një viti u detyruan ta lëshojnë atdheun e tyre për jetë më të mirë. Të njëjtit, të jeni të bindur, që do të vazhdojnë t'i marrin familjarët e tyre, gratë e fëmijët, dhe pastaj ne do detyrohemi që të kërkojmë informata nga ministri i Arsimit se cili është numri i shkollave të mbyllura pa nxënës, sa arsimtarë kanë mbetur pa orë e kushtimisht, sa arsimtarët kanë mbetur pa punë.

Pra, çka do të bëjë Qeveria për migrimin e popullsisë, sepse unë këtë nuk e pashë në ndarjet buxhetore. Kosova po zbrazet e po varfërohet, ndërkohë që halli i vetëm i Qeverisë është ta rrisë numrin e ministrave për ta shtuar efikasitetin, të cilin dikur e kundërshtonte Albin Kurti.

Diçka tjetër që shihet qartë është ndarja e buxhetit për komuna dhe këtu komunat përballen drejtpërdrejt me kërkesat e qytetarëve. Ato kanë mbetur pa përkrahje dhe kanë mbetur edhe pa investime. Në ndarjet buxhetore shohim që komunat, të cilat udhëheqin nga Vetëvendosja përfitojnë 40,3% të investimeve totale dhe 34% investime të reja. Edhe pse e përfaqësojnë vetëm 23% të popullsisë, e 18,3% të sipërfaqes. Këto janë të dhëna, të cilat unë i kam marrë nga instituti GAP, që ka bërë një analizë të buxhetit dhe flet për një ndarje joproporcionale të buxhetit për t'i diskriminuar komunat të cilat nuk janë komuna të Vetëvendosjes dhe për t'i dënuar qytetarët, të cilët kanë vendosur të votojnë parti të tjera politike.

Sa i përket obligimit kushtetues, ose mirë të them shkeljeve kushtetuese me koeficientin, nuk do të zgjatëm shumë, sepse këtë e tha zoti Gruda, dhe mendoj që këtë shqetësim duhet ta përcjellim, në mënyrë që të mos i dëmtojmë 90 mijë punëtorët e administratës.

Kemi edhe një reagim të sindikatës, përfaqësuesve të sindikatës, më mirë të them sindikalistëve të Administratës Publike, janë qytetarë të këtij vendi, të cilët mezi ia dalin me këtë situatë të rënduar.

Prandaj, duhet të shihet mundësia që të mos i diskriminojmë dhe në harmoni me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese t'i trajtojmë, ta trajtojmë edhe këtë kërkesë të tyre.

Përndryshe, unë besoj që do të kemi mjaftueshëm kohë që ditëve të tjera të flasim edhe për programin e Qeverisë, edhe për sfidat të cilat i ka sot Kosova. Por, meqë është fjalimi im i parë, them që një Qeveri që ka marrë 51% të mbështetjes qytetare nuk do duhej të na skuqte sot me një projektbuxhet të tillë, që në fakt nuk ka për synim t'i ndihmojë qytetarët e Kosovës, por ka për synim t'i varfërojë edhe më tej, sepse këtë e shohim çdo ditë me mënyrën se si Qeveria i ka trajtuar edhe në të kaluarën qytetarët e këtij vendi. Këto janë vetëm disa prej pikave të cilat besoj që edhe kolegët e tjerë do t'i trajtojnë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën tani e ka shefja e Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Jehona Lushaku-Sadriu.

JEHONA LUSHAKU-SADRIU: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Krejt në fillim të seancës kur ju e morët fjalën, na treguat rendin e gjërave dhe thënë të drejtën, në rendin e gjërave do të duhej që ta kishim Programin qeverisës menjëherë pas aprovimit të Qeverisë, e pastaj të kishim buxhetin e rishikuar këtu. Përndryshe, del krejt e pakuptimtë që ne sot ta shohim duke u diskutuar një draft-buxhet, i cili nuk është i përditësuar dhe nuk përkon me realitetin, as me nevojat e qytetarëve, as nuk paraqet një hartë zhvillimore të vendit tonë, e as nuk i reflekton prioritetet e juaja si Qeveri, madje nuk e reflekton as përbërjen tuaj qeveritare. Por, kjo për më shumë edhe i anashkalon vendimet Gjykatës Kushtetuese.

Nuk reflekton nevojat e qytetarëve dhe si fund nuk reflekton as paraqitjen reale të buxheteve të komunave dhe dua të rri te kjo e fundit dhe të nis me kryeqytetin.

Në këtë në këtë buxhet nuk është i përfshirë buxheti i Komunës së Prishtinës, i kryeqytetit, i cili në fakt është paraqitur vetëm me tabelat e vitit 2024. Kjo me dy vite vonesë. Jo që na reflekton, ose na e kujton bojkotin e bllokadën dhe vështirësitë që ka pasur Komuna e Prishtinës përgjatë

dy viteve të fundit, por kjo tregon edhe për dashakeqësi ndaj kryeqytetit dhe mosrespekt ndaj qytetarëve të kryeqytetit të Kosovës.

Kryeqyteti e ka aprovuar buxhetin dhe s'ka asnjë arsytim që ky buxhet të mos jetë i përfshirë. Mospërfshirja e tij përbën shkelje të autonomisë lokale, të rendit kushtetues dhe shkelje të të drejtave të qytetarëve të Prishtinës, por kjo është edhe një e drejtë kushtetuese e vetë kryeqytetit. Prandaj, buxheti i kryeqytetit i vitit 2026 duhet të përfshihet menjëherë në këtë ligj.

Çështja e dytë që dua ta adresoj ka të bëjë me nenin 31 të këtij draft-ligji që e keni sjellë dhe që ka të bëjë me njohjen e përvojës së punës. Gjykata Kushtetuese e ka nxjerrë një aktvendim KO79/23, i cili e obligon Kuvendin dhe Qeverinë që ta ndryshojnë Ligjin për pagat në sektorin publik për ta llogaritur përvojën e punës me efekt nga shkurti i vitit 2024.

Qeveria nuk e ka bërë këtë dhe afatet janë kaluar dhe sot po tentohet që kjo të adresohet me një projektligj, i cili nuk është ai që ka rekomanduar Gjykata Kushtetuese. Sot kemi një adresim të tillë që thuhet që do të llogaritet përvoja e punës retroaktivisht nga janari i 2026-tës. Domethënë, jo nga viti 2024, por nga 2026. Dy vjet dëme financiare për mbi 90 mijë zyrtarë publikë. Ky nuk është respektim i aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por kjo mund të rezultojë në padi kundër shtetit tonë dhe miliona euro kosto shtesë për buxhetin tonë publik.

Çështja e tretë që dua të adresoj ka të bëjë me arsimin. Ju e deklaruat, por e keni deklaruar edhe gjatë viteve të kaluara që arsimi parafillor është njëri nga prioritetet e juaja. Nuk po dua tash të kthehem te ato 120 çerdhet e pandërtuara, që asnjëherë nuk u bënë, por dua t'ju kujtoj që vetëm 15% e fëmijëve të moshës në fillore janë të përfshirë në arsimin e parafillor, në arsimin e hershëm.

Domethënë, 85% e fëmijëve nën moshën 5-vjeçare nuk janë të përfshirë në arsimin parafillor. Kjo tregon që përkushtimi juaj në pesë vjetët e kaluara nuk ka arritur që ta zbutë përfshirjen e fëmijëve dhe nuk ka arritur që ta ndryshojë numrin e komunave që nuk kanë ende çerdhe publike.

Jua kujtoj, po ashtu, që gjatë viteve të kaluara ka pasur shumë adresime nga komunat, iniciativa nga komunat për çerdhe të reja, por ato nuk shihen sot të përfshira në projektin e buxhetit që keni sjellë. Po jua kujtoj edhe një herë që Ligjin për fëmijërinë e hershme e keni aprovuar, por i mungojnë aktet nënligjore, aktet e zbatimit dhe nuk ka asnjë kuptim që një ligj të jetë në fuqi pa akte zbatuese.

Ju i përmendët në ekspozenë tuaj edhe bonuset për fëmijë. Nuk e di në cilin buxhet e keni planifikuar. Ku doni t'i merrni ato të holla, përderisa ajo absolutisht nuk është pjesë e këtij

buxheti. Asnjë program specifik që e adreson këtë dhe që tregon se si do t'i ndihmoni familjet me këtë bonus për fëmijët.

Te arsimit fillor gjatë fushatës ju kemi dëgjuar tek i keni premtuar edhe shujtat e ngrohta. E keni premtuar me shumë kryetarë komunash mësimin tërëditor, por nuk e pashë të përfshirë në këtë projektbuxhet. Kisha pasur dëshirë ta di prej jush konkretisht, sepse ka komuna si Komuna e Prishtinës, që e kanë bërë edhe me mjete vetjake, por mësimi tërëditor si njëra prej reformave më substanciale në arsim meriton të ketë qasje dhe përkrahje nacionale. Meriton të ketë vendosmëri nga Qeveria për të ecur përpara, se vetëm mësimi tërëditor u jep mundësi familjeve për organizim të mirëfilltë, i jep mundësi arsimit për ngritje të cilësisë dhe u jep mundësi grave për punësim.

Ju i përmendët pesë gjimnaze të specializuara. Nuk pashë asnjë linjë buxhetore që e jep planifikimin buxhetor për pesë gjimnazet. Ato kushtojnë diku 10 milionë dhe gjithmonë duhet pasur parasysh ku i merrni ato të holla dhe kjo është një pyetje e imja. E të mos flasim për digjitalizimin në arsim, se është diçka që është inovative dhe kërkon adresim.

Po ju, digjitalizimin në arsim e përmendni veç katër herë në këtë ligj. Edhe atë në lidhje me Komunën e Kaçanikut, Gjakovës, Skenderajt e Drenasit. Ndoshta për renovim diçka të kablllove të internetit, po jo për investim në tabela digjitale për krejt Kosovën.

Gjysma e klasave në shkollat tona jo që s'kanë tabela digjitale, por s'kanë as investime bazike për zhvillim të mësimi normal aty, e lëre më për cilësi.

Prandaj, është e rëndësishme që të dimë se përderisa fëmijët tanë rriten me teknologji në dorë, sot Qeveria po ua prezanton një buxhet që nuk jep perspektivë për ta, që nuk është e përditësuar për nevojat e tyre dhe që nuk e bën klasën dhe shkollën interesante për ta dhe jo për mungesë mjeteshe, por për mungesë vullneti politik.

Arsimi profesional thatë që është prioritet, sepse duhet të lidhet me nevojat e tregut. I keni ndarë vetëm rreth 300 mijë euro në këtë linjë buxhetore. Nuk e di se si arrini që ta ndërlidhni industrinë dhe kurrikulat e shkollave profesionale për të cilat nuk i keni as sot pas pesë vjet qeverisje. Asnjë shkollë profesionale nuk ka kurrikula të miratuara dhe të zbatuara, as tekste bazike. Ndërsa po flasim, emocione të veçanta sot kemi për mijëra familje, mbi 5 mijë familje që rritin fëmijë me nevoja të veçanta.

Shkollat tona nuk arrijnë të krijojnë kushte për ta, dhe në këtë rast edhe ky projektbuxhet i lë familjet të vetme që të merren me ata fëmijë. Vetëm 700 mijë euro janë investime kapitale për fëmijët me nevoja të veçanta, që i bie që asnjë qendër burimore nuk mund të ndërtohet me to.

Asnjë program nacional që u del ndihmë prindërve që kanë fëmijë me nevoja të veçanta, e numri i tyre është gjithmonë në rritje.

Pyetini komunat dhe e shihni se sa është nevoja për ta.

E për t'i lënë vetë nuk e meritojnë dhe e besoj që nëse jeni parti me program social, e nëse keni ndjenja, besa edhe si prindër, ju bëj thirrje që urgjentisht ta rritni buxhetin për fëmijët me nevoja të veçanta.

Tek arsimi i lartë, veç një shembull po e marr Universitetin e Prishtinës. Vetëm 0,91% e buxhetit të Kosovës i takon Universitetit të Prishtinës, universitetit më të vjetër, i cili do të duhej që në mënyrë progresive t'i kishte të hyrat shumë më të mëdha, të kishte dhe të hyra vetjake, edhe zhvillim të shkencës dhe përkrahje më të madhe. Nuk e besoj që ne si shtet do t'ia dalim mirë nëse arsimin e lartë, e posaçërisht universitetet publike që duhet të udhëheqin edhe hulumtimet shkencore, edhe studimet mbi qeverisjet tona, gabimet tona, të na japin rekomandime, t'i lëmë me buxhet kaq të vogël.

E nuk po flas për inovacionin, sepse fondi i hulumtimeve shkencore, Këshilli për Inovacion e shumë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Edhe një minutë, regjia, deputetes!

JEHONA LUSHAKU-SARIU: Për shumëçka që keni premtuar për inovacion, e ka përkrahjen minimale dhe që pesë vjet, këto janë premtime që pesë vjet, ato aspak nuk ekzistojnë. Si parti nuk e besoj që do ta përkrahim për aq kohë sa buxheti i Prishtinës nuk përfshihet dhe për aq kohë sa ky ligj nuk përditësohet. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Tani është radha e deputetit Ferat Shala.

FERAT SHALA: E nderuar kryetare e kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Media,

Po i ngreh disa shqetësime krejtësisht teknike, por që në esencë janë shumë përmbajtjesore dhe substanciale për politikën e Qeverisë të kryeministrit Kurti, politika të cilat i ka pasur sfidë në mandatin që shkoi në kuptimin juridik, profesional, ekonomik, menaxherial, por dhe korruptiv.

Dhe, besoj që me këtë logjikë dhe me këtë program që e shoh dhe tabelë të planifikimit, me këto sfida do të ballafaqohet kjo Qeveri në vazhdimësi, nëse nuk ndryshon qasje dhe strategji.

I nderuar kryeministër,

Po nisem nga sektori më i veçantë dhe bazament i zhvillimit, energjia. Në tabelë po e shoh që Zyra e Rregullatorit për Energji ka -16,29% mjete të planifikuara në këtë vit. Më thuaj, kryeministër, si do ta menaxhosh sektorin energjetik kur Agjencia Rregullative e ngulfat, edhe ashtu ke filluar më herët, dhe tash e sjellë para situatës që as të hyrat që i ka pasur të mos i ketë.

Kjo është në varësi direkte nga institucionet ekzekutive. Kjo është për ta humbur pavarësinë rregullatori dhe të detyrohet të shkojë te kompanitë që tash në mars do të na e ngrenë çmimin. T'i vlerësojë rregullatori ofertat dhe propozimet që i bëjnë kompanisë shërbyese. Pra, cila është autonomia e rregullatorit që tash do ta vlerësojë çmimin e energjisë kur ju ia keni ulur çmimin?

Edhe ashtu ka pak staf profesional, edhe ashtu e keni ngulfatur tash e katër vjet, pesë vjet, edhe ashtu e keni obliguar të kryejë shërbime jashtëligjshëm në vlerësimin e të hyrave të lejuara maksimale dhe sot prapë po i bëni presion edhe financiar që ai në mars të na e ngrehë çmimin prapë, të jetë i dëgjueshëm, apo çka është kjo? Kjo është ndërhyrje flagrante në pavarësinë e rregullatorit, i cili po i bart mbi supe politikat tuaja, kryeministër dhe të ministres që është këtu.

Prandaj, ju rekomandoj të ndërroni qasje, sepse Kushtetuta e ka paraparë të ketë rregullator, edhe vetë shteti është rregullator. Nëse ju e mbytni rregullatorin, e keni mbytur sektorin dhe ekonominë.

Shkojmë dhe me një rregullator tjetër, kryeministër. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, minus 1,39% rënie të të hyrave. Edhe Fondit të Sigurimeve ua ke zbritur, e në anën tjetër proklamon diçka tjetër krejt.

Ky shqetësim është edhe tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Shikojeni, -10,88% ia ke zvogëluar të hyrat Agjencisë Antikorrupsion. Sinqerisht, e ke pasur sfida dhe e ke sfida ende dhe do të vazhdosh ta kesh korrupsionin. Me këtë kulturë, me këtë sjellje, me këtë politikë, kur orvatesh edhe agjencinë që ju e menaxhoni ta diktoni dhe ta ngushtoni. Po, ne e kemi sfida si shoqëri antikorrupsionin, korrupsionin, luftën. Plot gojën e kemi kundër korrupsionit.

Nuk i ke përmbushur as kriteret minimale të raporteve ndërkombëtare për luftë antikorrupsion. Në vend që t'i fuqizosh rregullatorët, e ata të ndihen të pavarur e të fuqishëm juridikisht e ta parandalojnë korrupsionin, ju i goditni me buxhet.

Apo, ta marrim një rregullator tepër të ndjeshëm, jetik, Autoritetin e Shërbimeve të Ujit, ARRU-në.

Të nderuar deputetë, edhe ju të mazhorancës,

Jeni dëshmitarë që katër vjet rresht, qytetarët e Prishtinës e gjysma e Kosovës nuk kanë ujë normal. Nuk ka muaj që s'kemi pasur lajmërimi publike, mos e pini ujin, ju sjellim me cisterna, e bëjmë atë. Sot, ia keni ulur buxhetin Rregullatorit të Ujit për 18,68%.

Kryeministër, nëse dhe shërbimet e ujit i godet kështu, e tarifa është rritur për shkak të energjisë, çfarë shërbimi ke në dorë tjetër ti, që qytetarëve mund t'ua ndërpresësh. ARRU-në, Rregullatorin e ujit të pijes në tërë Kosovën.

Kryeministër, po kaloj nga mostra tjetër, edhe në kulturë pak, se të tillë shembuj ka mjaft. Singerisht nuk e kuptoj, te investimet kapitale qysh ka mundësi që Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, asnjë cent investime kapitale. Po edhe kulturën nëse nuk e respekton, e nuk e ruan, e nuk e nderon, çka na ka mbetur tjetër? Si ka mundësi që as në kulturë 1 cent s'e ke ndarë. Ama, 3,3 milionë i ke ndarë për makina. Në buxhet i ke. 3,3 milionë të blihen makina të reja, në Këshillin për Trashëgimin Kulturore, asnjë cent.

Kryeministër, Autoriteti i Aviacionit Civil, përsëri një agjenci shumë e ndjeshme. Miliona qytetarë lëvizin e hyjnë, e shumica edhe votuesit tuaj, tashmë të dokumentuar, udhëtojnë me aeroplan, ia ke zbritur, jo po, asnjë cent në investime kapitale. Siguri njerëzore, qytetare, publike, siguri jetike për të lëvizur mërgata jonë. Asnjë cent investime kapitale.

Kryeministër, Radiotelevizionin e Kosovës, televizionin publik të shtetit tonë, televizionin që e ke abuzuar dhe eksploatuar edhe juridikisht, edhe mediatikisht, edhe publikisht, por së paku t'ia ndash një buxhet për investime kapitale. Së paku, ua rregullo zyrën atyre të dëgjueshmëve tu në menaxhment, se pjesa tjetër janë të shkëlqyeshëm.

Pra, qysh ka mundësi për televizionin publik asnjë cent për investime kapitale, e në anën tjetër ke vendosur struktura 100% politike të dëgjueshme, dhe ai që nuk të bën pyetje të mirë, e largon nga puna, madje edhe me nënën shtatzënë, a investime kapitale RTK-së, zero. Zyrat i kanë kështu, prej që i mban mend ti dhe unë bashkë. Objektet i kanë të njëjtat. Prona është e legalizuar që para shtatë vjetësh, kur e kam ndarë që të ndërtohet objekti i ri i televizionit, i është përgatitur edhe projekti i shpronësuar.

Ndaje investimin në kapital, t'ua ndërtosh, se është televizion, jo veç yti, është i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Është televizion publik që e mbajmë me taksat tona. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Fjala është për deputetin Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Po e diskutojmë sigurisht dokumentin më të rëndësishëm në Kuvend dhe i kam parasysh argumentet që u thanë në fillim të seancës, megjithëse i gjej të paarsyeshme komplet. I diskutuam disa herë, janë bërë zgjatjet buxhetore dhe nuk ka pasur asnjë urgjencë që ky buxhet të vijë kështu në Kuvend, por të vijë bashkë me programin qeverisës dhe të reflektohen komplet, jo vetëm për 2026, por '27 dhe '28, sepse ky është buxhet 3-vjeçar për krejt prioritetet e Qeverisë.

Po ta lëmë anash atë. Kam një përshtypje që buxheti më shumë po shihet si një plan kontabël sesa si një dokument strategjik i mbledhjes së të hyrave dhe i mënyrës se si i shpenzojmë ato. Dhe, unë dua të flas më shumë në këtë aspekt.

Nëse e analizon në strukturë buxhetin si tërësi, nuk sheh asnjë gjë të re. Dhe, këtë e kemi parë në katër-pesë vjetët e fundit. Pa asnjë politikë të re fiskale, pa asnjë politikë të re industriale, të cilat në tre-katër vjetët e fundit bota është kthyer plotësisht nga politikat industriale. Pse po e them këtë?

Shihni veç çka po ndodh me tregtinë me jashtë, me importet, kanë shkuar në 7 miliardë euro. Nuk duhet asnjë tregues tjetër për ta parë se çka po ndodh me ekonominë vendore. Dhe, nëse e shihni strukturën se çka po importojmë, do të çuditëni. Gjërat më elementare. Që nënkupton, asgjë s'është duke u prodhuar. Dyfish më shumë po importojmë nga jashtë. 800 milionë euro janë importet vetëm nga Kina.

E kuptoj nga Gjermania, ose nga Turqia si vende partnere. Por të rriten importet nga Kina, dhe nëse e shihni çka importojnë nga Kina, prapë janë gjërat më elementare të konsumit të përditshëm, që reflekton mungesën e politikave fiskale dhe, në veçanti, politikave industriale.

Për më tepër, shiheni vetëm strukturën ose natyrën e 10 kompanive më të mëdha në Kosovë, u publikuan dhe para disa ditësh, të këtyre korporatave të mëdha që po kryeministri po i merr si shembull që i ka rritur fitimin. Në rregull që i kanë fitimet, po kush janë ato kompani? Nga 10 kompanitë më të mëdha në Kosovë, 9 prej tyre janë tregtare. Me tregtime, me import të mallrave, ushqimorë para se gjithash, edhe me energji e të tjera, e të tjera. Vetëm njëra nga to, KEK-u prodhon energji edhe ajo është publike, nuk është private, 9 të tjerat janë kompani tregtare. Dhe, kjo tregon shumë se çka po ndodh me ekonominë vendore.

Po cili është kontributi i këtij buxheti në rritjen ekonomike? Është pothuajse i papërfillshëm. Ja, po i jap statistikën që i keni edhe në dokumentin e buxhetit, edhe në analizën e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Investimet private dhe konsumi privat kontribuojnë në rritje me 3 pikë edhe 4 pikë të përqindjes respektivisht, por investimet publike dhe konsumi publik kontribuojnë me 05 edhe 04 pikë të përqindjes në rritjen ekonomike. Pra, është i papërfillshëm.

Ne mund të krenohemi, e kemi bërë buxhetin 4 miliardë, por ndikimi i këtij buxheti në ekonomi, zero. Pse është zero? Se s'ke politika industriale. Krejt çka shpenzojmë, krejt shkon jashtë. Një pjesë shumë e vogël e tyre, me vetëm 13% arrijmë ta mbulojmë importin me eksporte.

Mund të krenohemi që e kemi bërë buxhetin 4 miliardë, që i kemi rritur disa pensione të tjera. Por, çfarë ka ndodhur me inflacionin? I ka gërryer të ardhurat, i ka gërryer të ardhurat reale të qytetarëve. Edhe në anën tjetër, nuk është shkuar përpara me disa sigurime bazike shoqërore, ta zëmë sigurimet shëndetësore. Shihni ku i çojnë shpenzimet mesatare familjet në Kosovë, një pjesë të madhe i çojnë për të blerë shërbimet shëndetësore, për barna dhe kujdes tjetër shëndetësor. Dhjetëra miliona euro, të mos thuhet qindra, i shpenzojmë në Shkup, në shëndetësi. Pse ka ndodhur kjo? Sepse, në 4-5 vjetët e fundit asnjëherë nuk arritëm t'i funksionalizojmë sigurimet shëndetësore.

Dhe një element tjetër, edhe unë e përcjell nga afër këtë, subvencionin në bujqësi. Edhe në buxhet figurojnë bukur të larta. A e dini çfarë është duke ndodhur me subvencionet në bujqësi? Vonohen, bujqit marrin kredi në ato dhjetëra institucione mikro-financiare, me normë të interesit 13, 15, 18%. Kur i marrin subvencionet bujqit nga shteti, gjysma e tyre u shkon për t'i paguar kreditë nga këto institucione mikro-financiare. Por, çka është duke ndodhur? 70, 80 a 100 milionë që i ndahen këtij për bujqësi, gjysmën e tyre ua jep institucioneve mikro-financiare. Ato jemi duke i mbajtur në këmbë ende, ato kanë pasur kuptim në vitet e para të pasluftës. Po në 2025, 2026 ende të mbijetojnë institucione mikro-financiare me 18% në normë të interesit, kjo veç në Kosovë ndodh, veç me këtë qeveri ndodh. Dhe kjo është duke ndodhur në realitet. Ti u jep subvencionet bujqve, ata marrin kredi, s'ua jep me kohë dhe krejt u shkojnë atje në këto kredi.

Disa çështje teknike. Po vazhdon ende vit pas viti me fondin zhvillimor për Komunat në Veri. Kjo kur është bërë para 10 vjetëve, 12-13 vjetëve, është bërë për shkak të problemeve që kanë ekzistuar atëherë në Veri dhe është bërë që t'u ndihmohet atyre komunave. Tash e keni Ministrinë për Zhvillim Rajonal, ju duheni që t'i ktheni fondet në mbështetje të komunave jo përmes instrumenteve të tilla, por t'i ktheni në buxhet të rregullt. RTK-së ia keni lënë buxhetin të pandryshuar prej vitit 2021 e kënde, 8.6 milionë euro. E vazhdoni me programin e ringjalljes, nuk po ndalem këtu. Ti nëse thua që ke pasur rritje ekonomike më të madhe në rajon, si ka mundësi që ende e ke në buxhet programin e ringjalljes ekonomike?

Dhe një element tjetër, punësimi në sektorin publik nga viti 2021 në 2026 është rritur për 5 mijë e 400, 4 mijë e 100 prej tyre janë në institucionin qendror, jo nëpër komuna dhe nëse i sheh ku janë këto, nuk janë në arsim e në shëndetësi. Rritja e punësimit në arsim e në shëndetësi është josignifikante, është shumë e vogël. Krejt janë nëpër institucione të ndryshme. Tash edhe rritja e qeverisë ta reflekton këtë çështje. Ndërkohë, që ju keni qenë më të zëshmit për uljen e punësimit dhe stabilizimin e punësimit në sektorin publik. Një element tjetër, struktura e buxhetit u

diskutua disa herë, është përmbys raporti shumë i mirë që ka ekzistuar në të kaluarën mes shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve rrjedhëse në kuadër të buxhetit. Kjo është përmbysur komplet dhe ja po e shohim efektin. Po e jap një element, krenoheni me atë programin “Super puna”, në vend që të ketë tamam politika për promovim të punës, përmes politikave industriale dhe ja argumenti.

Papunësia ka rënë në 12 ose 10%, por punësimi nuk është rritur. Njerëzit kanë emigruar jashtë, nuk janë më në shifra, sepse kanë shkuar jashtë. Pra, nuk i ke tek shifrat e punësimit ata që nuk i ke tek shifrat e papunësisë. Fshatra të tëra janë zbratur në vitet e fundit. Me borxhin publik, ju thoni që po e mbani nën kontroll, por realizimi i projekteve të borxhit është zero, në nivele shumë të ulëta. Të premtën që shkoi e kemi miratuar një kredi për arsim. A e dini për çfarë e keni marrë kredinë? Për ta përgatitur rregullativën për arsimin parashkollor, t’i ndërtoni disa çerdhe dhe t’u jepet kuponë familjeve për t’i çuar fëmijët në çerdhe. Krijon përshtypjen se je me një vend të Afrikës ku i kemi problemet elementare. Për një qeveri që s’mundet vetë të ndërtojë çerdhe dhe t’i financojë ato çerdhe, çfarë qeverie ajo është, çfarë rrugë bën, çfarë zhvillim ka ajo qeveri.

Prandaj, të nderuar kolegë, unë propozoj dhe besoj që është plotësisht e arsyeshme që ky buxhet të tërhiqet, të reflektohet struktura e re e qeverisë, të reflektohen orientimet programore, të silltet së bashku me programin e qeverisë, të përfshihet programi, po mendoj buxheti i Komunës së Prishtinës dhe i komunave të tjera që i kanë miratuar me vonesë buxhetet e tyre dhe të siguroheni që në këtë buxhet i ri që vjen në Kuvend të reflektohet komplet programi i qeverisjes për komplet mandatin, sepse është buxhet 2026-2028. Kështu si është, është i papërmirësueshëm, nuk përmirësohet me amendamentet që mund të bëjnë deputetët gjatë dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Tani e ka radhën deputetja Sala Jashari.

SALA JASHARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues politikë,

Të dashur qytetarë,

Është nder dhe kënaqësi që të jem këtu përpara jush që t’ju përfaqësoj në mënyrën më të mirë të mundshme.

Meqenëse në këtë legjislaturë kam marrë besimin që të jem pjesë e Komisionit për Arsim, ndiej obligim moral dhe institucional të theksoj qartë se, ajo me të cilin po përballemi sot në sistemin e arsimit, në fakt nuk është një gjendje e zakonshme, është një alarm për shtetin e Kosovës.

Ky alarm bëhet edhe më i fortë në momentin kur ju e shihni argumentin nga Pisa. Fëmijët tanë janë tre deri në katër vjet më poshtë se fëmijët e tjerë në aspektin e arsimit. Le të ndalemi një moment te kjo. Kjo nuk është vetëm statistikë, kjo është diferenca në mes të një të riu që konkurren në tregun evropian dhe një të riu që mbetet në periferi të tij. Prandaj, çdo vit që kalon

pa veprim, e thellon këtë hendek. Në këtë kontekst nëse arsimit do të ishte prioritet transformues, këtë do ta shihnim qartë në strukturën e buxhetit të vitit 2026, por sot realiteti është krejt ndryshe. Ju mund ta shihni vetëm nga aspekti dhe përqindja e pagave të sektorit të arsimit që shkon mbi 80%. Ndërsa, shumë pak mbetet për atë që realisht ndryshon jetën e nxënësve, strategji kombëtare për zhvillimin e arsimit dhe në këtë kuadër edhe cilësinë e mësimdhënies, zhvillimin profesional, inovacionin në klasë.

Ne nuk kemi nevojë për përsëritje të buxheteve të kaluara, sepse ato nuk kanë sjellë reforma të arsimit në Kosovë. Ne kemi nevojë ta ristrukturojmë mënyrën se si e organizojmë sistemin e arsimit në Kosovë, sepse ky sistem nuk po përparon mjaftueshëm shpejt për fëmijët tonë dhe mos të harrojmë që fëmijët tanë nuk kanë kohë për ritme të ngadalta. Sot, po përqendrohemi tek nxënësit tanë, por nuk duhet harruar kursesi Universitetin tonë të Prishtinës, shtyllën e zhvillimit tonë të sotëm dhe shkencën, nëse duam të jemi pjesë e rajonit dhe Evropës.

Për më tepër, sfidat strukturore vetëm sa po shtohen. Ndërkohë që numri i nxënësve në Kosovë po bie nga viti në vit, struktura jonë shkollore ka mbetur pothuajse e pandryshuar. Sot, të dashur kolegë, kemi mbi 300 klasë me më pak se pesë nxënës. Edhe këta pesë nxënës nuk janë të moshave të njëjta, ndërsa ekziston krejt tjetra në aspektin e vetë kryeqytetit tonë. Kemi shkolla mbi 35 nxënës për klasë, e cila nuk e siguron cilësinë e arsimit në Kosovë. Kemi shkolla me hapësira të pashfrytëzuara dhe burime njerëzore të shpërndara jo në mënyrë efektive. Në kushte të tilla, një sistem i fragmentuar e ka shumë më të vështirë të garantojë mësimdhënie cilësore për të gjithë, por problemi nuk ndalet këtu.

Një nga dobësitë më serioze mbetet mungesa e matjes së qartë të rezultateve. Sot në dokumentet buxhetore mungojnë qartë indikatorë të fortë kombëtarë të arritjeve, lidhje e drejtpërdrejtë mes financimit dhe rezultateve, sistem i konsoliduar i vlerësimit të mësimdhënësve i lidhur me zhvillim profesional. Pa këtë ne po lundrojmë pa busull, sepse e vërteta është e thjeshtë, ajo që nuk matet me seriozitet, nuk përmirësohet me shpejtësi. Pikërisht për këtë arsye, ky është momenti vendimtar për fëmijët tanë, jo për rregullime të vogla, por për fokus të qartë dhe të guximshëm.

Pyetja është kjo: A jeni të guximshëm ta zgjidhni rrugën e vështirë? Ndryshimi i vërtetë dëshmohej atëherë kur e zhvendosim fokusin e buxhetit drejt cilësisë së të nxënësve, jo vetëm drejt rritjes së sasisë. Ndërtojmë një sistem të besueshëm të matjes së rezultateve, forcojmë vlerësimin dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, e riorganizojmë rrjetin e shkollave sipas realitetit të ri demografik dhe veprojmë me urgjencë për ta mbyllur hendekun me vendet e zhvilluara, sepse arsimit nuk është vetëm çështje sociale, është çështje e zhvillimit ekonomik dhe e sigurisë kombëtare.

Në fund, historia nuk do t'ju gjykojë për buxhetet që keni miratuar, po për mundësitë që ose ua keni krijuar ose ua keni mohuar fëmijëve tanë, për zhvillim në krahasim me fëmijët të tjerë. Dhe sot është dita për të vendosur nëse doni një sistem që administron apo një sistem të arsimit që transformon. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Tani e ka radhën deputeti Ermal Sadiku.

ERMAL SADIKU: Faleminderit, kryetare!

S'kisha dashur të flisja për këto temat e tjera e të koncentrohem në diçka që unë së paku e kuptoj dhe di ta analizoj, e që është digjitalizimi e teknologjia, po s'kam si të analizoj diçka që s'është, si e thanë edhe më herët, pa një kod buxhetor, pa buxhet nuk kam çka të analizoj dhe nuk di si të votoj në këtë aspekt.

Më është dhënë një dokument 700 e diçka faqe, megjithatë po mundohem disa prej gjërave që i kam lexuar aty në ato faqe t'i ndaj me juve dhe të shohim pse është pak e rëndë të votohet ose çka i kam problemet elementare si inxhinier që të votoj një diçka të tillë e ta kuptoj. Për shembull, është kodi 19298, është diçka që quhet “forcimi i qeverisjes digjitale në ofrim të shërbimeve”, për mua një prej gjërave më të rëndësishme në aspektet digjitale të shtetit. Paramendojeni, ky projekt ka filluar në mars të vitit 2024, janë të paraparë 6,8 milionë euro, deri sot për dy vjet janë shpenzuar 9 mijë e 990 euro. Tash pritet brenda vitit të ardhshëm të shpenzohen, sa kanë mbetur aty, 6 milionë e 700 mijë euro.

Në start, për mua kjo nuk është diçka e mirë, nuk është diçka profesionale, nuk e di qysh të votoj diçka të tillë. E kemi te digjitalizimi i arsimit, kodin 19298, më falni derisa të gjej, s'është me rëndësi tash e gjej kodin. Projekti ka filluar në shkurt të vitit 2023, janë 16 milionë euro buxhet. Ministër, më ndihmo nëse jam gabim, deri sot janë shpenzuar zero euro, për tre vjet janë shpenzuar zero euro edhe tash kanë mbetur edhe dy vjet këtu, se këtu po shkruan që përfundon në muajin e fundit 2027 ka mbetur të shpenzohet 16 milionë të mbetura. Nëse kjo është arsyeja e ndërrimit të qeverisë po ngjet, së paku një punë e mirë aty.

Sa i përket inovacionit, hulumtimeve, u mundova të gjej këtu nëpër rreshta diçka, krejt çka gjeta ke diçka gjithashtu pak e dhimbshme. Investimet kapitale në arsim të lartë, furnizimi me pajisje laboratorike, kërkime shkencore “R&D”. Buxheti është 50 mijë euro, 50 mijë euro i kemi buxhet për të bërë “R&D”. E gjeta diçka që është avancimi i prokurimit publik elektronik që zoti Kurti ka qenë kritik, edhe besoj të gjithë ne, se aty ka nevojë për përmirësime, edhe për këtë projekt që për mua është i rëndësishëm për ndërmarrësi, për start upe janë të parapara 100 mijë euro. Mu këto shifra pa të keq nuk po më duken edhe që janë serioze, se s'po shoh vizion qeveritar për të ndërtuar një shtet digjital, për të ndërtuar një shtet të avancuar, për të ndërtuar një shtet modern. Unë jam gëzuar shumë, edhe mendoj që është puna më e mirë e kësaj Qeverie që e keni krijuar

ministrinë dhe e keni caktuar një person të aftë në atë ministri. Po me këto shifra, unë s'po më përputhen këto dy gjëra.

Është një projekt gjithashtu që më pëlqeu, quhet “Pilot projekt për portofolio digjitale”, e-wallet e quajmë ne, me një aplikacion ku do të jenë të gjitha të dhënat, letërnjoftimet, ID të ndryshme, certifikatë të ndryshme për qytetarin. Po paramendo ky projekt fillon shumë vonë edhe quhet “pilot projekt”. Tash a nuk po guxoni ta nisni projektin, a po doni ta testoni, se në vitet 2026/27 nuk mund të testojmë ne me kesi projekte. Na është dashur ta bëjmë këtë projekt, ishte dashur të bëhej para pesë vjetëve, po së paku ishte dashur të ketë diçka konkrete, jo të quhet “pilot projekt”. Nëse është sa për të bërë diçka, s'po e kuptoj. ITP-ja e Prizrenit është një prej projekteve më të rëndësishme në Kosovë që e kam përgëzuar dhe e kam mbrojtur vetë Qeverinë për investimet atje.

Tash e mora, e analizova projektin dhe aty ishin të buxhetuara 50 mijë euro për qendër të ekselencës. Nuk di çka mund të bëhet me ato 50 mijë euro atje. Është e vërtetë që atje është investuar, është një qendër e mirë. Një qendër që është dashur të jetë e ardhmja e të rinjve që sidomos rajonin e Prizrenit, por pse jo edhe Prishtinën, se nuk është aq larg të mbahet ëndrra e një të riu këtu dhe tash ata për qendër të ekselencës i kanë buxhet 50 mijë euro. Edhe në fund, projekti i fundit “i-qeverisja” ose “e-government” që për mua paraqet esencialisht transformimin digjital të shtetit, një projekt ku është dashur të ndikojë në zvogëlim të nepotizmit, rritje të produktivitetit, janë buxhetuar për vitin 2026 380 mijë euro, në vend që të jenë 30 milionë, sepse ato kthehen shumë më shpejt dhe shumë më mirë, këtu janë buxhetuar 380 mijë euro.

Këto janë disa prej gjërave që i pashë edhe i lexova e që më dhimbën kështu duke i lexuar, se s'pashë vizion konkret që ky vend ka për t'u transformuar, të investohet në digjitalizim, në teknologji. Nëse në hulumtime dhe kërkime i keni parë 50 mijë euro në vit, unë nuk e di, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje si do t'i ngrenë duart për diçka të tillë. Nuk e di a kanë lexuar ose a guxojnë të ngritin dorën për diçka të tillë ose nuk guxojmë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ariana Musliu-Shoshi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Shumë të dashur qytetarë,

Kryeministër, edhe sot dëgjuam sërish një paraqitje optimiste nga ju, por ajo që mungon është më e rëndësishme se ajo që thuhet sot. E ajo që mungon është dokumenti kryesor që ne sot do të duhej të kishim para nesh, e që është programi qeveritar.

Në një demokraci serioze nuk mund të kërkohet besim pa transparencë, nuk mund të kërkohet durim nga opozita pa plan dhe nuk mund të flitet për zhvillim pa treguar rrugën e qartë se si do të arrihet ai zhvillim për vendin. Folët për një buxhet prej afër 4 miliardë eurosh, një shifër e madhe në letër, por na thua, kryeministër, ku realisht po shkojnë këto para dhe kush realisht po përfiton? Sepse, qytetarët nuk e matin suksesin tuaj me statistika, por me mirëqenien në tryezat e tyre.

Kryeministër, sot e thotë, e keni thënë edhe më herët, keni premtuar pagën e 13-të, keni premtuar rritje pagash, keni premtuar rritje pensionesh, shtesa për fëmijë dhe për gratë. Ne asnjëherë nuk jemi dhe as nuk kemi qenë kundër rritjes së mirëqenies. Përkundrazi, ajo duhet të jetë synim primar i çdo qeverie. Por, rritja nuk duhet të jetë propagandë financiare. Ajo duhet të vijë nga një orientim i qartë ekonomik, nga zhvillimi i prodhimit dhe nga krijimi i vendeve të qëndrueshme të punës. Përndryshe, rrezikojmë të shpërndajmë para sot dhe të krijojmë pasiguri nesër. Na u tha se po sigurohet qëndrueshmëria ekonomike, por qëndrueshmëria nuk shpallet, kryeministër, ajo ndërtohet dhe ndërtohet me investime reale.

Për këtë vit u tha nga ju pak më herët se paralajmërohen 720 milionë euro investime kapitale, me ambicien për të arritur 1 miliard. Pyetja konkrete është, sa projekte janë përfunduar realisht dhe sa kanë mbetur vetëm premtime? Ju nuk jeni kryeministër vetëm sot, por jeni kryeministër nga viti 2019, pra që gjashtë vjet. Sepse, e dimë që ekonomia nuk rritet nga planet që përfundojnë në letër, por nga rrugët që ndërtohen, nga shkollat që hapen, e nga bizneset që fuqizohen. Dëgjojmë deklarata, e dëgjuam edhe pak më herët nga ju se kontrabanda është eliminuar.

Nëse është kështu, atëherë pse nuk kemi transparencë të plotë për tregtinë rajonale? Qytetarët tanë meritojnë fakte dhe jo slogane. Ndërkohë që qytetarët po përballen me një realitet krejt tjetër, kryeministër: rritje të vazhdueshme të çmimeve të produkteve bazë, kur buka, qumështi, vaji bëhen më shtrenjtë, çdo statistikë që ju e ne e flasim sot e humb kuptimin. Vendosja e një çmimi tavan që u tha më herët nga ju që ka qenë iniciativë e mëhershme, mund të tingëllojë si zgjidhje e shpejtë, por pa mekanizma të fortë tregu rrezikon të jetë vetëm një masë afatshkurtër. Ironikisht, në të njëjtën kohë kur familjet po detyruan të kufizojnë shpenzimet e tyre elementare, fitimet e korporatave, u tha nga ju, se kanë arritur në 2,2 miliardë euro për fitim.

Kjo nuk është domosdoshmërisht problem në shoqëri, sepse sukcesi i çdo biznesi është i mirëpritur, por bëhet problem kur rritja nuk shpërndahet drejtësisht dhe kur barra bie drejtpërdrejt mbi qytetarët tonë. Prandaj, sot kryeministër, nuk po kërkojmë mrekulli nga ju, po kërkojmë përgjegjësi, kërkojmë transparencë, kërkojmë një program të qartë qeverisës që tregon jo vetëm sa para ka shteti, por si të përmirësohet jeta e qytetarëve. Sepse, një qeveri asnjëherë nuk gjykohet nga fjalët që thotë, por nga realiteti që krijon dhe realiteti sot më shumë se kurrë kërkon punë, kërkon më pak propagandë nga ju dhe më shumë llogaridhënie. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që, meqë është hera e parë në këtë Legjislaturë që marr fjalën, t'i falënderoj qytetarët e Republikës së Kosovës që për të shtatën herë radhazi ma rikonfirmuan besimin për t'i përfaqësuar në këtë Kuvend.

Sot nuk do ta zgjas shumë, sepse i thanë kolegë deputetë nga të gjitha partitë dhe ngritën shumë çështje. Prandaj, sot kur po diskutojmë për buxhetin, nuk do të flas as për zhvillimin e infrastrukturës, as për policinë, as për ushtrinë, nuk do të flas as për energjinë elektrike ose shtrenjtimin e energjisë elektrike, as për ujin dhe për asgjë tjetër, por kjo nënkupton që i mbështes të gjitha adresimet që i folën ose i thanë bashkëpartiakët e mi, por dhe kolegë të tjerë deputetë nga tabori tjetër opozitar.

Duke i mbështetur të gjitha kërkesat nga kolegët, unë nuk mund të hesht sot vetëm për një çështje dhe kjo çështje të cilën do ta ngre tani unë mendoj që nuk duhet heshtur nga askush nga ne për një çështje më të ndjeshme dhe më të dhimbshme për shoqërinë tonë e që është siguria në shkolla. Fatkeqësisht, çdo ditë po lexojmë e po dëgjojmë lajme për dukuri devijues të rrezikshme, të cilat iu kanë vërshuar shkollave shqipe në Kosovë. Shkolla duhet të jetë tempulli i dijes dhe i edukimit. Duhet të jetë vend i sigurt, ku prindërit i dërgojnë fëmijët dhe jo hapësirë ku fëmijët tanë përballen me drogë, dhunë e dukuri të tjera negative.

Fatkeqësisht, sot jemi dëshmitarë se në shumë shkolla nxënësit që nga klasa e pestë janë të ekspozuar ndaj substancave narkotike dhe ndikimeve që rrezikojnë shëndetin dhe të ardhmen e tyre. Prandaj, para se të kërkojmë mësim tërëditor, para se të kërkojmë teknologji, para se të kërkojmë inovacion, ne duhet të kërkojmë siguri, sepse jo të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës i kanë mundësitë siç i ka Presidentja e vendit që fëmijët i çojnë në kolegje, shkolla private. Jo të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës i kanë mundësitë që t'i shkollojnë fëmijët në Norvegji, siç i shkollon kryeministri i vendit.

Fatkeqësisht, sot gjendja është alarmante dhe kjo nuk është çështje që pret, kjo është çështje emergjente dhe kombëtare dhe këtu kërkoj mbështetjen edhe të ish-ministres Nagavci, e cila është jashtëzakonisht mirë e njoftuar për gjendjen e rëndë që dominon shkolla. Prandaj, në kuadër të buxhetit 2026 kërkoj që të ndahet një linjë e veçantë buxhetore për rritjen e sigurisë në shkollat tona, përmes vendosjes së kamerave dhe sistemeve moderne të sigurisë, shtimit të stafit mbikëqyrës dhe psikologëve shkollorë, programeve parandaluese kundër drogës dhe dhunës, bashkëpunimit të strukturuar mes shkollave, prindërve dhe institucioneve të rendit, institucionet si Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta kenë prioritet të padiskutueshëm dhe të trajtojnë me seriozitet maksimal.

Nëse sot nuk investojmë në sigurinë e fëmijëve tanë, nesër do të paguajmë shumëfish më tepër në pasoja sociale, shëndetësore e morale. Buxheti nuk është thjesht një dokument financiar; është dokument vlerash dhe prioritetesh dhe prioriteti ynë duhet të jenë fëmijët e Kosovës. Sepse, një shoqëri që nuk i mbrohet fëmijët e saj, nuk e ka të sigurt as të ardhmen e vet. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputete! Ministër, a e dëshironi fjalën? Është paraqitur edhe një deputet, Artan Behrami.

Atëherë deputet, fjala është për ju!

ARTAN BEHRAMI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Të dashur përfaqësues të mediave që sot po e mbrojnë demokracinë më shumë se çdokush tjetër në Kosovë.

Të dashur qytetarë,

Meqë jemi në një ditë në prag të përvjetorit të 18-të të pavarësisë së Kosovës, dua t'i uroj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për këtë përvjetor. Nesër, si 18 vjet më parë, kryeministri Hashim Thaçi nga kjo foltore e shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Disa nënshkrues të asaj deklarate i kemi sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pavarësia e Kosovës është angazhim i përjetshëm për t'u dëshmuar atyre që ranë dhe atyre që nesër vijnë në jetë, se liria dhe pavarësia janë beteja që çdo ditë duhet të fitohen. Sot si 18 vjet më parë, unë isha në aeroplan drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i veshur me një bluzë me mbishkrimin "Edhe unë kam shtet".

Kur krejt bota e vërshoi Kosovën për të qenë dëshmitar i një ngjarje historike të papërsëritshme, unë si gazetar vendosa të festoj këtë ditë në shtetin që ndihmoi jetësimin e përpjekjeve për liri dhe pavarësi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pse kjo është e rëndësishme sot 18 vjet më vonë? Sepse, as në imagjinatën time më të errët nuk e kisha menduar se 18 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës do të festojmë pa ata që këtë shtet e skicuan, këtë shtet e shpallën, e bënë, e forcuan dhe e ndërkombëtarizuan; pa Hashim Thaçin, pa Kadri Veselin, pa Jakup Krasniqin dhe pa Rexhep Selimin.

Nga këto u dërgojmë urimet më të përzemërta, për t'u thënë se ata nuk janë vetëm. Se pas tyre e kanë edhe këtë Parlament, qysh u dëshmuar me votimin e Rezolutës për drejtësi. Se pas vetes e kanë edhe popullin, siç do të dëshmohet nesër me një pjesëmarrje historike në marshin për drejtësi. Për t'u thënë se populli i Kosovës nuk i duron padrejtësitë, se ky popull nuk do të lejojë rishkrimin e historisë.

KRYETARJA: I nderuar deputet, të lutem kthehu në temë!

ARTAN BEHRAMI: Të dashur qytetarë,

Ky përvjetor e gjen Kosovën me mungesë të parashikueshmërisë, në një moment ku vlerat tona si shtet çdo ditë po sfidohen, çdo ditë po testohen. Ky përvjetor e gjen Kosovën të përçarë, me urrejtje për njëri-tjetrin, me paqartësi dhe pasiguri. Ky përvjetor e gjen Kosovën të izoluar, pa miq, të pazhvilluar dhe pa vizion në ekonomi. Ky përvjetor e gjen Kosovën me marrëdhënie në gjysmështizë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Tani do të dal edhe te buxheti, e nderuar kryetare!

KRYETARJA: Do të kesh edhe mundësi të tjera, natyrisht që mund të flasësh, për shkak të respektit natyrisht edhe për UÇK-në, për pavarësinë e Republikës së Kosovës. Unë nuk ta ndërpreva fjalën, por të lutem respektojeni Rregulloren e Kuvendit, kthehu në temë, diskuto për buxhetin, përndryshe do të detyrohem ta ndërpres fjalën.

ARTAN BEHRAMI: Faleminderit, kryetare!

Unë jam duke folur për politikë të jashtme, për dështimet e politikës së jashtme dhe për atë se çfarë shkruan në buxhetin që e keni prezantuar këtu. Prandaj, unë do të vazhdoj, sepse pati fjalime këtu edhe më parë me të njëjtën frymë.

Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin goditja e parë e politikës së jashtme të gjashtë vjetëve të fundit.

KRYETARJA: Regjia, ju lutem që t'ia ndërpritni fjalën deputetit! Faleminderit!

Menjëherë dil te buxheti. Nëse nuk del menjëherë te buxheti, detyrohem që ta ndërpres dhe mos ta rikthej më fjalën. Të lutem respektoje fjalën time!

ARTAN BEHRAMI: Ndonëse e pakuptueshme, po vazhdojmë. Sot po diskutojmë për buxhetin e Kosovës dhe këta numra që shtrihen në 723 faqe nuk janë vetëm një projektim buxhetor, por është një skicim i prioritetëve të kësaj Qeverie.

Fatkeqësisht, bazuar në këtë buxhet, këtë vit politika e jashtme nuk është prioritet. Fatkeqësisht, edhe këtë vit shtimi i njohjeve për Republikën e Kosovës nuk është prioritet dhe fatkeqësisht edhe këtë vit anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare nuk është prioritet.

Nga ajo që kemi lexuar në këtë buxhet, nuk ka asnjë ndarje të dedikuar për lobim, për shtim të njohjeve, për përfaqësim strategjik në arenën ndërkombëtare, për forcimin e njohjes së Kosovës në botë. Tash e gjashtë vjet nuk është kontraktuar asnjë firmë lobuese amerikane për të siguruar që zëri ynë të dëgjohet te ligjvënësit dhe administrata amerikane. Kosova tash e gjashtë vjet nuk ka kontraktuar asnjë firmë amerikane për t'u siguruar se Kosova është partner i besueshëm për investitorët amerikanë.

Bazuar në këtë buxhet, shohim që nuk është kontraktuar asnjë firmë amerikane për të siguruar që mbrojtja e partneritetit me SHBA-në, mbështetja në sektorin e sigurisë, forcimi i ushtrisë të bëhet. Dikush mund të thotë për çfarë e kemi ambasadën tonë në Uashington? Por, edhe Gjermania si fuqi ekonomike botërore e ka ambasadën me dhjetëra e qindra të punësuar, por paguan firma lobuese amerikane. Edhe Franca si fuqi politike, ekonomike e ushtarake, me qindra të punësuar në administratën e tyre në Uashington, paguan firma lobuese amerikane.

Edhe Turqia si fuqi politike paguan. Përveç shteteve mike, edhe shtetet armike të Kosovës janë aktive në Uashington. Serbia asnjëherë nuk e ka ndryshuar agjendën luftënxitëse dhe të dominimit, me të cilën ka hyrë dhe ka kryer gjenocid në Kosovë. Ajo ka investuar dhjetëra miliona euro në kompani po ashtu amerikane të lobimit. Paramendojeni, edhe Rusia, e cila teknikisht është në luftë me Perëndimin, paguan kompani të tilla. Madje, edhe ambasada e Iranit në Uashington kontrakton dhe merr shërbime nga kompanitë e tilla.

Kosova e vogël, e izoluar ndërkombëtarisht, me stagnim total në shtimin e njohjeve, me frenim në anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, me dialogun Kosovë-Serbi mbi kokë, me rrezikun për rishkrimin e historisë nga Gjykata Speciale, i duhet një aranzhim i tillë sa më parë. Jo, aso kompanish që llojnë në Soma, po aso kompanish që avokojnë në Shtëpinë e Bardhë. Kompanitë lobuese nuk mund t'i ndryshojnë vijat e trasha gjeopolitike të SHBA-ve, por ato mund ta ndihmojnë Kosovën të dinamizojë jetësimin e prioriteteve në politikën e jashtme, duke shtyrë përpara anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe rikthimin e dialogut për marrëdhënie strategjike me SHBA-në. Sepse, në botën e trazuar gjeopolitikisht, asgjë nuk është e mirëqenë.

Pra, lobimi është një instrument strategjik për ta mbrojtur vendin tonë, për të ndërtuar aleanca dhe për të garantuar të ardhmen e shtetit tonë. Dhe në këtë buxhet, nuk është ndarë asnjë linjë e veçantë buxhetore.

Prandaj, do të jetë jetike që të krijohet një linjë e tillë dhe të shpenzohen këto para në lobim, në Uashington, në Berlin, Bruksel, në Paris dhe qendra të tjera multilaterale. Një amendament i tillë, unë besoj që do ta kishte votën time, por dhe të deputetëve të tjerë.

Të dashur qytetarë,

Pse është i rëndësishëm një mekanizëm i tillë që të jetë në buxhetin e Kosovës? Sepse, mungesa e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës dhe në NATO, por edhe në Kombet e Bashkuara, do ta sfidojë subjektivitetin ndërkombëtar të vendit tonë.

Dua t'jua jap vetëm një shembull. Me pak fjalë. Këtu e kam një raport të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i publikuar dy muaj më parë. Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi ka përfunduar punën e tij dhe aktualisht funksionon mekanizmi ndërkombëtar i mbetur për tribunalet penale, i cili po reduktohet gradualisht. Në këtë proces,

arkivat e Tribunalit të Hagës me të cilat është gjykuar Milosheviqi do të zhvendosen në një vend jashtë Holandës. Një pjesë shumë e madhe e këtij arkivi asnjëherë nuk është përdorur në tribunal dhe në mesin e tyre ka shumë dokumente, shumë incizime për krimet serbe në Kosovë që dëshmojnë ato krime.

Dhe, ndër shtetet që kanë aplikuar për të marrë arkivin e Tribunalit është shteti që ka bërë gjenocid në Ballkan, Serbia. Për këtë arkiv kanë aplikuar edhe shtetet e tjera. Është jetike që Kosova të bëjë të gjitha përpjekjet politike e diplomatike për të kërkuar që arkivat të kthehen në Kosovë. Po ashtu, bashkë me shtetet mike në rajon, Evropë e botë, të sigurohen që ato mos të përfundojnë në shtetin që e ka sponsorizuar gjenocidin në Ballkan, Serbinë. Nëse arkivat vendosen në Serbi, ekziston rreziku politik i kontrollit narrativ dhe i kufizimit indirekt të qasjes, sidomos për dokumentet jopublike dhe materialet që kërkojnë bashkëpunim institucional.

Ne jemi dëshmitarë që Serbia ka falsifikuar, ka fabrikuar dokumentacione dhe arkiva në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës dhe në Gjykatën Speciale.

Dhe, në fund, për Gjykatën Speciale, populli i Kosovës nesër e jep verdiktin e tij me pjesëmarrjen historike në sheshin “Skënderbeu”.

“Drejtësi, jo politikë”. Ju ftoj që të merrni të gjithë pjesë! Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputeti Bedri Hamza është paraqitur për fjalë. Ka folur në emër të grupit, tash ka të drejtë edhe në emër të tij si deputet, prandaj po ia japim fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Me vëmendje i përcolla gjatë gjithë kohës diskutimet në Kuvend dhe nuk e shoh shumë të rëndësishme renditjen e hapave drejt këtij procesi. A është zgjedhja e Qeverisë, ekspozaja, programi, buxheti. Ato mund të rirregullohen dhe besoj që në një të ardhme të shpejtë do ta kemi edhe programin e Qeverisë, do ta kemi edhe buxhetin e rishikuar. Problemi është përtej kësaj. Problemi është që prioritetet e prezantuara në ekspozë, e pres që një pjesë e tyre do të jenë edhe në program, nuk ka hapësirë fiskale të akomodohen brenda buxhetit. Mungon hapësira fiskale.

Nga 653 milionë euro projekte kapitale në vitin 2026, vetëm 40 milionë janë projekte të reja. Ku të akomodohen ato premtime? Kemi folur për investime në diga, rreth 400 milionë, derisa në buxhet për këtë vit edhe vitin e ardhshëm gjithsej janë 13 milionë e 900 mijë euro. Ku vendoset pjesa tjetër? Ku është autostrada e Dukagjinit? Ku është ajo Banullë-Qafë e Duhles? Ku janë investimet në hekurudha?

Dhe, duhet t'i trajtojmë disa çështje më serioze. Lojërat Mesdhetare. Ne e shohim që te Lojërat Mesdhetare është një pozicion aty që më mirë do të ishte të mos ishte fare, renovimi i qendrave studentore për Lojërat Mesdhetare, 10 mijë euro. Po çka bën me 10 mijë euro?

Prandaj, hapësira fiskale është ngushtuar, struktura e buxhetit është ndryshuar, është ndryshuar në dobi të transfereve dhe subvencioneve, në dëm të investimeve kapitale dhe këtu paraja ka dalë jashtë. Është rritur konsumi, po e jep ndikimin në kërkesën agregate, por nuk garanton rritje të qëndrueshme ekonomike. Paga e trembëdhjetë është mirë që po jepet. Asnjë nuk besoj që është kundër, po duhet ta themi qartë, që paga e trembëdhjetë nënkupton 8% të rritjes së pagave. Kjo është pak! Është më pak se pak!

Nuk ka hapësirë dhe nuk shoh që do të ketë rritje të subvencioneve dhe të pensioneve të tjera që do të jenë të parashikueshme dhe të planifikuara. Një çështje tjetër, më ka bërë përshtypje dhe jam pajtuar, më ka pëlqyer. Do të lirohet paga minimale prej tatimit në pagë. Qarkullimi deri në 6 mijë euro do të lirohet. Veturat e reja të importuara prej BE-së do të lirohen prej taksës doganore 10%, të gjitha i përkrah. Dhe, në të njëjtën kohë, u premtua rritja e pagave dhe e subvencioneve. Para do kohe, kryeministër, po është kjo simpatike.

Kryeministër,

Ke pas thënë që nuk ka mundësi të ulen tatimet edhe të rriten pagat. Unë kam thënë që ka mundësi, ka ndodhur edhe mund të ndodhë. Kryeministër, ose s'e ke pasur mirë atëherë, ose s'e ke mirë tash. Unë po të them tash e ke mirë, atëherë ke pasur keq. Po ka kaluar ajo.

Prandaj, ka shumë projekte të cilat përnjëmend Kosova ka nevojë. Ka nevojë për investime në energji, ka nevojë për investime në infrastrukturë, ka nevojë për shumë investime. Po brenda kësaj hapësire fiskale për buxhetin e vitit 2026 edhe dy buxhetet e viteve vijuese, 2027 dhe 2028, nuk ka mundësi të akomodohen.

Edhe krejt në fund, duhet shikuar edhe vlerën për para. Kur flasim 700 milionë investime kapitale që priten të jenë në vitin 2026, nëse e kemi normën e inflacionit, nuk janë të barabarta me nivelin e investimeve në 2012. Janë më pak, sepse me paratë me 700 milionë sot të investuara në investime kapitale, duhet ta përkthejmë sa kilometra rrugë mund t'i bëjmë, sa shkolla mund t'i ndërtojmë, sa çerdhe mund t'i ndërtojmë.

Edhe te subvencionet, duhet pyetur prapë vlerën për para. Po japim qindra miliona në subvencione. A e ka ndryshuar gjendjen? A është zvogëluar importi i atyre produkteve, qofshin bujqësore, qofshin të tjera si rezultat i subvencionimit? Ku është vlera për para?

D.m.th. ty po të rritet importi, po përkeqësohet deficitit tregtar, ne po vazhdojmë me subvencione. Prandaj, këto politika duhet të ndryshohen. Buxheti duhet të vendoset në favor të sektorëve

strategjikë, të cilët garantojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe, mbi të gjitha, krijim të kushteve të favorshme për bizneset.

Asnjë reformë fiskale domethënëse nuk e kemi parë pesë vjetët e fundit dhe pres këto që gjatë këtij mandati të ndodhin. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Edhe z. Tahiri është paraqitur për fjalë.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Vetëm tri çështje për ministrin Hekuran Murati.

E para, u fol shumë për punën e buxhetit për Prishtinën. A ka mundësi të dalë ta shpjegojë para qytetarëve të Prishtinës të vërtetën? Më 6 shkurt është miratuar buxheti në Asambleenë Komunale, më 13 shkurt është propozuar buxheti prej Qeverisë. Pse nuk është në këtë ligj? Është me rëndësi të dihet, për shkak se u fol shumë. Besoni as unë s'po e kuptoj çka ka ndodhur. A bën ta dimë pse në buxhetin e Kosovës, pse nuk është Ligji për kryeqytet?

E dyta, ka të bëjë me rrugët magjistrale. Arsyeja pse po e ngre këtu, edhe për këtë në qoftë se ka mundësi ta jepni një përgjigje. Në qoftë se ky buxhet do të vijë në rishikim, kushtimisht po them, në prill, a nënkupton kjo që në rrugët të cilat janë të paasfaltuara, të pashtuara që janë problematike, në akset rrugore, nuk do të ketë investime edhe do të pritët koha kur do të rishikohet.

Edhe e treta, një sqarim na nevojitet për nenin 31. Neni 31, siç u tha më herët, është antikushtetues. Është bukur e rëndësishme ta jepni një sqarim tash kur e jep sqarimin për çështjet që u ngritën për buxhet.

Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit z. Tahiri! Tani e ka fjalën ministri Hekuran Murati.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

U thanë shumë çështje, u ngritën shumë tema. Po mundohem që t'i adresoj një nga një, ose të përmbledhur, kështu së paku ato që konsideroj që kishin të bënin me buxhetin. U tha fillimisht pse kjo urgjencë, se nuk ka nevojë. Në fakt, ne jemi vonë. D.m.th. ky buxhet do të do duhej të ishte në fuqi më 1 janar. Domethënë, shteti do të duhej të kishte buxhet që nga data 1 janar, por në mungesë të atij buxheti, është zbatuar masa emergjente e zgjatjes së buxhetit të vitit të kaluar që mundëson vetëm pagesat të shpenzimeve rrjedhëse ose të atyre kontratave që kanë qenë pra në vazhdimësi e sipër, kontratave aktive, por nuk mundëson inicimin e prokurimeve apo kontratave të reja. Kjo për t'u përgjigjur pikërisht edhe në pyetjen e deputetit Besnik Tahiri që e kishte se çfarë ndodh me këto rrugë.

Pra, pikërisht duke mos e pasur këtë buxhet të miratuar, nëse ne do të vonoheshim për ta sjellë buxhetin ashtu të rregulluar siç po kërkohet, do të rrezikonim që këto kontrata, këto inicime të procedurave të mos bëheshin tash, por të shtyheshin më vonë. Pra, ky është problemi.

Sa i përket urgjencës, mendoj që duhet ta kemi të qartë; nuk ka asnjë lloj motivi tjetër. Për më tepër, deputeti Gruda e përmendi që fillimisht erdhi zgjatja, pastaj pse e sollët buxhetin. Ne, në fakt, në Qeveri, në mbledhjen e njëjtë i kemi miratuar të dyja. Domethënë, vetëm sa për ta sqaruar dhe për ta heq çdo dilemë. Ka qenë çështje e Kuvendit që në rend dite fillimisht e ka përfshirë zgjatjen e buxhetit, sepse ka mundur ta miratojë pa pasur Komisionin për Buxhet.

Ndërkaq, Projektligji për buxhet është dashur fillimisht të kalojë te Komisioni për Buxhet. Pra, kjo ka qenë arsyeja pse në seancë plenare kanë ardhur si dy çështje të ndara, mirëpo në Qeveri ne e kemi miratuar si pako, pra në një mbledhje të Qeverisë; fillimisht pra zgjatja që të sigurohemi që shpenzimet rrjedhëse vazhdojnë pa ndërprerje dhe e dyta buxheti, ky që ka qenë, pra i miratuar më 31 tetor, sepse po të hynim në procesin e rishikimit, pra ende pa pasur një buxhet, rrezikonim sinqerisht të mbesim pa buxhet pastaj.

Domethënë, mund të kalojmë në afate se ju po e shihni edhe vetë, pra në Kuvend ka procedura të tjera. E për më tepër, janë ministritë e linjës të cilave duhet t'u dërgohet një qarkore e re. Do të ishin stafi i buxhetit që po ashtu ka procedurat e veta për të përpiluar këto 700 faqe që po i shihni. Pra, sepse aq sa është vështirë për t'i lexuar e për t'i shqyrtuar, pra ka një punë edhe te përpilimi i këtij buxheti.

Te çështja e buxhetit të komunave që u ngrit nga disa prej palëve. Ne buxhetin e kemi proceduar ashtu siç ka qenë, pra tabelat që kanë qenë të përditësuara deri në ditën e mërkurë, pra kur e kemi mbajtur pastaj edhe mbledhjen e Qeverisë të nesërmen.

D.m.th. ato komuna që kanë arritur ta miratojnë buxhetin deri në atë datë dhe ta përfshijnë në sistem, sepse janë dy procese të ndryshme; pra një gjë është akti administrativ i miratimit në Kuvendin Komunal, gjë që e ka bërë Komuna e Prishtinës më datën 6 shkurt, por ka qenë ditë e premtë dhe pastaj e shtunë dhe e diel kanë qenë pushim. Në dy ditët e tjera nuk kanë arritur që t'i përfshijnë tabelat pra në sistemin e buxhetit, i cili pastaj kur eksportohet, eksportohet si tërë dhe prodhohen këto tabela që i keni para jush. Normalisht, ne kemi proceduar, sepse nuk ka qenë vetëm Prishtina, pra është edhe Komuna e Shtimes që nuk është e reflektuar këtu, pra për ta hequr çfarëdo dileme që po pretendohet se ka të bëjë me politikë, është thjesht procedurë.

Pra, është Komuna e Prishtinës, Komuna e Shtimes dhe Komuna e Zubin Potokut. Janë këto tri komuna, të cilat nuk janë përfshirë deri në datën kur ne është dashur ta prodhojmë dokumentin për mbledhjen e Qeverisë për ta proceduar tutje si material në Kuvend. Mirëpo, kjo nuk nënkupton që ato buxhete nuk mund të përfshihen. Siç e kemi thënë edhe vitin e kaluar,

megjithëse këto komuna janë vonuar në miratim të buxhetit të tyre, hapi tjetër apo shansi tjetër për t'i përfshirë në paketën e ligjit, pra Projektligjit për buxhet, është në mes të dy leximeve.

Pra ose është dashur, sepse ta kemi parasysh, pra nuk janë ndjekur procedurat ashtu siç po pretendohet. Komunitat do të duhej t'i kishin buxhetet e miratuara më datën 30 shtator të vitit të kaluar. Pra, një komunë që e miraton buxhetin në muajin shkurt në vitin 2026, po flasim për pesë muaj vonesë. Pra ka vonesa, por gjithsesi ne jemi që t'i përfshijmë këto. Vetëm se datën kur është gjeneruar raporti, pra buxheti dhe tabelat e buxhetit për t'u përcjellë në mbledhjen e Qeverisë, e pastaj edhe në Kuvend, nuk kanë qenë të përfshira në sistem, sepse komunitat janë vonuar. Ndoshta, kryetari i Komunës së Prishtinës po të ishte kaq i zellshëm të punonte fundjavave, aq sa është i zellshëm të mbajë konferencë për media gjatë fundjavave, s'do ta kishim këtë problem.

Mirëpo, prapë po e them, kjo punë, kjo çështje mund të rregullohet dhe do të rregullohet në mes të dyja leximeve, pra për të gjitha komunitat që arrijnë ta përfshijnë buxhetin në sistemin e buxhetit. Nëse ka ndonjë komunë që mbetet pa e miratuar buxhetin edhe pas leximit të dytë, është procedura që e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, që thotë që: Komuna ia përcjell ministrit të Financave, ministri i Financave - Qeverisë, Qeveria - Kuvendit dhe Kuvendi pastaj e ka në diskrecion a e miraton apo jo. Për ne, siç e thashë, besoj dhe shpresoj që Komuna e Prishtinës, por edhe komunitat e tjera, Komuna e Shtimes dhe Komuna e Zubin Potokut, pra ta mobilizojnë stafin, ta mobilizojnë administratën e tyre që të punojnë dhe t'i përfshijnë buxhetet e tyre në sistemin e buxhetit shtetëror.

Ne si, Ministri e Financave, stafit të ministrisë për të cilin jam falënderues, shpesh i bie të punojë edhe fundjavave, edhe përtej orëve kur është situata emergjente, pra kur ka nevojë që të përgatiten tabela apo projektligje të tilla. Do të duhej që edhe komunitat ta bartnin barrën e tyre të përgjegjësisë. Kjo sa i përket buxhetit të komunave. Edhe një herë po e theksoj: të gjitha ato komuna që arrijnë t'i miratojnë buxhetet dhe t'i përfshijnë në sistemin ndërmjet dy leximeve në sistemin e buxhetit, do të përfshihen pa kurrfarë problemi.

Sa i përket çështjes tjetër, u përmend nga deputeti Hamza çështja e hapësirës fiskale, tash, unë e kuptoj që një kritikë e tillë ka qenë edhe në fillim të mandatit të kaluar, madje ndoshta edhe fjalëpërfjalshëm ka qenë që një pjesë e madhe e premtimeve nuk ishin reflektuar apo përfshirë në buxhet, sidomos shtesat për fëmijë, për të cilat thuajse edhe do ta bankrotonin shtetin.

Ka qenë deputeti Besian Mustafa që pati thënë që mënyra qysh e keni hartuar buxhetin do ta zhytni vendin në borxhe, 1 miliard euro borxhe, borxhi publik do të shkojë mbi 30%. Pra, e pamë që edhe shtesat u bënë, edhe paratë u gjetën edhe vendi, lëre që s'u fut në borxhe më tutje, ose nuk u eskalua problemi i borxhit, por borxhi publik tash është në nivelin më të ulët ndoshta në dekadën e fundit.

Sa u përket projekteve konkrete, po, për shembull janë çështjet e rrugëve, apo çështjet e digave, të cilat parashihet dhe janë në proces të negocimit. Domethënë, ai buxheti që është bërë vetëm sa për ta hapur kodin, për shembull, tek Qendra Studentore, ai është për ta filluar si kod, mirëpo financimi aty do të vijë nga huamarrja dhe procesi është duke zhvilluar me Agjencinë Franceze për Zhvillim.

Ngjashëm është edhe Pallati i Rinisë, është me Bankën Investive Evropiane. Ngjashëm janë edhe shumë projekte të tjera me diga, apo të ngjashme infrastrukturore, të cilat do të përfshihen në kuadër të financimit nga huamarrja. Pra, jo domosdo gjithçka financohet nga granti buxhetor.

Pamë edhe adresime të tjera që mendoj, ose kanë qenë të keqinformuara, ose ndoshta mund të jenë edhe të qëllimshëm të proklamuar si të tilla. Për shembull, deputeti Haradinaj nga AAK-ja e përmendi që shumica e rrugëve nuk janë fare në buxhet. Më vjen keq, por janë në buxhet. Domethënë, janë edhe kodet për to. Ta zëmë, për rrugën Dollc-Gjakovë kodi 1568, për rrugën për Gjilan është 1550, e kështu me radhë. Pra, janë në buxhet, janë të përfshira.

Problemi që ka qenë në vazhdimësi me këto projekte të trashëguara ka qenë mënyra se si janë lidhur kontratat. Asnjëherë nuk ka qenë çështje ndarja e buxhetit. Sa herë që kemi ndarë më shumë buxhet te këto rrugë - ka tepruar, sepse punëkryerësit nuk e kanë kryer punën që të mund të shpenzohen ato para. Domethënë, kurrë s'ka qenë problem buxheti për këto projekte. Është çështja te kontratat që janë lidhur ose në mënyrë të gabuar, ose pa qenë projekti i detajuar, ose pa qenë procesi i shpronësimit i përfunduar.

Ka dhe të tjera, për shembull, u përmendën investime të ndryshme, qoftë në infrastrukturën e digjitalizimit, apo edhe në infrastrukturë energjetike. Shumë prej gjërave janë edhe jashtëbuxhetore, ose edhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, zbatimi i ligjit për mbledhjen e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm, apo për tarifën e tillë. Ai fond është jashtëbuxhetor, pra nuk përfshihet në buxhet. Është një fond, i cili do të jetë jashtëbuxhetor dhe menaxhohet si i tillë. Ajo çfarë figuron aty është fondi, apo shuma e ndarë për trajtime jashtë institucioneve publike, që është në kuadër të asaj që tash quhet si Fondi për Sigurime Shëndetësore.

Ose për ITP-në, për shembull. U përmend një shumë e vogël, në fakt për ITP kjo Qeveri në të kaluarën, përmes Ministrisë për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka ndarë 8 milionë euro, sepse mënyra se si funksionon ITP-ja është e tillë. Nuk është organizatë buxhetore që të figurojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Edhe një minutë, të lutem, ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Nuk është pjesë e buxhetit që të figurojë si e tillë, por bëhet ndarja përmes subvencionimit në kuadër të marrëveshjes ndërkombëtare që kemi pasur edhe me GIZ-in gjerman, të cilët po ashtu kanë bashkëfinancuar nëse nuk gaboj edhe 6 milionë euro të tjera. Është një shumë e konsiderueshme, e cila i është ndarë ITP-së.

Kishim edhe pretendime të tjera. Për shembull, deputetja Salihu nga Ferizaj, pasi e përfundoi fjalimin dhe tregoi se si 70 milionë euro projekte janë në buxhet për Komunën e Ferizajt, tha nuk është bërë kurrjë për Ferizajn. Domethënë, veç të mos jemi kundërthënës brendapërbrenda fjalisë.

Sa u përket çerdheve. Pra, për pesë vjet janë ndërtuar 74 çerdhe. Ndërkaq, në periudhën para qeverisjes tonë kanë qenë vetëm 4 çerdhe. Domethënë, e kuptojmë që ndoshta mund të mos i kemi përfunduar të gjitha ato që kemi thënë. Megjithatë, është shumë më tepër sesa të gjitha...

(Ndërprerje nga regjia)

KYRETARJA: Faleminderit, ministër!

Janë paraqitur deputetët për replika. Po i marrim, nëse je dakord ministër, deputetët të cilët janë të interesuar që të bëjnë replika, gjithnjë atyre që ua ke përmendur emrin apo i janë referuar fjalimit. Prandaj, po vazhdojmë me deputeten Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!

Ministër, 74 çerdhe nuk janë ndërtuar në mandatin tuaj. Nuk ka asnjë statistikë publike e cila e vërteton një gjë të tillë. I ke për tre vjet radhazi 7 çerdhe modulare, merre me mend, çerdhe modulare me qëllimin që kishe të bëhen shpejt, edhe i ke ndarë vetëm 150 mijë euro për buxhet të vitit 2026. Nuk ka çerdhe të ndërtuara. Ju lutem, nëse ke mundësi ta sjellësh listën. Jo, 74 në asnjë rast.

Në anën tjetër, të gjitha shpenzimet kapitale, edhe pse keni pasur shumë ngecje sa i përket shpenzimit të buxhetit për shpenzime kapitale në vitet e kaluara, asnjë nga projektet e mëdha nuk ka përfunduar. Edhe pas pesë vjetësh që je në Qeveri, duke mos e ndarë Qeverinë me asnjë parti tjetër, keni qenë partia e vetme me 50% e 51%, nuk e ke luksin, ministër, t'i akuzosh të tjerët, të thuash: kontratat shpronësimi, ajo, kjo. Është dashur të përfundojë rruga për Pejë, rruga për Gjilan, rruga për Podujevë, rruga Kijevë-Zahaj, rruga Dollc-Gjakovë. Të gjitha këto është dashur që të përfundojnë.

Nëse nuk ka qenë pengesë buxheti, më lejo të tregoj që këtu pengesë është korrupsioni. Korrupsioni jashtëzakonisht i lartë, sepse kur merren përqindjet në fillim, mandej nuk e keni guximin të shkoni dhe t'ua shkëputni kontratat. Qysh mund ta arsyetosh një operator ekonomik, i

cili nuk e ka kryer punën e vet që pesë vjet? Nuk ka lidhje a e ka lidhur dikush tjetër kontratën, a kush, apo jo.

Domethënë, pesë vjet s'ta ka kryer punën, nuk je në gjendje të shkosh për t'ia shkëputur kontratën. Këtu nuk ka arsytim tjetër, përpos që ata ju shantazhojnë juve për shkak të korrupsionit të lartë.

Ministër, edhe një herë sa i përket buxhetit të Prishtinës. Kishim pasur shumë dëshirë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Edhe deputeti Bedri Hamza. Edhe një herë po e sjell në vëmendjen tuaj: Rregullorja e Punës së Kuvendit thotë që vetëm nëse i është përmendur emri, apo nëse i është referuar diskutimit të tij. Në ndërkohë, unë shoh këtu që plot deputetë janë paraqitur për fjalë pa i përmendur fare as diskutimet, e as emrat e përveçëm të tyre.

Prandaj, me këtë rast po e ftoj vetëm edhe zotin Bedri Hamza, dhe e përmbyllim kohën e replikave. Besnikun e ke përmendur, edhe Daut Haradinajn e ke përmendur, por Besniku s'po do, Dauti nuk është. Prandaj, zoti Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kisha pasur dëshirë që të ketë hapësirë fiskale ku mund të akomodohen projektet me rëndësi për zhvillimin e Kosovës. Mirëpo, përtej, po e lëmë punën e digave. I gjetët paratë. Nuk janë 400 milionë, veç 14 milionë i keni. Ku janë paratë? Qysh do ta financoni rrugën Rahovec-Prizren-Gjakovë-Deçan-Pejë-Istog? Ku janë paratë? Ku është kodi për vazhdimin e autostradës së Gjilanit dhe autostradës "Arbër Xhaferi" prej Banullës deri në Qafë e Dulës. Ku janë paratë, të cilat janë të nevojshme për shumë projekte në kogjenerim? Ku janë paratë për rehabilitimin e Kosovës A dhe Kosovës B?

Nëse duam ta rritim borxhin publik, prapëseprapë, zoti ministër, duhet të paktën t'i jemi pjesë e projeksioneve makrofiskale, edhe parashikimi i rritet borxhit. 1 miliard euro garanci janë premtuar, dhe kjo e kalon borxhin publik në nivel tjetër. Nëse borxhi publik përdoret edhe për financimin e këtyre projekteve kapitale, kudo qofshin, s'po hyj më specifikisht, prapëseprapë borxhi publik kalon në nivel tjetër. Ne e dimë që kreditë ndërkombëtare kanë kohë të gjatë prej momentit të fillimit të negocimit e deri në ratifikim, dhe pastaj për më shumë se një arsye, të gjithë e dimë që dizbursimi i mjeteve nga kreditë është shumë i ulët.

Prandaj, unë kisha pasur dëshirë, por po të siguroj kur të vijë rishikimi i buxhetit do të pajtohem i që nuk ka hapësirë fiskale, e cila i zë të gjitha këto projekte. Faleminderit!

KRYETARJA: Edhe deputetja Arbnore Salihu, sepse ministri ia ka përmendur emrin, e ka replikën, pastaj ministri.

ARBNORE SALIHU: Faleminderit, kryetare!

Ministër, a je këtu? Ti edhe ke mundur të ndash buxhet për Ferizajn, po për projektet jetike kryesore për Ferizajn, planifikimet dhe mjetet i ke ndarë për vitet 2028-2029. Po besoj je duke e kuptuar. Projektin jetik për Ferizajn, 19 milionë euro i ke ndarë në 2028-ën. Imagjinoje çka ke bërë. Po, ti nuk i ke planifikuar qysh duhet këto mjete dhe ti e di shumë mirë çka ke dashur të bësh. Ti e di shumë mirë, edhe po besoj qytetarët e Ferizajt tashmë e kanë kuptuar se ti ke dëshirë t'i zvarritësh projektet për Ferizajn, se nuk të konvenon të dërgosh projekte atje, se Komunën e Ferizaj e qeverisë Agim Aliu, e Partia Demokratike e Kosovës.

Kjo është arsyeja pse ti krejt projektet i ke bllokuar, i ke penguar dhe i ke zvarritur, e mjetet i ke planifikuar, jo për 2026-tën, por për 2028-tën e për 2029-tën.

KRYETARJA: Kundër-replikë, ministri Murati. Ministër i ketë tre minuta.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Për çerdhet. Sa u përket çerdheve, nga deputetja Hykmete që u përmend, tash e vërtetë që në disa raste komunat, pra kur keni qeverisur ju edhe kanë penguar. Domethënë, nuk është që kanë qenë ekspeditivë me dhënien e lejeve apo me bashkëpunime të tjera që kanë qenë të nevojshme. Sepse, siç e dini, edukimi i hershëm parashkollor është në kompetenca të nivelit lokal.

Pra, në këtë rast ka pasur edhe pengesa nga vetë komunat. Kjo është edhe një arsye pse ndoshta nuk është arritur rezultati i plotë që të ketë më shumë çerdhe apo numri sa është premtuar në fillim.

Sa i përket korrupsionit, ju e thatë një gjë serioze, një akuzë serioze që thatë që kontratat apo për këto kontrata, për këto rrugët që po vonohen, është dhënë ryshfet në fillim të kontratave. Kjo është akuzë shumë serioze. Nëse keni fakte për këto gjëra, ju ftoj ngjashëm siç ka bërë ministri për këto. Mirëpo, këto nuk kanë qenë të nënshkruara në qeverisjen tonë. Po besoj e di kur janë nënshkruar. Të gjitha këto kontrata janë nënshkruar së paku në qeverisjen PAN, pra PDK-AAK-Nisma.

Kështu që, ngjashëm qysh kanë dërguar ministrat tanë dosje në Prokurori, por që ende çuditshëm Prokuroria nuk po merret me to, të lutem, shko dorëzoji edhe ti ato fakte, argumente që i ke, se jemi të interesuar ta luftojmë krimin. Veç urdhëro! Ama, veç të dilet këtu e të thuhet është marrë ryshfet, qysh po flitni në djathtë e në të majtë, pa përmendur emër konkret, nuk bën.

Kjo pastaj është manipulim me opinionin publik. Sa u përket çështjeve të projekteve, pra buxheti për rrugët Duhël-Banullë, kjo është e paraparë në negociim me BERZH-in, kredi po ashtu. Edhe sa u përket projekteve të tjera. Buxheti aktualisht për vitin 2026 për kapitale është 1 miliard euro, por jo të gjitha projektet janë të përjetshme, apo të përhershme. Domethënë, ka projekte që kryhen, lirohet hapësira fiskale dhe vijnë të tjerat. Kjo është forma se si mund të përfshihen të gjitha ato projektet që u përmendën.

Ndërkaq, sa i përket çështjes apo Komunës së Ferizajt, unë mendoj që problemin kryesor Komuna e Ferizaj e ka me borxhe dhe me përmbarues, dhe me shkeljet ligjore që i bën vazhdimësi. Po mendoj, aty është problemi. S'ka të bëjë fare me nivelin qendror. Përkundrazi, niveli qendror është përpjekur ta mbështesë atë sa ka mundur në të gjitha fushat, duke filluar prej Qendrës për Mjekësi Kryesore Familjare, duke filluar prej çerdheve, duke filluar edhe prej spitalit, të cilin e keni lënë gjërmadhë kur keni qeverisur ju.

Edhe ato kontratat që i keni lënë të çuditshme dhe interesante, ngjashëm, një gjërmadhë është edhe këtu. Pra, s'ka të bëjë veç me Ferizajn. Është edhe Qendra Emergjente apo si quhet në oborrin e QKUK-së. E njëjta storie është. E njëjta storie, ku lihet një gjërmadhë për shkak se operatori i përzgjedhur nuk e ka kryer punën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit, ministër!

Vazhdojmë tani me votimin e Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Fillimisht po votojmë për prani. Pra, ju lutem që të votoni për praninë. Atëherë, 100 deputetë janë të pranishëm. Votojmë tani!

Procedojmë me votimin e Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Votojmë tash!

Konstatoj se me 66 vota për, 32 vota kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi e miraton në parim Projektligji nr.10-L001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Falënderoj deputetët e Kuvendit për votimin e buxhetit!

Në ndërkohë po e shoh që shefja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, zonja Nagavci e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zonja Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Urime për votimin e projektligjit në lexim të parë! Në vijim të diskutimit që e kemi pasur edhe të premtën, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoj që shqyrtimi i Projektligjit nr. 10-L001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin

2026 të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 34 paragrafi 4, nenin 52 paragrafi 1, nenin 80 paragrafi 4 dhe nenin 81 paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

Amendamentet në projektligj t'i adresohen Komisionit FunkSIONAL për Buxhet deri më 18 shkurt 2026, në orën 16:00.

Komisionet parlamentare deri më 19 shkurt 2026, në orën 12:00, ta shqyrtojmë projektligjin dhe raportet me rekomandimet t'ia paraqesin Komisionit FunkSIONAL për Buxhet.

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet deri më 19 shkurt 2026, në orën 24:00m ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë të projektligjit në seancën plenare dhe

Shqyrtimi i dytë i projektligjit të bëhet në seancën plenare, më 20 shkurt 2026, në orën 11:00. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci. Ftoj deputetët që të përgatiten për votim që të shmangemi nga Rregullorja e Kuvendit, bazuar në kërkesën e zonjës Nagavci. A e dëshirojmë fjalën grupet parlamentare? A e dëshirojmë fjalën grupet parlamentare? Ju lutem, që të paraqiteni kush e dëshiron fjalën! LDK-ja, zonja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!

Sinqerisht, s'po e kuptojmë çka është gjithë kjo nguti. Ju e dëgjuat Hekuran Muratin, tha ne jemi duke punuar ende me kontratat e 2020-tës. Ende janë duke punuar me kontratat e 2020-tës! Janë duke kërkuar që të shqyrtohet buxheti me procedura të shpejta. Cila është kjo nguti, se nuk po ju kuptojmë?! Edhe njëherë, ministër, nëse je duke punuar me kontrata të 2020-tës, afati i të cilave ka pasur të skadojë dhe të dorëzohet puna më 2022, 2023, 2024, 2025, ju jeni ata të cilët po bëni shkelje në baza ditore, duke mos i shkëputur kontratat.

Po vazhdoni t'i paguani operatorët ekonomikë, të cilët po rrinë, a po? Këtë je duke e thënë. Jemi kundër shmangies! Jemi kundër shmangies! Jemi kundër shmangies!

KRYETARJA: Faleminderit! Përgatitemi për votim, sepse nuk ka tjerë të paraqitur. Kush është për? Në fakt votojmë me elektronikë, më falni! Regjia ta bëjë gati sistemin e votimit. Votojmë tash!

Atëherë, sipas votimit kalon edhe ky propozim. Prandaj 2/3 e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, siç po e shihni propozimi kalon. Faleminderit, deputetëve!

Në ndërkohë, kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe komisionet e tjera parlamentare sipas fushave që mbulojnë, ta shqyrtojnë Projektligjin mbi ndaljet buxhetore për

vitin 2026 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime, dhe po ashtu edhe vendimi i sapo miratuar i Kuvendit. Faleminderit të gjithëve!

Shihemi nesër në seancën solemne, në orën 10:30, për nder të Pavarësisë!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë